المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

JETA DHE VDEKJA

Muhamed Mutevel-li esh-Sharavi

Botuar nga: Zëri Ynë

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PARATHËNIE 6
HYRJA E AUTORIT 7
KAPITULLI I PARË 8
Ç'ËSHTË FILLIMI 8
DEBAT I KOTË DHE LLOMOTITJE 10
NË BOTËN E DHERR-IT ISHTE DËSHMIA 13
PAMJET E KRIJIMIT 14
LIGJET E JETËS DHE VDEKJES 17
LIGJET E GJUMIT 18
FILLIMI I JETËS 20
SHPIRTI - BURIMI I JETËS 22
EKZISTENCA DHE NJOHJA E SAJ 23
KAPITULLI I DYTË 27
Ç'ËSHTË JETA 27
TRUPAT QAJNË, ... 31
DËGJOJNË DHE FLASIN 31
BIMËT (NDIEJNË) GJITHASHTU 33
BUBURRECI FLET, PUPËZA DI 35
JETË, POR E PANJOHUR PËR NE 37

DITURIA E ALL-LLAHUT DHE E NJERIUT 40
GJITHÇKA QË EKZISTON NË UNIVERS ËSHTË E GJALLË 44
KAPITULLI I TRETË 45
Ç'ËSHTË VDEKJA 45
JETA NË VARR 48
JETA NË BERZAH E PËRJASHTON KOHËN 54
VETËM AI JEP DHE MERR JETË 58
NEMRUDI SI "VDEKJEPRURËS DHE JETËDHËNËS" 60
KAPITULLI I KATËRT 66
NJERIU DHE PËRJETËSIA 66
SEKRETI I JETËS DHE MBARIMI I SAJ 70
RICIKLIMI I DY KRIJIMEVE: I VDEKJES DHE I JETËS 73
EMRAT E QENIES DHE EVIDENTIMI I ATRIBUTEVE 75
ISHIM PARA SE QË JEMI 76
VETËVRASËSI – PËRJETËSISHT NË ZJARR 78
KAPITULLI I PESTË 83
JETA E DUNJASË 83
ADHURIMI - I DOMOSDOSHËM POR, SI BËHET? 86
KUSH NA PREMTON USHQIMIN 88

PROGRAMI PARA KRIJIMIT 90
DETYRAT E NJERIUT NË JETË 91
LIGJET E ALL-LLAHUT 94
DHE LOGJIKA E NJERIUT 94
JETA – NGA MASHKULLI DHE FEMRA 97
KAPITULLI I GJASHTË 100
JETA TJETËR - AHIRETI 100
MENDJA – JO, NDËRSA MUNDËSIA- PO 103
REGJISTRI NUK HUMBET 104
ARGUMENTI LOGJIK 108
I RINGJALLJES 108
XHENNETI 111

PARATHËNIE

Ky përkthim m'u mundësua gjatë udhëtimit tim dy javor Shqipëri - Turqi. Në këtë pesëmbëdhjetëditësh të përkthimit, nuk llogaris përkthmin e ajeteve, sepse fjalët e All-llahut në Kur'anin fisnik i kam përkthyer pasi jam kthyer në Prishtinë. Ajetetet kur'anore është vështirë të përkthehen, prandaj me to jam marrë më shumë se dy muaj të tërë.

Ajetet kur'anore jam munduar t'i përkthej vetë, sepse mendoj se ato duhet të përkthehen prej vetë përkthyesit. Megjithatë, përkthimi i tyre nga ana ime, do të ishte i pamundur sikur të mos shërbehesha me të gjitha përkthimet ekzistuese që janë në gjuhën shqipe. Prej përkthimeve të Kur'anit në gjuhën shqipe do të kisha veçuar përkthimin e Hasan ef. I. Nahut dhe Feti Mehdiut. Gjithashu, më ka shërbyer mjaft në disa raste edhe përkthimi në gjuhën angleze i A. Jusuf Aliut. Për përkthimin e këtyre ajeteve, jam shërbyer shumë edhe me komentimet e ndryshme të Kur'anit në gjuhën arabe.

Duke menduar se do t'i ndihmoj lexuesit më shumë, në disa raste, kam shpjeguar terminologjinë e disa fjalëve dhe kam dhënë disa sqarime ose komentime, gjithmonë duke përdorur fusnotat.

I dashur lexues,

Shpresoj që ky libër të lexohet me vëmendje. Kemi të bëjmë me jetën e kësaj bote dhe me të ardhmen tonë në botën e përje-tshme. Neglizhimi, ose mohimi i saj do të na kushtojë shumë.

Nuk do të dëshiroja që asnjë nga bashkëkombasit e mi dhe askush nga mbarë qeniet njerëzore, t'a humbiste rrugën e drejtë. Ndërsa ata që vazhdojnë t'a mbivlerësojnë vetveten, pasi t'a kenë lexuar këtë libër i cili është bazuar krejtësisht në Kur'an, pra në fjalët e All-llahut xh. sh., atëherë le t'a meritojnë dënimin e dhembshëm nga Ai, sepse, vërtet, kryeneçët shkatërrimtarë, nuk meritojnë të mëshirohen.

HYRJA E AUTORIT

Pas madhërimit të All-llahut xh.sh., i dërgojmë salavate dhe përshëndetje më të mirit të të gjitha krijesave, zotëriut tonë, të dërguarit të All-llahut, Muhammedit s.a.v.s.

Lus All-llahun që këto libra t'a pasurojnë, t'a rrisin, dhe t'a lartësojnë kur'anotekën tonë, të bëhen ndriçuese të rrugës së udhëzimit dhe nur në zemrën e njerëzve, drejt dritës së imanit.

Dashtë All-llahu i Madhërishëm, që të vemi drejt suksesit në këtë botë dhe shpëtimit në jetën e pasosur.

Muhamed Mutevel-li esh Sharavi

KAPITULLI I PARË
Ç'ËSHTË FILLIMI

Asnjë temë nuk e ka preokupuar njerëzimin më shumë se tema rreth jetës dhe vdekjes. Kjo temë mendojmë se ka shtuar kureshtjen dhe ka hapur debate të mëdha. Gjithashtu, asnjë temë më shumë se kjo, nuk ka shtjelluar mendime dhe gënjeshtra të ndryshme, të cilat janë futur nga dijetarë të llojllojshëm! Kjo për faktin se vdekja është një sekret, një çështje e panjohur për ne, prandaj, për të folur për të, ne duhet të mbështetemi në informacionin që na ka dhënë All-llahu xh.sh.

Përderisa nuk kemi dëshmi bindëse, atëherë ndërhyrja e shkencës në këtë fenomen është e gabueshme. Nëse shkenca do të merrej me këtë fenomen,atëherë, ajo do të mbështetej ve-tëm mbi supozime dhe iluzione. Mbështetja e saj mbi supozi-me, do të krijonte mundësi që të dëgjonim gënjeshtra të ndry-shme dhe të humbej koha së koti, pasi këto supozime nuk kanë të bëjnë aspak me realitetin.

Edhe dijetarët e të gjitha kohërave, kanë dhënë mendi-me nga më të ndryshmet, rreth fillimit të krijimit tonë. Ato janë përplot kundërshtime me njëra tjetrën. Dikush prej tyre bazohet në teorinë e evolucionit, e cila thotë se njeriu e ka pre-jardhjen prej majmunit me emrin Lusi!

Këtyre trilluesve ju themi: kush iu informoi për këtë!? Gjatë gjithë historisë nuk është regjistruar kurrë ndonjëherë një gjë e tillë, (nuk ka) shkrime që të dëshmojnë se majmuni është shndërruar në njeri, edhe pse ne kemi shumë shkrime dhe mendime të ndryshme, të ruajtura që nga kohërat e lashta. A është shndërruar ndonjëherë majmuni në njeri, dhe kjo gjë nuk është përsëritur më?

Ky majmun, kur u 'shndërrua' në njeri, ishte mashkull apo femër!? Nëse do të ishte shndërruar në femër do të ishte i përgjysmuar, nëse është shndërruar në mashkull, gjithashtu do të ishte gjysmak. Ku u gjet kjo teori, të cilën e sajuat dhe për të cilën konkludoni (se është e vetmja e mundshme), se nuk ka mundësi tjetër veç saj!?

Tani kemi të bëjmë me një shkencë mjaft të zhvilluar. Hulumtimet shkencore kanë arritur një piedestal të tillë të la-rtë, që historia njerëzore nuk e ka arritur kurrë më parë. Gji-thashtu, kemi një teknologji të tillë, si kjo e kohës bashkëkohore, e megjithatë, akoma, ju jeni duke diskutuar për të argumentuar supozimin tuaj!! Ju lutem, na tregoni se si shndërrohet majmuni në njeri!?

Ndërkaq, neve, për trillime të tilla si këto të tuajat, na ka informuar All-llahu xh.sh. në shumë shembuj në Kur'anin fisnik, në të cilat thotë:

"Unë, nuk i mora ata (Iblisin-Shejtanin dhe pasardhësit e tij) për dëshmitarë, me rastin e krijimit të qiejve dhe të tokës. (Gjithashtu, nuk i mora për dëshmitarë) as gjatë krijimit tuaj. Unë, nuk kisha nevojë për mbështetjen e të humburve."

I Lartëmadhëruari na ka informuar se do të vijnë njerëz të humbur dhe do të merren me (hipoteza mbi) krijimin e qie-jve, tokës dhe krijimin e njeriut. Ata do të trillojnë dhe do të "tregojnë se si ndodhën" të gjitha këto!!! Këta të humbur nuk kanë qëllim tjetër, veçse t'i humbin edhe njerëzit e tjerë (prej së vërtetës), pasi ata nuk kanë qenë vetë dëshmitarë në kriji-min e qiejve dhe të tokës. Gjithashtu, ata nuk kanë qenë dëshmitarë në krijimin e vetvetes së tyre, që të jenë në gjendje, në emër të shkencës, të na tregojnë se çfarë ndodhi.

Ardhja e këtyre të humburve, e atyre që thonë se preja-rdhja e njeriut është prej majmunit, dhe e atyre që 'argume-ntojnë' me anë të teorive të tyre 'shkencore' rreth krijimit të njeriut, ka për qëllim vetëm një gjë, e ajo është se: këta të hu-mbur, vetëm sa e vërtetojnë Kur'anin dhe me këtë ia përfo-rcojnë imanin besimtarëve në tokë. Sikur të mos vinin këta njerëz që e kanë humbur rrugën e tyre, ne do të kishim thënë se All-llahu xh.sh., kur na ka informuar në Kur'an për gjërat që do të vijnë, na ka treguar për disa njerëz që do të na thonë se qielli dhe toka janë krijuar 'kështu e ashtu', ndërsa, realisht, këta njerëz nuk erdhën. Pra, ardhja e tyre ishte e domosdo-shme, pasi ato përforcojnë imanin e besimtarëve.

DEBAT I KOTË DHE LLOMOTITJE

Njerëzimi, gjithashtu, ra në grackën e ideve filozofike dhe ideve të kota, të cilat nuk posedojnë kurrfarë argumenti. Njësoj si ajo filozofi e thatë (shterpë), e cila kërkon të dijë se cila u gjend e para, veza apo pula?! Vërtet, rreth kësaj teme është polemizuar gjerë e gjatë. Lindën shkolla të shumta, të cilat vetëm sa e përgënjeshtronin njëra-tjetrën. Të gjitha këtyre shkollave iu drejtojmë pyetjen: pse kjo llomotitje e gjatë? (Përse e gjithë kjo) Kurse i Lartmadhëruari na treguar dhe na ka qetësuar, rreth fillimit të krijimit kur thotë:

"Dhe, të gjitha sendet i kemi krijuar çift, ndoshta do të mendoni (për Fuqinë Tonë)."

Kjo ka kuptim (të saktë), pasi ne, këtë dije e kemi marrë nga i Lartësuari. Jeta nuk mund të vazhdojë ndryshe, pra, nuk do të kishte jetë sikur të mos ekzistonte çifti: mashull-femër.

Ndërkohë, mendoj se polemikat e tyre janë shterpe, dhe se interpretimet e tyre janë tallje me shkencën (nëse ia vlen të thuhet kështu), pasi nga sjellje të tilla nuk kemi kurrfarë dobie. All-llahu xh.sh. na ka treguar se çdo gjë është krijuar prej çiftit. Sikur të mos ishte gjeli për të fekonduar vezën në brendësi të pulës, veza do të ishte sterile dhe nuk do të jepte asgjë.

Ishte, pra, dëshira e All-llahut xh.sh., që të ekzistojnë katër etapa të krijimit. Secila etapë, në vetvete konsiderohet mrekulli, pasi në të shfaqet Fuqia e All-llahut xh.sh. Këtyre (etapave) nuk ju njihen kufijtë, pasi ato nuk përkufizohen brenda rregullave të njohura prej nesh. Ademi a.s. ka qenë krijesa e parë në rruzullin tokësor.

Për këtë, na tregon i Lartësuari, në Kur'anin fisnik:

(Përkujtoni kohën) Kur Zoti yt u tha melekëve: Unë po krijoj njeriun nga balta. Pra, kur Unë t'a kem përsosur atë, dhe t'i kem fryrë atij nga Shpirti Im, atëherë, ju përuljuni atij (bëjini sexhde)."

Ky ishte fillimi i krijimit, ashtu si na ka treguar All-llahu xh.sh. All-llahu i Lartmadhëruar i fryu Ademit, nga shpi-rti i Vet. Ajo (Hava-çiftuesja e Ademit) u gjend atëherë, kur u krijua Ademi a.s., për të vazhduar më pas, në këtë mënyrë të krijimit me pasardhësit e tij deri në ditët tona e deri në Ditën e Fundit, me një precizitet i cili është shkruar dhe etiketuar me një shifër hyjnore, karakteristika e veçantë që do t'a ketë nje-riu. Për këtë lloj të krijimit, Ai na ka informuar Vetë, në Kur'anin Kerim:

"(O Muhammed, kujtoju njerëzve kohën) Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre, dhe kërkoi prej tyre të dëshmojnë ndaj vetes së tyre: (Ju tha) 'A nuk jam Unë Zoti juaj?' 'Po, gjithsesi, i thanë, ne këtë e dëshmojmë' (Kështu vepruan), që të mos thoni Ditën e

Kija-metit "Ne, nuk kishim njohuri për këtë (ekzistencën Tënde) ". Apo të thoni: "Por, të parët tanë ishin ata që të kishin vënë ortak, ndërsa ne ishim brezi pas tyre! A do të na dënosh për atë që bënë (të parët tanë) gënjeshtarët!?"

Disa njerëz edhe mund të pyesin: çfarë lidhje ka midis meje dhe Ademit, ndërkohë që kanë kaluar kaq shumë shekuj? Atyre, që pyesin kështu, iu themi: edhe ti je njëra pjesë e asaj fryme të All-llahut xh. sh., që Ai ia dha Ademit a.s. Ai (xh. sh.) t'a ka dhënë këtë jetë që ke. Ata do të pyesin: si? Atyre iu themi se jeta është një zinxhir i pashkëputur. Kur ai këputet, (jeta) mbaron. P. sh. merr rezultatin e shembullit fizik të jetës së babait tënd: sikur të mos ishte ekzistenca e babait të babait tënd, pastaj sikur të mos ishte babagjyshi, nuk do të ishte (as) babai yt. Babagjyshi yt ka qenë i gjallë, si rezultat i jetës së më hershme së babait të vet (katragjyshit tënd), jetë e cila është përcjellur hallkë pas hallke, kështu vijon deri tek Ademi a.s. Ky i fundit (Ademi a.s.) sikur të mos ishte i gjallë, nuk do të kishte fëmijë, ndërsa fëmijët e kanë marrë jetën prej mikrobit të gjallë që ishte te Ademi a.s. Pra, prej jetës së Ademit a.s. e morën jetën fëmijët e tij, të cilën ua përcollën më pas fëmijëve të tyre.

Kështu, sipas vullnetit të All-llahut xh.sh., jeta është përcjellë deri në ditët e sotme dhe do të vazhdojë t'u përcillet fëmijëve tanë, nipërve dhe mbesave, deri në Ditën e Kijametit.

NË BOTËN E DHERR-IT ISHTE DËSHMIA

Ne, të gjitha krijesat e All-llahut, kemi dëshmuar ndaj vetes sonë që prej fillimit të krijimit. Prej këtij dëshmimi nuk bën përjashtim askush, që prej atyre që kanë mbaruar së jetuari këtë jetë, e deri tek ata që do të vijnë (sa të jetë kjo botë). Sikur të mos ishte kjo dëshmi, qenia njerëzore nuk do t'a ki-shte njohur, apo përvetësuar imanin. Ky është një nga sekretet. Maja më kulminante e këtij sekreti është besimi (imani) në erzistimin e Hyjnisë-All-llahut. Pse? Sepse mendja e njeriut nuk do të mundej t'i përcaktonte ose t'i emërtonte gjërat. Kusht i emërtimit të gjësendeve është shikimi i tyre.

T'i nuk do t'a dije P. sh. apo nuk do t'a kuptoje thënien 'kodër'- atë do t'a kuptoje vetëm atëherë kur do të shikoje dikënd që është duke u ngjitur në të. Gjithashtu, nuk do t'a ku-ptoje thënien 'liqen', nëse nuk e ke parë më parë fotografinë e tij apo e ke parë (me sy) diku tjetër. Njeriu nuk e ka parë All-llahun xh.sh., e as nuk e ka të skicuar në mendje, por megji-thatë kur përmendet emri i All-llahut, njeriu nuk e ka të vë-shtirë që t'a njohë dhe t'a dijë domethënien, sepse kjo buron nga Fuqia e Madhe, prej së cilës njeriu është krijuar, gjendet, përjeton dhe furnizohet. Kur kryen një lutje, njeriu ndien në vete se është pastruar dhe i është mbushur zemra plot dritë. Të gjitha këto shenjëzojnë dhe japin kuptimin se All-llahun e kemi dëshmuar, secili në vete, në Botën e Dherr-it, atëherë kur është krijuar Ademi a.s.Ne e dimë,se Ai ekziston dhe i jep jetë (ekzistencën) secilit send. Këtë ne e quajmë natyrshmëria e besimit-imanit.

Ne, kur lindim, e kemi me vete këtë natyrshmëri ima-nore,e cila e mbush frymën dhe zemrat tona. Kjo ka energji aq të fortë sa që na tërheq lart, deri tek Krijuesi. Kjo natyrshmëri imanore ekziston tek secili i posalindur. Për këtë na informon i Dërguari All-llahut s.a.v.s. i cili thotë:

"Secila foshnje, lind me natyrshmëri të pastër (islame), më pas prindërit e bëjnë hebre, krishter ose zjarrputist."

PAMJET E KRIJIMIT

Tani, le të ndalemi tek katër format e krijimit nga ana e All-llahut xh.sh.:

Krijimi pa prezencën e mashkullit dhe pa prezencën e femrës, pra, drejtëpërdrejt nga All-llahu i Lartmadhëruar, pa ndërhyrjen e asnjë shkaku. Ademit a.s. u krijua në këtë mënyrë.

Krijimi prej mashkullit pa prezencën e femrës. Në këtë mënyrë u krijua Hava. U krijua nga brinjët e Ademit a.s. Kështu na ka informuar Kur'ani Kerim:

"O njerëz! Druajuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi nga një qenie e vetme, e prej tij krijoi çiftin e tij (femrën)"

Krijimi prej mashkullit dhe prej femrës. Nga ky krijim janë të krijuar të gjithë njerëzit, me përjashtim të njërit (Isait a.s.) dhe e gjithë kjo bëhet me vullnetin e All-llahut xh.sh. që ka sjellë shkakun.

Shkaqet, këtu kuptohet, janë qenurit e mashkullit dhe e femrës. Porse, shfaqja e Fuqisë së All-llahut jep mundësi që shkaqet të mos funksionojnë vetvetiu. Madje, ato veprojnë vetëm në sajë të shkakut. Prandaj, kemi çifte të martuar dhe që i plotësojnë që të dy kushtet për të pasur fëmijë,

por ja që ndodh, që ata të mos kenë fëmijë ose pasardhës. Sepse, mbi ato shkaqe, qëndron vullneti i All-llahut.

Le të lexojmë thënien e All-llahut xh. sh. në Kur'anin Kerim:

"(Vetëm) I All-llahut është Pushteti i qiejve dhe i tokës. Krijon atë që dëshiron. I jep (i fal fëmijë) femra atij që do, gjithashtu i jep (fal fëmijë) meshkuj atij që do. Ose, iu jep atyre çift, meshkuj dhe femra. E kë do Ai, e lë steril. Vërtet, Ai është i Plotfuqishëm dhe di."

Pra, kjo duhet të kuptohet se edhe pse ekzistojnë shkaqet dhe plotësohen të gjitha kushtet, si nga ana e mashku-llit ashtu edhe nga ana e femrës, shtimi ose pasardhësit, vijnë vetëm atëherë kur të plotësohet vullneti i All-llahut xh.sh. Ai arrihet me shfaqjen e Fuqisë Hyjnore, përndryshe, edhe pse bashkohet mashkulli me femrën, nuk jep rezultat. Ky nuk është trup i cili vepron në mënyrë mekanike, por mbi të gjitha këto shkaqe qëndron dhe ato finalizohen vetëm pasi të jetë shfaqur vullneti i All-llahut të Lartmadhëruar.

Për t'i përmbyllur mënyrat e formave të krijimit, ka ngelur edhe e katërta. Ajo është krijimi i Isait, birit të Merje-mes, prej femrës pa mashkull. Me këtë plotësohen katër mre-kullitë e krijimit. Pra njeriu u krijua:

1. pa mashkull dhe pa femër
2. prej mashkullit pa femër
3. prej mashkullit dhe prej femrës
4. prej femrës pa mashkullin.

Këto ishin format e krijimit të njeriut.

All-llahu i Lartmadhëruar, nga krijimi i Tij, bëri që të kemi edhe dy etapa të tjera, e ato janë jeta dhe vdekja. Jeta është një prej krijesave të Allahut, ashtu siç është edhe vdekja.

I Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

" I Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t'iu provuar se cili nga ju është më vepërmirë."

Secila prej këtyre dy etapave të krijimit, jeta dhe vdekja, kanë ligjet e veta me të cilat veprojnë dhe funksio-nojnë sipas tyre. Ne, qeniet njerëzore, nuk i dimë cilat janë ato ligje, me përjashtim të atyre që na ka mësuar All-llahu xh.sh. në Kur'anin Kerim. Ndërsa ato që kemi ne, janë shumë të pa-kta. Por, edhe pse ne posedojmë vetëm pak, ne gjykojmë sipas tyre, sepse janë të përgjithësuara!

Disa njerëz mendojnë se nuk ka asgjë tjetër në këtë botë, veç asaj që shohim kur jemi të zgjuar. Por, edhe ata nje-rëz që mendojnë kështu, bëjnë pjesë tek ata që ndërrojnë jetë çdo ditë dhe kthehen në të çdo ditë. Ata, sikurse edhe ne, tra-nsferohen prej një ligji në ligjin tjetër brenda një sekondi, dhe atë pa e ditur. Për këtë, i Lartësuari All-llah, thotë:

" All-llahu i merr shpirtrat në kohën e vdekjes së tyre, (gjithashtu ua merr spirtrat) edhe atyre që nuk kanë vdekur, kur janë në gjumë. Ua mban (shpirtin) atyre që u ka caktuar vdekjen, ndërsa ua rikthen të tjerëve (atyre që ishin në gjumë) deri në afatin e caktuar..."

LIGJET E JETËS DHE VDEKJES

Njeriu bie në gjumë duke u transferuar prej një ligji në një ligj tjetër. Kur ai është zgjuar, atë e sundojnë ligje të cilat janë të kufizuara. Ai sheh trupat që e rrethojnë, pra, trupat materialë. Ai vazhdon të ecë duke e përdorur edhe mendjen e tij. Kjo, për njeriun, quhet botë e dëshmive-fenomeneve. Botë e cila na është e njohur të gjithëve. Në të merr pjesë mbarë njerëzimi. Por, kur biem në gjumë, ne kalojmë në një jetë tjetër. Ky transferim ka ligjet e veta. Këto nuk i nënshtrohen mendjes, logjikës, e as dëshmive të kësaj bote. Ne pra, kështu, kemi dalë nga koha. Njeriu nuk ndien se ka të bëjë me kohën kur është në gjumë, për arsye se nuk ka të bëjë me elementet e kohës që ne i disponojmë në jetën tonë të natyrshme, thuaj të përditshme. Sikur të mos ekzistonte dallimi midis ditës dhe natës, njeriu nuk do t'a përjetonte dallimin kohor. Ai e bën këtë dallim ngase bie gjatë natës dhe zgjohet gjatë ditës, ose bie në gjumë gjatë ditës dhe zgjohet natën. Pra, nëse nuk do t'i përjetonte këto ndryshime, gjatë rënies dhe zgjimit, ai nuk do t'a dinte se sa kohë ka kaluar në gjumë.

Gjumi e shndërron njeriun, duke e bërë atë të dalë jashtë rrethit të botës normale. Ai nuk ndien asgjë për të (botën materiale), e as ajo nuk i është e njohur. Është i ndarë plotësisht prej saj. Thuajse, ai është ndarë prej ndodhive të kësaj botë plotësisht. Kur ai ndahet prej këtyre ndodhive, natyrshëm, ndahet edhe prej ligjeve të tyre. Ai mund të shohë, edhe pse sytë i ka të mbyllur. Ai vrapon edhe pse këmbët i ka në shtrat dhe nuk i lëviz. Rrëzohet nga ndonjë majë mali e lartë dhe nuk pëson fizikisht asgjë. E sheh veten duke fluturuar nëpër qiell, ose sheh të përmbytet toka. Ai e ndien veten se është duke qarë, ndërsa në realitet është duke qeshur. E kap ndonjë ankth, nxjerr zëra të çuditshëm, të bezdisshëm, ose zgjohet prej gjumit i trishtueshëm.

Ai gjatë kohës së tij në gjumë, nuk i nënshtrohet ligjeve të mendjes, e as nuk logjikon. Ai nuk u nënshtrohet as ligjeve të cilave u nënshtrohet në jetën e tij normale. Nëse i thua ndonjë njeriu se (në gjumë) kam shkuar në Amerikë dhe jam kthyer njëzet herë, brenda një nate, a do të të përgënje-shtronte? Përgjigja do të ishte: jo. Por nëse ti i thua se në gjumë kam biseduar me filanin dhe me filanin, të cilët kanë ndërruar jetë që prej shumë kohësh, a do të përgënjeshtonte? Përgjigja, gjithashtu do të ishte: jo.

LIGJET E GJUMIT

Njeriu në kohën kur është në gjumë, siç thamë më sipër, i nënshtrohet ligjeve të cilat shkenca nuk mund t'i kuptojë. Për këtë arsye njerëzit janë pajtuar që t'i nxjerrin nga përdorimi i dialektikës argumentet që shohin në gjumë. Asnjë njeri nuk bën debat rreth tyre, sado që të flitet për atë që shohin njerëzit në gjumë, ose që nuk janë logjike.

Shumë shkolla filozofike kanë bërë përpjekje që të japin shpjegime, rreth atyre se çfarë sheh njeriu kur është në gjumë. Por, të gjitha dolën pa rezultate konkrete, edhe pse kemi shumë thënie dhe shembuj të shumtë që rrodhën nga shkenca e psikologjisë. S'do mend se është derdhur djersë e shumtë, janë angazhuar mjaft njerëz dhe shkencëtarë, por përfundimi i tyre u bazua vetëm mbi supozime, ose trillime, prej të cilave njeriu nuk ka fare dobi. Të gjitha ato thënie nuk kanë të bëjë me realitetin.

Shkenca thotë: Koha më e gjatë që mund të punojë truri i njeriut, duke qenë në gjumë, është shtatëmbëdhjetë se-konda. Vetëm gjatë këtij intervali, njeriu "mund të shohë ëndrra". Ndërsa për t'a transmetuar një ëndërr, njeriut ndonjë-herë i duhet një orë ose më tepër.

Duhet të kuptohet se ky veprim është një transferim, nga një gjendje në një gjendje tjetër. Ai mund të kuptohet edhe si jetësim i një rregulli ose ligji, në një ligj krejtësisht tjetër. Këtë e përjeton secili njeri. All-llahu xh. sh. është i mëshi-rshëm me robërit e Tij, sepse shprehu Vullnetin e Tij që t'i tregojë njeriut që është në gjumë, se ai (njeriu) transferohet në botën e vdekjes në atë moment. Pra, kur ai kthehet në jetë (nga gjumi), domethënë, All-llahu xh.sh. ia kthen atij shpirtin përsëri në trup. Pse bëhet kjo? Për arsye që t'a mësojë njeriun, me transferimin e jetës së tij, prej një ligji në një ligj tjetër. Kur ne na thuhet se në ahiret do të jetojmë përgjithmonë, ne kuptojmë se do t'u nënshtrohemi ligjeve të tjera, dhe nuk habitemi, sepse jemi mësuar me këtë transferim!

Si mundet që njeriu të jetë i amshueshëm, apo të jetë i përjetshëm? Kjo jetë ka ligjet e veta të cilat e përcjellin njeriun. Pra, transferimi nga një ligj në një ligj tjetër bëhet çdo natë, tek secili njeri, duke mos e ndier ai fare këtë ndryshim. Kthimi, përsëri, i jetës dhe i ligjeve të mëparshme bëhet me anën e Fuqisë së All-llahut xh.sh., të cilat na sundojnë ne, e ato ligje janë ligjet e zgjimit. Pastaj, përsëri biem në gjumë dhe përsëri transferohemi në ligjin tjetër.

Nuk mendoj se dikush prej atyre, që deklaron vetëm në emër të shkencës, të mund të na shpjegojë se cilat janë ato ligje që i nënshtrohet ai, në momentin e rënies në gjumë. Të na tregojë, gjithashtu, se si mund të shohë ai, kur i ka sytë të mbyllur (në gjumë)? Ose kur vrapon, e ai është në shtrat? Ose kur udhëton nga një vend në tjetrin, e ai nuk ka lëvizur fare!?

Nga këto pyetje mësojmë se ekziston një mbretëri tjetër (ligjesh) për njeriun, të cilat ai akoma nuk i njeh, dhe nuk e di se si veprojnë ato gjatë gjumit. Pra, paskemi ligje që janë plotësisht të panjohura, që i përjetojmë gjatë jetës.

FILLIMI I JETËS

Shumë dijetarë janë përpjekur, të na ofrojnë (hipoteza mbi) format e fillimit të jetës. Prej tyre kemi marrë lloj lloj teorish. Prej tyre kemi mësuar se fillimi i krijesave ishte nga njëqelizorët. Pastaj kjo qelizë është ndarë dhe është zhvilluar, e kështu me radhë ... vazhdon ajo çfarë thonë ata...

Këtyre shkencëtarëve ju themi: ne nuk i marrim mësimet rreth jetës nga askush tjetër, përveç Krijuesit tonë. Vetëm krijuesi i diçkaje mund të na informojë për të. All-llahu xh.sh. është Krijuesi, dhe për këtë arsye edhe na tregoi se njeriun e ka krijuar prej dheut të tokës. Shkenca bashkëkohore, pasi ka njohur se njeriu është krijuar nga dheu, është marrë me hulumtimin e elementeve të cilat i ka toka dhe ka zbuluar se, në të, gjenden tetëmbëdhjetë elemente kimike, - të njëjtat elemente që i ka edhe njeriu në trupin e tij.

Fiziku i njeriut dallon sipas këtyre elementeve. Do të shohim se disa njerëzve ju mungon sasia e duhur e hekurit, e magnezit, ose e kalciumit, etj. Pasi kjo vërtetohet me anë të analizave laboratorike bashkëkohore, mjeku përcakton diagno-zën. Pastaj, ai i jep dozën e ilaçeve që duhet

të marrë pacienti për t'a plotësuar mungesën e elementeve që nuk i ka në trup. Por, këto tetëmbëdhjetë elemente (të tokës) janë po ato tetë-mbëdhjetë elemente të trupit të njeriut.

Pra, All-llahu xh.sh. na ka informuar se e krijoi njeriun prej dheut dhe prej baltës së tharë, të zezë dhe me erë.

Kështu, All-llahu i Lartësuar, në Kur'anin Kerim, thotë:

"(Përkujtojeni kohën) Kur Zoti yt u tha melekëve: Unë po krijoj njeriun nga balta. ...

Gjithashtu, në një verset tjetër, thotë:

"(Dhe përkujtojeni kohën) Kur Zoti yt u tha melekëve: Unë po krijoj njeriun nga balta e tharë , e zezë dhe e formësuar . Pra, kur Unë t'a kem përsosur atë, dhe t'i kem fryrë atij nga Shpirti Im, atëherë, ju përuljuni atij (bëjini sexhde)"

Kështu i ka përcaktuar All-llahu xh.sh. elementet e trupit të njeriut dhe etapat e krijimit. All-llahu xh.sh. u tregua i Mëshirshëm ndaj mendjeve tona, sepse, këtu, kemi të bëjmë me gjëra sekrete, prandaj Ai na jep pamjet e një dëshmitari, sa për t'ia afruar mendjes sonë, që të kuptojë më mirë.

Ne nuk e kemi përjetuar ose dëshmuar krijimin tonë, por çdo ditë e dëshmojmë vdekjen, që është bërë e zakonshme tek ne. Le të marrim si shembull ndërtimin e një ndërtese. Kur ti ndërton një ndërtesë, kuptohet fillon nga themelet, pastaj nga kati nëntokësor, pastaj nga kati i parë, i dytë, ... e kështu deri tek ai i fundit. Kur fillon t'a rrënosh atë, detyrimisht fillon nga ai i fundit. Githashtu, nëse ke për qëllim të udhëtosh nga Prishtina për në Tiranë, Tirana është stacioni yt i fundit. Kur mendon të kthehesh përsëri, qyteti i parë që do të lesh mbrapa është qyteti i Tiranës. Kështu

është edhe me vdekjen, ajo është e kundërta e jetës, prej së cilës kemi ardhur. Gjëja e fundit që ka hyrë në trupin e njeriut, sipas asaj që na ka info-rmuar All-llahu xh.sh., është shpirti.

1. Ai pra, (shpirti) duhet të jetë i pari që do të ndahet prej trupit.
2. Pastaj trupi i njeriut të vdekur, mer formën e shtangosjes- thuajse është i ngrirë.
3. Pastaj trupi kalbet dhe mer formën e baltës së kalbur me erë të rëndë.
4. Pastaj asaj balte të kalbur, i shteret edhe uji dhe ngelet vetëm dheu.

Kjo është e vërteta të cilën e ka theksuar Kur'ani Kerim. Çdokush, që i vjen vdekja, është dëshmitar i saj.

Njeriu ka dëshirë të dijë se ç'është vdekja? Më së pari ai duhet të kuptojë jetën. Shpirti është ai që i jep jetë trupit. Shpirti, gji-thashtu, është i krijuar, ai është në brendinë tënde, por është i pa njohur për ty. Ti nuk e di se ç'është shpirti, por di gjurmët që ai le tek ti. Ai është që t'i jep ndjenjat dhe të jep jetën.

SHPIRTI - BURIMI I JETËS

Por, si mund t'a dimë se ku është shpirti? A është ai në mendje, me anën e së cilës mendojmë? Apo në dorë, të cilën e lëvizim? Apo është në zemër, e cila na jep jetë? Apo, mos va-llë, është në këmbë, me të cilat ecim?

Ku është ai? Askush nuk e di.

Kur ne nuk jemi në gjendje të dimë sekretin e qenies sonë, një prej krijesave të tjera të All-llahut që jeton brenda nesh, në trupin tonë, a do të jemi ne në gjendeje t'i dijmë të gjitha se-kretet e krijimit? Kjo është e pamundur.

Ne do të kishim dëshiruar të njihnim më të parën (shpirtin), pasi është brenda nesh, në vetë qenjësinë tonë, para se të jepnim vendimim për njerëzimin mbarë. Përderisa jemi prej atyre që kanë dështuar në njohjen e një sekreti, prej sekre-teve të All-llahut të Lartmadhëruar që e kemi në trup, a do të mundemi t'i njohim sekretet e All-llahut në univers? Përgjigja do të ishte: Jo, nuk mundemi. Njeriu, mjerisht, shpeshherë paraqitet mendjemadh dhe mundohet të jep përgjigje aty, ku mendja e tij nuk ka mundësi të depërtojë.

Mendja e njeriut ka kufij. Detyra e saj është të zgjedhë midis alternativave të jetës, të dallojë të shëmtuarën nga e bukura. Ajo është një mjet përzgjedhës, që njeriu të dallojë me të (të mirën nga e keqja), pasi ajo është krijuar për të zgjedhur. Kjo mendje, nuk mund të dalë përtej kornizave që All-llahu xh.sh. ka paraparë për të.

EKZISTENCA DHE NJOHJA E SAJ

Vërtet, filozofët i kanë stërmunduar mendjet e tyre, duke u përpjekur t'i përgjigjen pyetjes se: ç'ekziston prapa materies. Ata, vërtet, nuk janë ndalur së pyeturi për asnjë moment. Kush ju ka

thënë atyre se ekziston diçka përtej materies? Këtë ua ka bërë me dije natyrshmëria e imanit të njerëzve. Sepse ajo e ndien dhe e di qartësisht se ekzistojnë gjëra që janë përtej materies. Por, a është e mundur që, me anë të mendjes, njeriu të mund të arrijë deri tek përgjigja e kësaj pyetjeje?

Përgjigja do të ishte: Jo! Përjashtim bën vetëm rasti nëse shpreh vullnetin All-llahu i Lartësuar, që krijesës së Vet t'i zbulojë një prej shumë sekreteve të universit. Sepse All-llahu xh. sh., secilës gjeneratë i zbulon ndonjë prej sekreteve të këtij universi, që ishte e panjohur më parë për njerëzimin. Nëse vjen koha që ky sekret të dalë, atëherë njerëzit do të fillojnë të hulumtojnë për të. Por, edhe sikur qeniet njerëzore të mos hulumtojnë për të, ai (kur t'i vijë koha e caktuar prej All-llahut xh. sh.) do të zbulohet. Atë neve do të na i zbulojë vetë All-llahu xh.sh., me 'ligjin' që bota njerëzore e quan 'rastësi'. Ky ligj i 'rastësishëm' është iluzor. Askush nuk e njeh këtë ligj, me përjashtim të mendjes njerëzore.

Ky univers me të gjitha potencialet që ka, prej ndo-dhive më të vogla deri tek ato më të mëdhatë, është sendërtuar prej All-llahut xh.sh., pra, ndodhi pas ndodhie. Atij nuk i mu-ngon asgjë prej diturisë së Tij, sado i vogël të jetë sendi. Asgjë nuk ndodh në univers pa lejen e Tij. Por, gjithashtu, është prej gjërave të Madhërisë së Tij (fakti) se Ai i ka të regjistruara të gjitha ndodhitë, që prej fillimit të krijimit deri tek Dita e Fundit. Ai i ka regjistruar të gjitha ato në Librin e Tij, para se të fillonte krijimi.

Lexonie thënien e All-llahut xh.sh.,në Kur'anin Kerim:

"Asnjë ndodhi prej ndodhive (fatkeqësive) nuk e godet tokën, e as juve, përveç asaj që është shënuar më parë në Libër..."

gjithashtu edhe thënien:

Tek Ai, janë çelësat e sekreteve, askush përveç Tij nuk i di ato. Ai e di se ç'ka në tokë dhe në det. Asnjë gjethe nuk bie (nga pema), pa dijen e Tij. As fara që është në brendi të tokës (nuk mbin), e nuk ka anjë send, të njomë e të thatë, të mos jetë i shkruar në Librin e Qartë."

Përderisa All-llahu xh.sh. i paska regjistruar të gjitha ngjarjet në univers, kjo jep të kuptohet se nuk ka asgjë në botë, që për të të thuhet "rastësisht", por çdo gjë ndodh me një precizitet të madh dhe Planifikim Hyjnor. Pra, asgjë nuk ndodh rastësisht. Ndërsa mosnjohuritë tona rreth sekreteve të ekzistencës (pasi ato na bëhen neve të njohura në sajë të vullnetit të All-llahut) i nxjerrin ato si ndodhi ose ngjarje të rastësishme.

E vërteta është se, All-llahu i Lartëmadhëruar ia shpalos mendjes sekretet e universit gradualisht, hap pas hapi, derisa të na bëhen të kapshme për t'i kuptuar. Duhet t'a kuptojmë se ekziston dallimi, ndërmjet ekzistencës dhe njo-hjes së ekzistencës. Përreth nesh ekzistojnë miliona gjëra që i kryejnë detyrimet e tyre në jetë. Ne prej tyre përfitojmë shumëçka, duke mos e ditur nëse ekzistojnë ato apo jo. Ishte vullneti i All-llahut të Lartëmadhëruar që të mësojmë se ekzistojnë miliona gjëra që e kryejnë detyrën e tyre në univers por që ne nuk i njohim ato. Mosnjohja e tyre nga qenia njerë-zore nuk do të thotë se ato nuk ekzistojnë.

Për t'a përmbyllur, përsa trajtuam në këtë kapitull, themi: All-llahu xh.sh. ka bërë që jeta të rrjedhë nga mashkulli dhe femra. Për çdo gjë ka krijuar çiftin. Shtimi nuk vjen, ve-tëm prej gjinisë së një lloji, por nga bashkimi i të dy gjinive. Më pas shfaqet Fuqia e All-llahut, e cila qëndron mbi ligjet dhe rregullat e proceseve natyrore.

Pastaj u argumentua se jeta është zinxhirore, dhe ka li-dhshmëri prej Ademit, (e do të vazhdojë hallkë pas hallke) deri në Ditën e Kijametit. Ajo transmetohet nga një njeri i gja-llë, tek një njeri tjetër i gjallë. Kur të vijë vdekja çdo gjë stagnon.

Gjithashtu, u agrumentua se, njeriu nuk mund të arrijë të kuptojë sekretin e jetës ose fillimin e krijimit. Ai nuk e di se si erdhi deri aty, sepse ai nuk e ka përjetuar ose dëshmuar atë. Përderisa njeriu nuk ka arritur të njohë një sekret, prej sekre-teve që është në brendi të trupit të tij (shpirtin), atëherë pse është kaq ambicioz që t'a kuptojë sekretin e krijimit të unive-rsit, në tërësi.

All-llahu xh.sh. nuk e ka bërë mendjen mjet për t'i njohur sekretet e jetës, por mendja duhet të meditojë rreth shenjave të All-llahut në univers, vetëm sa për t'u bindur se i Lartësuari është Ai i Cili e ka krijuar këtë univers. Nëse të dërguarit e All-llahut kanë ardhur për të sjellë programin e Zotit, ka qenë e domosdoshme që mesazhi i këtyre të dërgu-arve të pranohej, por mjerisht ata u pritën në mënyrë injoruese. All-llahu na mbroftë prej kësaj.

Ne kur duam të mësojmë për sekretin e jetës dhe të vdekjes, patjetër duhet që ato (dijenitë e atyre sekreteve) t'i marrim nga Ai i Cili i ka krijuar ato. Ne, çdo ditë, transfero-hemi prej jetës në (një gjendjeje) vdekje kur biem në gjumë dhe prej vdekjes në jetë kur zgjohemi. Por këto gjëra nuk i vë-rejmë nga rutina e përditshme, injoranca dhe mungesa e vëme-ndjes sonë.

Njeriu i nënshtrohet, së paku, ligjeve të jetës së tij: ligjeve të zgjimit dhe ligjeve të gjumit.

Por, vërtet, ç'ka është jeta? Këtë pyetje do t'a shpjegojmë në kapitullin tjetër, inshaAllah, nëse ka shprehur i Lartësuari vullnetin e Tij.

KAPITULLI I DYTË
Ç'ËSHTË JETA

Në orvajtjen tonë për t'a kuptuar jetën, duhet t'a kemi të qartë se All-llahu xh.sh.nuk e krijoi jetën vetëm për qeniet njerëzore dhe xhinn-ët, por duhet të kuptohet se jeta ka shtrirje në secilën pjesë të këtij universi. Perceptimi njerëzor për jetën është: 'çdo gjë që ndien dhe lëvizë'. Por thënë të vërtetën, jeta është: 'çdo gjë që e kryen detyrën e vet në këtë univers.'

Ne themi se njeriu është i gjallë, sepse lëvizë, ecën dhe flet. Gjithashtu, themi se kafshët janë të gjalla, po për këtë shkak, sepse ato ecin dhe kanë ndjenja. Bimët, po ashtu, janë të gjalla sepse marrin frymë. Ndërsa për krijesat e tjera ne mendojmë se nuk janë të gjalla. Por kjo nuk është e vërtetë. Si?

Të kuptuarit e jetës në këtë univers ndryshon nga të kuptuarit tonë plotësisht. Thamë se speciet në univers janë katër:

1. Trupat -"inorganikë ose të pajetë"
2. Bimët
3. Kafshët dhe
4. Njeriu.

Secili lloj i këtyre specieve i shërben tjetrit, ndërkohë që secili ka veçoritë e veta.

1. Le të marrim si shembull trupat inorganikë, ata iu ndihmojnë bimëve, kafshëve dhe njeriut. Ata njihen si trupa të pajetë, por ata kanë arritur deri në shkallën e zhvillimit. Këtë do t'a gjeni tek lloji i trupave barishtore në det, që quhen Merxhan-Korale. Do të vëreni se si ajo zhvillohet, edhe pse trupat inorganike nuk e kanë cilësinë e zhvillimit. Por secila specie në vehte, e ka kulmin e vet të zhvillimit në univers. Ajo përfundon së zhvilluari deri në segmentin kufitar të caktuar për të. Fillimi i species së re nënkupton përfundimin e species së më hershme. Trupat inorganikë, ndalohen së zhvilluari në kulminacionin e zhvillimit të tyre ose në veçorinë e tyre të zhvillimit primitiv për llojin e vet.

2. Ndërsa këtu është fillimi i veçorisë së bimëve. Ato, fillojnë duke u zhvilluar deri në maksimumin e tyre të mundshëm, e ajo është ndjenja. Kemi bimë të cilat kanë ndjenja. P.sh. zonja e turpshme, që është emërtuar kështu nga djelmoshat tanë. Ajo është një lule që kur i afron gishtin, ajo i mbledh gjethet.

3. Veçoritë e kafshëve fillojnë aty ka kanë mbaruar bimët, pra në zhvillimin e tyre të ndjenjave primitive, në të cilën janë të njohura instiktet, deri në fillimin e të menduarit. Shohim se disa lloje majmunësh, arrijnë t'a imitojnë njeriun, por ata nuk e kuptojnë, e as nuk trashëgojnë diturinë. Njeriu ka mundësi që t'i ushtrojë kafshët me lojëra të ndryshme aq sa ju është mundësuar atyre të mendojnë – siç themi ne 'mendje primitive'. Por këto ushtrime kafshët, nuk janë në gjendje t'i trashëgojnë. Majmuni i cili është stërvitur me ushtrime të ndryshme nuk mundet t'a mësojë këlyshin e vet ose ndonjë majmun tjetër i cili nuk është ushtruar nga njeriu. Kjo na bën të kuptojmë se të gjitha kafshët që kanë ushtruar kanë marrë një zanat të veçantë për ato që kanë ushtruar.

4. Në fund vjen njeriu i cili konsiderohet zotëria i këtij universi, të cilin All-llahu xh.sh. e ka dalluar me mendje, të planifikojë në krijesat e All-llahut xh.sh., t'i mendojë dhe perceptojë shenjat e All-llahut, dhe t'a ndjekë programin e të Lartësuarit.

Ne i shikojmë trupat inorganikë, se si ata nuk kanë jetë dhe lëvizje, por ne nuk vërejmë se si ata e kryejnë detyrën e vet në atë mënyrë. Le të studiojmë thënien e All-llahut xh.sh. në Librin e Tij, Kur'anin Kerim, e cila thotë:

"...përveç (All-llahut) Fytyrës së Tij , çdo gjë (e krijuar) do të shkatërrohet..."

Ne jemi të bindur, dhe e them me siguri të plotë se, çdo gjë që është në këtë univers do të shkatërrohet atë ditë kur do t'i fryhet Surit . Përderisa All-llahu xh.sh. do ta shkatë-rrojë çdo gjë, nga kjo pra rrjedh se çdo gjë në të ka pasur jetë, sepse shkatërrimi, siç thamë më sipër, është e kundërta e jetës. Le ta lexojmë thënien e All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim:

"...për t'u shkatërruar ai që është i padrejtë, -me argumente të qarta, e të jetojë ai që është i drejtë-me argumente të qarta...

Ky ajet kur'anor na lë të kuptojmë se shkatërrimi është e kundërta e jetës. Për këtë arsye, kur i Lartësuari thotë "çdo gjë do të shkatërrohet" lë të kuptojmë se çdo gjë ishte e gjallë, e për këtë arsye, çdo gjë do të shkatërrohet, me përjashtim të All-llahut xh.sh.

Ne jemi duke folur për jetën në cilësinë e saj si ndjenjë dhe lëvizje. Ky është të kuptuarit standard nga ana jonë. Por, realisht, ne jetën duhet që t'a kuptojmë mbi bazat e çdo gjëje që ekziston në univers. Trupat inorganikë kanë jetën e tyre, jetë që atyre iu përshtatet si të tillë. Bimët jetojnë jetën e tyre, ashtu si ato i janë përshtatur asaj jete siç janë. Gjithashtu, edhe kafshët kanë jetën e

tyre, që i janë përshtatur atij lloji të jetesës. Por, realisht, ka ngelur edhe një gjë pa u thënë, me të cilën nuk po ekzagjerojmë, e as nuk do të polemizojmë, e ajo është se, të gjitha këto që theksuam, e madhërojnë All-llahun e

Lartmadhëruar.

Këtë e vërtetojmë me këtë ajet kur'anor:

" S'ka asnjë kafshë që është në tokë, e as shpezë që fluturojnë me krahët e tyre, të mos janë bashkësi, sikurse edhe ju. Ne, në Libër nuk kemi lënë asgjë mangut, dhe pastaj te Zoti tyre do të tubohen. "

gjithashtu, edhe ajeti tjetër:

" ...dhe, çdo gjë e Lartmadhëron dhe e falënderon Atë, por ju nuk i kuptoni Lartmadhërimet (tesbih-ët) e tyre..."

Të fillojmë me trupat inorganikë. Ata kanë jetën e tyre, të cilën e jetojnë edhe pse ne nuk e kuptojmë. Ne e shohim një trup inorganik para syve tanë që është i palëvizshëm. Por a është kjo e vërteta!?

Kur ishim në shkollë na kanë mësuar se si arrihet deri tek magnetizimi i trupave ose hekurit. Mësonim se si hekuri merr cilësinë (magnetike) e tërheqjes së trupave. Na sillnin një enë cilindrike në të cilën kishte ashkla hekuri. Pastaj merrnim magnetin dhe e kalonim nga njëra anë. Shikonim se si ashklat e hekurit e ndërronin drejtimin e tyre, sistemoheshin në një rresht dhe bëheshin të magnetizuara. Kjo provë, me të cilën lëviznin pjesët e hekurta, bëhej tek të gjitha pjesëzat e

hekurit kur e kalonim magnetin në një drejtim. Kjo është një provë shumë e thjeshtë, të cilën e kemi vërejtur tek ashklat e hekurit. Kështu ndodh edhe kur ne kalojmë edhe shufrën e hekurt, pavarësisht se ne nuk e vërjemë atë, për shkak të copës së dendur të hekurit.

TRUPAT QAJNË, DËGJOJNË DHE FLASIN

Lëvizjet e trupave inorganikë syri nuk i vëren dot dhe ne nuk dimë gjë për to. Por një gjë është e ditur: ato e kryejnë detyrën e tyre sikurse gjallesat e tjera organike. Ne themi se trupat inorganike nuk kanë jetë, por, në realitet, këto trupa që ne themi se nuk kanë jetë, kanë mirësjellje, por ne nuk e kuptojmë. Le t'a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh.:

" Dhe as qielli e as toka nuk i vajtoi ata , e as nuk iu dha afat atyre"

Toka dhe qielli kanë mirësjellje. Ato qajnë, ndoshta edhe qeshin, edhe pse ne nuk i kuptojmë, por supozojmë se ato janë të ngurta (inorganike), e as nuk ndiejnë, e as nuk qajnë. Toka dhe qielli kanë veshë për të dëgjuar fjalët e All-llahut të Lartmadhëruar, dhe e kuptojnë dhe ia kthejnë përgjigjen Atij.

Kështu na informon Kur'ani Kerim, kur thotë:

"Pastaj vazhdoi (krijimin) e qiellit kur ai ishte tymnajë, duke i thënë atij (qiellit) dhe tokës: ejani, me ose pa dëshirë. Ato dyja (toka dhe qielli) i thanë: erdhëm vullnetarisht!

All-llahu xh.sh. i është drejtuar me fjalët e Tij qiellit dhe tokës, ata e kanë kuptuar të Lartmadhërishmin (urdhërin e Tij) dhe i janë përgjigjur me një gjuhë që askush nuk e di, përveç All-llahut xh.sh. Përderisa puna ka qenë kështu, neve nuk na lejohet të themi për tokën dhe qiellin se janë 'memecë'. Pra toka ka në vetvete veshë që dëgjon dhe (gojë që) përgjigjet.

Lexoni thënien tjetër të All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim:

"Kur qielli të çahet, e të dëgjojë Zotin e vet (me bindje të plotë), sepse e meriton. Edhe kur toka të shtrihet (për shkak se malet do të shpërbëhen), e t'i flakë gjithë ç'ka në brendinë e vet (të vdekurit...) derisa mos të mbetet asgjë në të dhe të dëgjojë Zotin e vet (me bindje të plotë), sepse e meriton..."

ç'kuptojmë nga kjo?

Kjo do të thotë se toka dëgjon me veshët e saj. Gjithashtu, edhe qielli ka veshë me të cilët dëgjon. Edhe toka ka veshë me të cilat dëgjon, gjithashtu. Kur i Lartësuari All-llah ju thotë: A më dëgjuat? - ato i përgjigjen Atij. Të gjitha këto për ne janë të panjohura, dhe ne nuk kuptojmë asgjë prej tyre.

All-llahu xh.sh., gjithashtu, na ka informuar se këto kanë mirësjellje dhe i frikësohen All-llahut xh.sh. Sipas kësaj ne kuptojmë se këto i frikësohen Atij më shumë se sa zemra e njeriut.

Për këtë, i Lartmadhëruari, thotë:

"(edhe pas gjithë këtyre argumenteve) Zemrat tuaja u forcuan, ato u shndërruan sikur guri ose diçka edhe më e fortë se sa guri ! Kemi shkëmbij që prej tyre burojnë lumenj, por kemi prej tyre, që kur ata të çahen, del uji, gjithashtu kemi prej tyre që drithërohen nga frika e All-llahut..."

Pra po shohim se edhe trupat inorganikë kanë jetërat e tyre të ndryshme, disa prej të cilave janë të theksuara në Kur'anin Kerim dhe shumë prej tyre të cilave ne (njerëzit) nuk dimë asgjë për to. Për disa prej tyre, na ka treguar i Dërguari All-llahut, Muhammedi s.a.v.s., si për shembull për gurin që e kishte para duarve të tij, i cili bënte tespih (lartmadhëronte Allahun). Edhe malet bënin tespih së bashku me Dautin a.s. Për këtë, i Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"...Ne i nënshtruam së bashku me Davudin, malet dhe shpezët, që t'a lartmadhërojnë All-llahun, (këto të gjitha) ishin prej veprave Tona."

BIMËT (NDIEJNË) GJITHASHTU

Nëse, tani, i lëmë anash trupat inorganikë dhe kalojmë tek bimët, do të shohim se edhe këto ndiejnë. Secili që bën tesbih, ka për qëllim t'a përkujtojë All-llahun xh.sh. Le të kujtojmë tregimin e pemës së hurmës. Kur i Dërguari i All-llahut, mbante ligjëratat (hutbet) e tij, ai e kishte zakon të mbështetej tek trungu i hurmës. Është një tregim shumë i njohur për ne, që më pas atë hurmë e bënë mimber të xhamisë. Kjo pemë kishte nxjerrë një ofshamë, që ishte shenjë e mërzitjes, kur Muhammedi s.a.v.s. ndërroi jetë. Ky është një argument i ndjenjave të bimëve edhe pse ne nuk e

kuptojmë gjuhën e tyre. Gjithashtu, kemi edhe shembullin e hurmës, e cila i puthi dorën Muhammedit s.a.v.s. Kjo është edhe një prej mrekullive të shumta të tij.

Edhe pse ekzistojnë shenja të jetës tek bimët, ne ato nuk i njohim. Ne dimë vetëm se bimët zhvillohen dhe kaq. Edhe bimët, gjithashtu, janë krijuar që me anë të shijes të zgje-dhin atë që duan. Kjo është hyjnore. Bimët thithin ujin prej kanaleve të rrënjëve adventive, të cilat ne i quajmë (pompa me presion- Ismozi), dhe e dërgojnë atë deri tek rrënjët adventive.

Këto prova i kemi bërë duke qenë në shkollë. Merrnim tubacione me rrënjë adventive, ato i vendosnim në një enë të mbushur plot me ujë. Vërenim se si ato e thithnin ujin dhe se si niveli i ujit ngrihej. Kjo rritje bëhej me ndihmën e këtyre rrënjëve, të cilat i kemi quajtur pompa me presion- Ismozi. Pra, na është thënë se bimët ushqehen në këtë mënyrë, por është harruar një gjë të na thuhet: nëse bimët ushqehen në këtë mënyrë, pse ato, atëherë, kanë prodhime të ndryshme, ndërkohë që ato ushqehen prej të njëjtit ujë? Nga kjo pyetje mësojmë se i Lartësuari All-llah, iu ka dhënë bimëve diçka më shumë se sa pandehim për veçorinë e llojit të tyre. Pra, edhe ato kanë veçorinë e përzgjedhjes.

Për këtë arsye shohim se secila pemë zgjedh prej tokës ato elemente që i shërbejnë për të dhënë frutin.

Secila pemë bën përzgjedhjen e vet. Merr prej elementeve tokësore aq sa asaj i nevojitet, aq sa t'i prodhojë frutat e saj, të ëmbla, me ngjyrë, me aromë tërheqëse dhe që e bëjnë atë të veçantë. P.sh. të supozojmë se kemi një pemë molle, pranë saj pemën e handhalit dhe pranë handhalit të kemi bimën e specit. Edhe pse ujitja bëhet prej të njëjtave elementeve, secila në vete do të thithë nga toka atë që i nevojitet. Handhali, përzgjedh elementin që i prodhon më shumë thartirë, molla më

shumë ëmbëlsirë..., ndërsa speci atë që prodhon më shumë djegësirë. Gjithashtu, secila në vetvete, ka ngjyrën e veçantë, formën e veçantë dhe secila ka emrin e vet. Pra, kjo është jeta që All-llahu xh.sh. e ka krijuar tek bimët: secila bimë ose pemë përzgjedh elementet të cilat i përshtaten.

Lexoni thënien e All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim, e cila thotë:

"Dhe, në tokë ka vende me të mbjella të ndryshme, e që janë pranë njëra tjetrës. Në to, ka hardhi e grurë, gjithashtu edhe hurma që janë me një pip ose me dy pipa. (Të gjitha bimët) ujiten nga i njëjti ujë, por, Ne, disa prej tyre i kemi dalluar (në shije) për ngrënie..."

Këto ishin disa aspekte të jetës, të cilat vërehen tek bimët: ndjenjë, lëvizje, përzgjedhje dhe kryerje e detyrës.

BUBURRECI FLET, PUPËZA DI

Nëse kthehemi tani tek insektet, do të shohim se edhe ato veprojnë me një precizitet të mahnitshëm. Ato, pa dyshim, kanë gjuhën e tyre dhe kuptohen me llojin e qenies së vet. A nuk ishin buburrecat ata të cilët, kur e panë ushtrinë e Suljmanit a.s., thanë:

"...(njëri prej buburrecave tha): O ju buburreca, hyni në vendbanimet tuaja, të mos ju shkatërrojë Sulejmani dhe ushtria e tij, sepse ata nuk e hetojnë (ndiejnë) (shkatërrimin tuaj)."

Kush i mësoi buburrecat se ushtria që po vinte ishte e kryesuar nga Sulejmani a.s.!? Kush i mësoi ata, se kur të vinte ushtria, buburrecat do të shkatërroheshin dhe do të vriteshin pa e ndier (ushtria) prezencën e tyre? Kush i mësoi ata të me-ndojnë në këtë mënyrë? Pra, ajo mendje që gjykon, nuk mund t'a kuptojë këtë ndryshe, përveçse se ato janë qenie që kupto-jnë, ndërkohë që ne nuk dimë asgjë për këto krijesa. Ato ku-ptojnë, por ne nuk e dimë se si ato kuptohen dhe çfarë ato bëjnë ndërmjet tyre.

Nëse lexojmë tregimin e pupëzës dhe Sulejmanit a.s., do t'a kuptojmë se sa e gjërë është dituria tek krijesat e All-llahut, përveç njeriut. Por, çfarë i tha pupëza Sulejmanit a.s.!?

I Lartësuari xh.sh., në Kur'anin Kerim, thotë:

"...(Pupëza s'vonoi shumë, erdhi dhe tha): Kam marrë informatë të cilën ti (Sulejman) nuk e ke. Unë po vij tek ti nga Seba me një lajm shumë të sigurtë. Gjeta një grua e cila e mbretëronte atë vend, asaj i ishte dhënë çdo gjë (që i nevojitej një sunduesi), ajo madje kishte një fron të mahnitshëm. Pashë se ajo dhe populli saj po i bënin sexhde diellit, e jo All-llahut. Shejtani ua kishte zbukuruar vepri-met e tyre, andaj i kishte larguar nga e vërteta. (Mjerisht) ata nuk ishin të udhëzuar."

Të shikojmë, së pari, se ç'na tregojnë këto ajete. All-llahu xh.sh. i kishte dhënë Sulejmanit a.s. pushtet të tillë, që askujt më parë prej qenieve njerëzore nuk ia kishte dhënë këtë mundësi në botë. Përkundër këtij pushteti të madh që kishte, Sulejmani po dëgjonte nga pupëza atë që e kishte mësuar i Lartësuari All-llah, gjëra të cilat Sulejmani a.s. nuk i dinte. All-llahu xh.sh. e bëri këtë që Sulejmani a.s. të mësonte dhe t'a kuptonte se Ai nuk ia jep diturinë vetëm një njeriu. Ai

(Su-lejmani) e kuptoi se secili ka specifikat e veta, dhe se askush nuk është i përsosur. Secilit i mungon diçka.

Kush e mësoi pupëzën se ajo mbretëri quhej 'Mbre-tëria e Sebas'? Kush e mësoi atë se ai popull është nën udhë-heqjen e një gruaje, e cila kishte edhe një fron madhështor, apo se ai popull adhuronte diellin e jo All-llahun? Kush e mësoi se veprimet që bënin ata ishin prej veprave të shejtanit, i cili po ua hijeshonte atyre sjelljet!? Të gjithë këtë dituri, pupëzës ia kishte dhënë All-llahu xh.sh., ndërsa ne mendojmë se shpezët nuk kuptojnë, ndërkohë që ato ia kthejnë përgjigjen qiellit, gjatë hulumtimit të tyre për ushqim. Kjo është detyra e tyre!

All-llahu i Lartmadhëruar na tregoi se buburrecat kanë gjuhën e tyre dhe flasin. Sikur ne t'a kuptonim këtë gjuhë, do të dinim se çfarë bisedojnë ata. Gjithashtu, edhe pupëzat kanë gjuhën e tyre. Sikur t'a dinim se çfarë flasin ato do të mësonim shumëçka prej mungesave të shumta që ne kemi si qenie njerëzore. Të gjitha qeniet e falënderojnë All-llahun e Lartmadhëruar! Jeta nuk përfshihet vetëm tek njeriu, por ajo i përfshin të gjitha speciet e universit, por ne, nuk dimë gjë për këtë, me përjashtim të disa gjërave të vogla.

JETË, POR E PANJOHUR PËR NE

Kemi jetëra të cilat ne nuk i njohim fare. Ne njohim vetëm ato, për të cilat na ka informuar i Lartmadhëruari. Melekët janë të krijuar prej dritës (nurit). Ne nuk i shohim, e as nuk i dëgjojmë.

Gjithashtu, edhe xhinn-ët janë të krijuar prej zjarrit, por edhe ata ne nuk i shohim, me përjashtim të rastit kur ata shndërrohen dhe marrin formën materiale.

I Lartësuari, në Kur'anin Kerim, na informoi për shejtanin, duke na thënë:

"Ai (shejtani) dhe farefisi i tij ju sheh, prej nga ju s'i shihni dot ata."

Ne këtu pyesim: Si mund që t'a besojmë jetën (ekzistencën) e atyre llojeve, që ne nuk i shohim?

Përgjigja është: Të pamurit e diçkaje, nuk është i vetmi mjet për të besuar se ai gjësend ekziston. Kemi shumë gjëra të cilat nuk i shohim, por ato ekzistojnë. Ekzistenca e gjësendit nuk mbështetet në njohjen e asaj ekzistence. Për këtë arsye, All-llahu xh.sh., ka dashur që ato të na i zbulojë neve, në mënyrë që të njihemi me ekzistencën e tyre, pasi ne nuk kemi qenë në gjendje t'i njihnim në të kaluarën.

Kur ti vështron me sytë e tu p.sh. një pikë ujë, syri yt nuk sheh aty asgjë. Por sikur atë pikë uji t'a vështroje me mikroskop, atëherë ke për të parë se në atë pikë uji ka jetë, sepse vërehen gjallesa të tjera të ndryshme që lëvizin. Kështu është edhe me gjakun. Në të nuk sheh asgjë, por kur ti e dërgon atë në laborator, do të marrësh dhjetra analiza të tij, (prej elementeve) që ekzistojnë në të, p.sh. rruazat e kuqe, rruazat e bardha, hemoglobina, etj., madje edhe të mikrobeve të cilat hyjnë në trup dhe të lëvizjeve të tyre. Kështu mësojmë se ato janë shumë precize dhe interesante. Të gjitha këto i vërejmë në gjak. Më pas (në bazë të analizave) ne mund të përcaktojmë edhe cilit grup i përket (ai gjak).

Shkenca bashkëkohore na ka dhënë mundësi që ne të mësojmë shumë sekrete të gjithësisë, të cilat nuk i kemi ditur më parë. Çdo ditë ne zbulojmë gjëra të reja, planete ose yje, të cilat, për ne, ishin

inekzistente më parë. A mos vallë këto gjëra u krijuan në momentin kur ne i zbuluam? Përgjigja do të ishte: Jo! Ato kanë ekzistuar para se ne t'i zbulonim, dhe secila e kryente detyrimin e vet në univers.

Mikrobet (viruset), të cilat u njohën së fundi, përmes mikroskopëve shumë të sofistikuar të kohës moderne, gjithashtu kanë ekzistuar me këto cilësi që i kanë edhe tani. Ato shkaktonin sëmundje tek njerëzit, por askush nuk e kuptonte se prej çkaje rënkonin ata njerëz. Kështu u vazhdua, derisa u zbuluan mikroskopët, të cilët i zmadhojnë gjërat me qindra mijëra herë. Pastaj u vërejt se kemi të bëjmë me një jetë të mahnitshme, që për ne ka qenë më parë inekzistente. Jeta ka lindje dhe shumime, ajo ka ligjet e veta. Prej hulumtimeve precize nuk e vërejmë se si ato (viruset) hyjnë në trup dhe shkaktojnë temperatura të larta, të cilat shkaktojnë edhe vdekje.

Rrezet lazër p.sh. i përshkojnë distancat me një precizitet të paimagjinuar. Tani këto i përdorim në bujqësi, kirurgji e në shumë vende të tjera. A mos i solli njeriu këto rreze në univers? Sigurisht që jo. Këto krijesa kanë ekzistuar që nga Ezeli dhe ato e kryejnë detyrimin e tyre me një precizitet të lartë, por ato nuk kanë qenë të njohura për ne, me përjashtim të disa viteve më parë.

DITURIA E ALL-LLAHUT DHE E NJERIUT

Kur Sulejmani a.s. shfaqi dëshirën që t'ia sillnin fronin e Belkizës, ai, tani, ishte i informuar se ajo me ushtrinë e saj e kishte lëshuar vendin e saj për t'u takuar me Sulejmanin. Çfarë u tha ai komandantëve të tij, si prej njerëzve ashtu edhe prej xhinn-ëve?

Le të shohim Kur'anin Kerimin se ç'na tregon për këtë rast:

"...cili prej jush do të ma sjellë mua fronin e saj, para se të vijnë tek unë të dorëzuar (nënshtruar)."

Filloi një garë, midis kryesuesve të dy qenieve (njerëzore dhe xhinn-ëve), se cili do t'ia sillte Sulejmanit a.s., fronin e Belkizës. Ushtria e qenies njerëzore, heshti. Ishte krijesë prej materies tokë, dhe nuk posedonte forcë dhe mundësinë e fshehjes (sikur që mundnin xhinn-ët - shën. i përkth.) e as nuk posedonin shpejtësinë që të shkonin dhe të vinin para ushtrisë së Belkizës. Gjithashtu, edhe xhinn-ët e rëndomtë heshtën. E vetmja krijesë ose qenie që foli, ishte Ifriti. Ai i përkiste llojit të xhinn-ëve. Çfarë tha ai?

Kur'ani Kerim thotë kështu:

"Ifriti ishte prej xhinn-ëve, dhe tha: Unë do t'a sjell atë para se të ngrihesh nga vendi që je (i ulur)..."

Pra, ai i tha Sulejmanit se do t'ia sillte atë (fronin) para se t'a mbaronte mbledhjen. Sa do të zgjaste mbledhja e Sulejmanit? Një orë, dy, apo tri orë? Ajo çka është me rëndësi është se ai i tha se do t'ia sillte fronin, para se të mbaronte mbledhja.

Këtu u paraqit (foli) edhe një tjetër. Por, çfarë tha ai, i cili kishte dituri prej Librit?

Kur'ani na tregon kështu:

"...Unë do t'a sjell ty atë, sa hap e mbyll sytë..."

Unë, do t'a sjell para teje fronin e Belkizës para se t'a mbarosh fjalinë!

Pra, këtu paskemi dituri, që qenia njerëzore e bëkërka për një çast. (Qenia njerëzore) Paska mundësi t'a transferojë një gjë, prej një vendi në vendin tjetër, për pak sekonda. Por duhet të jemi të saktë, kjo dituri nuk i jepet gjithkujt. Ajo dituri është e rezervuar për All-llahun dhe Ai me vullnetin e Tij ia jep atij që do. Pra, këtu kemi të bëjmë me trasferimin e fronit për punë sekondash. Ai e ftoi që të ulet në të, dhe kjo punë ishte e kryer. Pra, froni i Belkizës gjendej në Jemen, ndërsa mbledhja e Sulejmanit mbahej në Sham!

Kjo na shtyn që t'i dorëzohemi çdo gjëje që vjen drejtëpërdrejt nga All-llahu. Neve nuk na lejohet që t'a moho-jmë ekzistencën e as jetën e një gjësendi, për shkak se ne nuk e njohim. Pse? Për arsye se ne kemi me qindra argumente shumë të qarta, për gjëra të cilat nuk i shihnim e as nuk e nji-hnim ekzistimin e tyre, ndërsa ato ishin shumë prezente dhe vepronin në univers.

Kështu është edhe me jetërat (e pjesëve të ndryshme) në trupin tonë, të cilat ne nuk i njohim. Duart, këmbët, gjuha, lëkura dhe të gjitha pjesët e trupit kanë jetë dhe ne besojmë se ato janë

marrë prej nesh. Kjo nënkupton se ne i urdhërojmë, dhe ato na nënshtrohen. Këmbët i urdhëron të nxitojnë për në xhami dhe ato nënshtrohen. I urdhëron për të shkuar në kafe-alkooli dhe ato të nënshtrohen. Duart i urdhëron që të t'a hapin rrugën duke i shtyrë dhe duke i mërzitur njerëzit, dhe ato të nënshtrohen. Ndërsa gjuha, kur flet, gjithashtu dëgjon urdhërin tënd. Kur ti i thua: gënje, ose thuaje të vërtetën, ajo ashtu vepron.

Këto pjesë të organizmit tënd, janë të tuat dhe ti i sundon ato. Ato veprojnë sipas urdhërave të tua. Por e vërteta është se ato kanë jetën e tyre të veçantë. Ato bëjnë tespih, dhe janë besimtare. Ato kanë gjuhë me të cilën flasin. Ato të janë dorëzuar ty dhe ti i urdhëron ato sipas vullnetit tënd. Por, vetëm në këtë botë. Kur të mbarojë kjo jetë, ti nuk do të kesh pushtet ndaj tyre. Në ahiret, nuk do të kesh kompetenca për t'i urdhëruar. Edhe sikur të ndodhë kjo, ato nuk do t'i përgjigjen vullnetit tënd. Por ato do të dëshmojnë (kundër teje), dhe ka prej atyre që do të të mallkojnë për ato që i ke urdhëruar, në mënyrë që të marrësh hidhërimin e All-llahut.

T'a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh.:

" dhe kur ata të arrijnë tek ai (zjarri i xhehennemit), do të dëshmojnë kundër tyre, veshët, sytë dhe lëkurat e tyre, për atë ç'kishin punuar. Ata do t'u thonë lëkurave të tyre: Pse dëshmuat kundër nesh!? Thonë: All-llahu na bëri të flasim, Ai është i cili bëri të flasë çdo send (krijesë)..."

Ai, që ka pasur rastin t'a kryejë obligimin e tij të haxh-it, është habitur, kur ka parë, se të gjithë haxhillarët janë treguar të fortë dhe të shkathët fizikisht, megjithë lodhjet e tyre, bile edhe me atë pak gjumë që bëjnë atje. Ka parë se si të gjithë janë të lëvizshëm dhe entuziastë. Sigurisht që në vendin e tyre kjo lëvizshmëri kaq aktive u mungon, ata nuk e përba-llojnë dot tërë atë lëvizje, edhe pse në shtëpitë e tyre janë më të pushueshëm!!

Kjo ndodh për shkak se këto (pjesët e trupit) nuk dëshirojnë të flenë ose të pushojnë. Por, ato duan që t'iu mbe-tet një kujtim, nga adhurimi i All-llahut xh.sh., prej tyre. Njeriu kur është në këtë vend të shenjtë nuk mendon gjë tjetër, përveç adhurimit të All-llahut xh.sh. Për këtë arsye, organet e trupit dëshirojnë që të mos flenë, për të vetmen arsye, që t'i vazhdojnë lutjet. Ato qëndrojnë vazhdimisht duke e Madhë-ruar All-llahun xh. sh. Ndërsa pjesët e trupit të mohuesve të All-llahut xh.sh., për shkak që të mos bëjnë gabime gjatë të qenurit të tyre të zgjuar, nuk i zgjojnë nga gjumi njerëzit e tillë.

Disa njerëz pyesin se si është e mundur që të flasin organet e trupit? Në një ajet kur'anor thuhet:

"...All-llahu na bëri të flasim, Ai është që bëri të flasë çdo send (krijesë)..."

Pra çdo gjë, që quhet ose emërohet (diçka ose gjësend) në këtë botë, ka gjuhën e vet dhe All-llahu xh.sh. flet me të. Në univers çdo gjë e madhëron All-llahun xh.sh. Do të mbetesh i çuditur në kohën kur do të dëshmojë: lëkura, duart, këmbët, gjuha etj. Secila prej tyre ka gjuhën e vet, që e bën të dallueshme njërën prej tjetrës. Këtë informacion ne e kemi nga mëshira e All-llahut xh.sh. Organet e trupit e njohin njëra tjetrën, dhe këtë shumë bindshëm. Ato kanë gjuhën e tyre të veçantë, dhe posedojnë gjithashtu shifra të veçanta.

Nëse ndodh që një pjesë e lëkurës të shkëputet prej trupit, dhe ne parapëlqejmë që t'a zëvendësojmë atë me një pjesë tjetër të një lëkure të huaj, do të shohim se pjesa e lëku-rës së tjetrit nuk do të jetë e mirëseardhur në trupin tonë. Sikur të pësonim plagë, ose të humbnim një numër të konsideru-eshëm të qelizave nga ndonjë plagë e thellë ose nga zjarri, do të shihnim se si do të solidarizoheshin të gjitha organet e tjera të trupit, për t'a shëruar plagën. Ato angazhohen

secila në ve-tvete dhe bëjnë një thurrje të re në trupit tënd, në vend të së vjetrës. Kjo bëhet për t'a plotësuar humbjen e shkaktuar.

Pra, konstatojmë se të gjitha pjesët e trupit e njohin njëra tjetrën shumë mirë. Ato i largojnë qelizat e huaja duke qenë indiferente ndaj tyre. Kjo lë të kuptojmë se, i Lartësuari All-llah i ka dalluar qelizat midis vete dhe secila ka grupin e vet.

GJITHÇKA QË EKZISTON NË UNIVERS ËSHTË E GJALLË

Le t'a përmbledhim shkurtimisht atë që thamë. Çdo gjë në këtë univers është e gjallë. Gjithashtu, çdo gjë që ekziston e kryen detyrën e vet. Nuk ka materie të vdekur, as bimë, e as kafshë pa jetë (të vdekura). Por ne, nuk e kuptojmë (jetën e tyre). Materia inorganike ka ndjenja, edhe ajo qan. Kur vdes i biri i Ademit, për të qajnë dy tabore. Tabori i sexhdeve dhe tabori i veprave.

All-llahu xh.sh. na ka dhënë shembuj të shumtë në Kur'anin Kerim për llojet e diturive të tjera që ekzistojnë në botë. Buburrecat, pra, e dinin se ai (që po vinte) ishte Sulejmani, gjithashtu e dinin se ai mund t'i shkatërronte ata, së bashku me ushtrinë e tij, gjatë marshimit të tyre ushtarak.

Jeta ekziston në formën e vet, tek secila krijesë në univers. Edhe pse shohim para nesh shkëmbinj të rrënjosur që nuk lëvizin, megjithatë, tek ta ekziston jeta. Gjithashtu (jeta ekziston edhe tek) të gjitha ato krijesa që nuk shohim ose nuk i njohim në univers. Ne tani e kemi të qartë se secila

krijesë e kryen detyrën e vet në univers. Gjithashtu, theksuam se ekzistenca e gjësendit është diçka tjetër dhe njohja e tij është diçka krejtësisht tjetër. Jeta nuk kufizohet vetëm tek njeriu, por ajo shtrihet tek të gjitha llojet e krijesave në univers.

Por shtrohet pyetja: a është (vetëm) kjo jetë, të cilën All-llahu xh.sh. e dëshiron për ne?. Pra, jetën e kësaj bote, apo kemi një jetë tjetër, përveç kësaj jete, atë të cilën e ka synim All-llahu i Lartësuar, Zoti i botërave.

Këtë do të mundohemi, në emër të All-llahut, t'ua sjellim në kapitullin vijues.

KAPITULLI I TRETË
Ç'ËSHTË VDEKJA

Para se të fillojmë bisedën rreth vdekjes, e shoh të domosdoshme të theksojmë dhe të vemë në pah se 'jetë' tek All-llahu, nuk është vetëm jeta e kësaj bote, por, tek Ai, është edhe bota e ahiretit. Kur All-llahu i Lartmadhëruar e krijoi njeriun, Ai i fryu atij prej Shpirtit të Tij. Kjo dhuratë konsiderohet e përhershme. Kjo jep të kuptohet se secili që ka lindur ose që ka ardhur në këtë jetë, do të mbetet përgjithmonë - në amshueshmëri. Ai do të jetë në xhennet ose në xehennem (All-llahu xh.sh. na mbroftë prej tij). Kështu është edhe me fëmijën që sapo ka filluar t'a shijojë jetën dhe vdes duke qenë foshnje. Edhe ky do të ringjallet në xhennet. Ky është i privi-megjuar, sepse do t'i marrë me vete prindërit e tij në xhe-nnet.

Pra, kur All-llahu i Lartësuar i fryu njeriut prej Shpirtiti të Tij, i dha atij përjetësinë. Ai jeton në këtë univers, jetën e kësaj bote, për disa ditë ose vite (dekada), dhe më së fundi vdes. Më pas, ai ringjallet dhe jeton jetën e tij të përhe-rshme, në ahiret. Atë jetë do t'a jetojë sipas rezultateve të arritura në këtë botë. Sipas asaj, se e ka ndjekur apo jo progra-min e All-llahut apo programe të tjera, ai ose do të shpërblehet ose do të ndëshkohet.

Këtë, më së miri, e përshkruan Kur'ani Kerim, në të cilin All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

" ...dhe vërtet, (jeta e) botës tjetër është jetë. Sikur ata t'a dinin këtë."

Kjo do të thotë se bota e ahiretit është jeta e vërtetë, të cilën do t'a jetojë njeriu, ndërsa jeta e kësaj bote, sado që njeriu të jetojë në të, është e kufizuar. Kjo është jeta eksperti-mentale-sprovë e njeriut. Këtu nuk ka përjetësi.

I Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"...përgjigjuni (bindshëm) All-llahut dhe të Dërguarit Tim kur ju thërret, meqë iu ngjall juve..."

Përshkrimi i tillë është për besimtarët. I Lartësuari u ligjëron atyre, duke qenë të gjallë. Si mund t'iu thuhet 'meqë iu ngjall juve', ndërkohë që këta janë të gjallë?

Ju themi se kjo botë nuk është jeta e amshueshme, të cilën All-llahu xh.sh. e ka caktuar për njeriun, por kjo është ngrehinë ekpserimentale. Në të njeriu eksperimentohet ose sprovohet përmes programit të All-llahut. Nëse i plotëson ku-shtet, pra, nëse korr sukses, do të hyjë në xhennet. Por, nëse nuk e frenon veten nga pasionet dhe bën mëkate, do të hyjë në zjarr.

I Lartësuari All-llah, çdo gjallesë të gjallë në këtë botë e quan të vdekur, ndërsa kuptimi i fjalës 'i vdekur', do të thotë se do të përfundojë kushtimisht në vdekje. Për këtë, i Lartma-dhëruari, i ligjëron të dërguarit të Tij, Muhammedit s.a.v.s., duke i thënë:

" Pa dyshim, ti je i vdekur (vdekshëm) dhe ata, gjithashtu, janë të vdekur (vdekshëm)."

Kjo thënie i është dedikuar të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. dhe shokëve të tij duke qenë të gjallë. Si mund të kuptohet kjo këshillë e All-llahut xh.sh., se ata janë të vdekur? Për arsye se ky do të jetë përfundimi i tyre. Njeriu prej momentit që lind dhe fillon jetën e tij, përballet me vdekjen. Vdekja vazhdon t'a ndjekë të zotin e vet derisa t'i vijë exheli dhe kështu t'a kryejë detyrimin e pjesës së vet.

Vdekja nuk është bazamenti botës (universit), ajo duhet të konsiderohet si etapë e kapërcyeshme. Ne, në botën e atomeve (si substancë) ishim të vdekur, pastaj erdhëm në këtë botë, të gjallë. Pastaj do të vdesim përsëri dhe kështu, edhe një herë, do të ringjallemi.

I Lartëmadhëruari thotë kështu në Kur'anin Kerim:

" Si po e mohoni All-llahun, kur ju ishit të vdekur, pastaj Ju dha jetë, pastaj do t'iu vdesë, pastaj përsëri tek Ai do të ktheheni."

Këto janë etapat e jetës të cilat i kalon çdo njeri. Ato janë të ndara në katër stade:

- Vdekja në botën e atomeve-Dherrit
- Jeta në këtë botë
- Vdekja në jetën e Berzahit (varr-it)

- Jeta e përjetshme, amshueshmëria në xhennet ose xhehennem.

Në ditën e Gjykimit do të vijë vdekja, dhe do t'ia marrë shpirtin vetes së vet. Ajo do të flijohet, ashtu si na ka treguar i dërguari i All-llahut s.a.v.s., në thënien e tij të shkëlqyer – hadithin sherif:

" Do të vijë vdekja në Ditën e Gjykimit në formën e dashit dhe do të flijohet. Pastaj do të thërrasë thirrësi përpara All-llahut të Lartmadhëruar: O ju banorët e xhennetit, jetë të amshueshme pa vdekje dhe o ju banuesit e zjarrit, jetë të amshueshme pa vdekje"

Pra, edhe vdekja paska përfundimin e vet. I Lartma-dhëruari All-llah do t'iu thotë banuesve të xhennetit:

"Në të (xhennet) nuk do t'a shijojnë vdekjen, përveç vdekjes së parë (të kësaj bote) ndërsa ata do t'i ruajë (All-llahu) prej dënimit të xhehennemit."

Kështu pra, kuptuam se edhe vdekja ka fundin e vet. Ndërsa jeta do të mbetet e përhershme në amshueshmëri. Jeta pra, është bazamenti i universit ndërsa vdekja vetëm sa kapë-rcen nëpër të.

JETA NË VARR

Kur të vijë Exheli, d.m.th., të vijë ora ose momenti i agonisë, atëherë kemi "jetën" në varreza. Kjo etapë përfundon me ringjallje. Sikur të jemi të mprehtë apo njohës të mirë, do t'a kuptonim se kemi të bëjmë me një kohë shumë të shkurtër, e cila nuk krahasohet me këtë jetë. Ajo (koha),

pasi të jemi mbledhur në Ditën e Ringjalljes, nuk ka të bëjë aspak me (kohën që kemi pasur në) këtë jetë.

Kur'ani Kerim, na e sparon shumë qartë, kur All-llahu xh.sh. e shprehu këtë me fjalën 'vizitorë'.

I Lartësuari thotë:

"Garimi për grumbullim (të pasurisë etj.) ju ka hutuar, (mjerisht kështu vazhduat) derisa vizituat varrezat (u bëtë të vdekur)"

Çka do të thotë se njeriu në varreza është vetëm vizitor? Kjo do të thotë se ai aty nuk qëndron përgjithmonë. Përderisa është vizitor e nuk qëndron aty, vizita nënkupton një periudhë kohore të shkurtër, e cila ka fundin e vet. Periudha e vizitës do të mbarojë në Ditën e Tubimit. Sipas kësaj, vdekja kuptohet të jetë transferim prej një ligji në një ligj tjetër të ndryshëm nga ai që ishim më parë. Njeriu gjatë jetës së tij, është vetëm një trup material, por me vdekjen e tij, trupi kthehet përsëri në tokë, pastaj ai trup, në Ditën e Gjykimit, do t'i kthehet përsëri pronarit të vet.

Vdekja fillon që nga momenti i agonisë. Fjala 'agoni' nënkupton momentin kur liria e zgjedhjes së individit ka përfunduar. Njeriu pra, në jetën e tij në këtë botë, ka mundë-sinë e përzgjedhjes. Ka mendjen, me të cilën zgjedh kur i ofrohen alternativat. Por, në një çast, atij i ndërpriten këto mundësi. Atij i përfundon koha e përzgjedhjes. Atij dikur i mbaron koha eksperimentale dhe jeta e provimit dhe sprovave. Atij i fillon një etapë tjetër e re, aty ku nuk ka mundësi të përzgjedhë. Atë tani e pushton jeta e detyruar. Njeriu në momentin e agonisë, e kupton bindshëm se ka vdekur. Ai, në ato momente, do t'i shohë melekët. Ai do të shohë krijesa të reja të All-llahut, të cilat i ishin të panjohura më parë.

Le t'a lexojmë thënien e All-llahut xh.sh. në Kur'anin Kerim:

"(Përgënjeshtruesit do t'i thuhet) Vërtet, ishe i pavëme-ndshëm ndaj kësaj (momentit të vdekjes). Ndërsa sot (në ahiret) të kemi hequr perden tënde (të të pamurit), dhe shikimin e ke shumë të qartë."

Në këto momente përjashtohet jeta njerëzore, sepse atij tani i përcaktohet përfundimisht fati i tij. Ai, tani, do t'a dijë saktësisht se a do t'i përkasë banorëve të xhennetit apo të xhehennemit. Ai do të shohë ose melekët e mëshirës, ose melekët e ndëshkimit. Këto informacione i kemi nga i Lartësuari All-llah, në librin e Tij të mrekullueshëm, kur Ai iu flet banuesve të xhennetit, në momentin kur do t'u paraqitet vdekja.

I Lartmadhëruari thotë:

"Atyre (njerëzve) që ua gjejnë shpirtrat e pastër, ua marrin melekët duke ju thënë: Selamun Alejkum (Shpëtimi qoftë mbi ju), hyni në xhennet në saje të asaj që keni punu-ar."

Nga kjo mësojmë se besimtarët konsiderohen si pronarë të veprave të mira, prandaj, në momentin e agonisë, ata do t'i shohin melekët e mëshirës. Shfaqja e këtyre mele-këve për këta njerëz, është sihariq se janë prej banuesve të xhennetit. Kjo jep të kuptohet se atyre iu shpalosen sekretet, pra, atyre ju shkon buza në gaz, sepse e kuptojnë se janë duke udhëtuar për në vende më të mira nga ç'ishin. Kur vdesin këta njerëz, i sheh të hijshëm dhe buzagaz, ata duken se po ikin të qetë, të sigurtë. Kjo fytyrë e bukur lë të kuptohet se këta ishin të kënaqur me premtimin e All-llahut, i Cili nuk e ndryshon kurrë premtimin e Vet.

Ndërsa ata të cilët ishin mohues, që silleshin me arro-gancë, që mëkatonin duke i bërë shok All-llahut dhe e luftonin fenë e Tij, takimi i të tillëve me vdekjen është i ndryshëm.

Për këtë, na informon Kur'ani Kerim:

"(O Muhammed, sa vështirë do t'a kishe) sikur t'a shihje (tmerrin dhe frikën) kur melekët ua marrin shpirtrat femohuesve, duke i goditur nga para, e nga prapa dhe (duke ju thënë: tani) Shijojeni ndëshkimin e zjarrit."

Në adresë të mohuesve të All-llahut, i Lartmadhëruari na jep, gjithashtu, edhe një përshkrim tjetër.

Ai, në Kur'anin Kerim, thotë:

"...po t'a dije (o Muhammed) se në ç'gjendje janë zullumqarët gjatë agonisë së vdekjes, dhe kur melekët ua zgjasin duart (për t'ua nxjerrë shpirtin me ashpërsi dhe ashtu të tmerruar ju thuhet): Nxirrni shpirtrat tuaj! Sot do të pësoni ndëshkimin poshtërues, për shkak të pavërtetësive tuaja që i keni thënë në drejtim të All-llahut, gjithashtu ishit mendjemëdhenj (dhe tallës) ndaj argumenteve të Tij."

Kështu pra, nga ky ajet kur'anor kuptojmë se, ashtu sikurse besimtarët që do t'a shohin fatin e mirë të tyre në xhennet gjatë momentit të agonisë, po ashtu edhe femohuesit do t'a shohin fatin e tyre të keq duke u dënuar në zjarr, kur të jenë në momentin e agonisë. Bile, melekët e ndëshkimit i urojnë "mirëseardhje" femohuesve për ndëshkimet që ata i kanë merituar. Ata do t'i godasin si nga para, ashtu edhe nga prapa trupit të tyre. Kështu që ata, në këtë formë, do t'a ndiejnë dhe shijojnë dhembjen e xhehennemit. Nëse fejohuesi ka qenë prej njerëzve të famshëm, ka qenë

personalitet i njo-hur për pasuri materiale, ose për ndonjë arsye tjetër, ata (mele-kët) do të grumbullohen tek ai, për t'ia nxjerrë shpirtin me vra-zhdësinë më të madhe, që edhe në këtë moment t'a ndiejë dhe-mbjen. Ai do të përpiqet që të mos t'i dalë shpirti, por nuk do të mundet, sepse nuk ka as mundësi, e as forcë të duhur për t'i penguar.

Në këtë moment, liria e zgjedhjes e individit mbaron, ai tani do të marë statusin e të detyruarit, sikurse edhe llojet e tjera në univers. Ai kishte një status shumë të begatë, në jetën e kësaj bote (botës sonë). Një prej shenjave së përmbylljes së keqe (lusim All-llahun që të mos jemi prej tyre), është se do t'i shohësh femohuesit (qafirët ose mizorët) se si u shprishet fyty-ra, se si u deformohet trupi dhe se si u humb shkëlqimi prej vuajtjeve të dënimit, që ai është duke përjetuar në ato momente.

I Dërguari s.a.v.s. i All-llahut, i këshillonte shokët e tij, duke ua tërhequr vëmendjen dhe duke përshkruar përfundimin e atyre njerëzve që i përkasin këtij lloji. Ai iu thoshte:

O ju njerëz,

"Ju keni shenjat dhe përfundojeni jetën tuaj duke i përcjellë ato shenja, ju, gjithashtu, keni përfundimin tuaj dhe përmbylleni këtë përfundim tuajin. Pa dyshim, besimtarët janë midis dy momenteve të frikshme. Midis exhelit të kaluar, me të cilin nuk di se çfarë All-llahu ka përgatitur për të, dhe midis exhelit të mbetur, që gjithashtu nuk e di se çfarë të kaluar kishte. Le t'a përgatisë robi veten e tij në atë mënyrë, sa të duket se është vetja e tij, që prej botës së tij deri në përfundim . Kemi prej atyre që thinjen para pleqërisë dhe prej tyre që e përjetojnë para vdekjen. Pasha Atë në dorën e të Cilit është fryma (nefsi) i Muhammedit, pas vdekjes nuk ka kthim në vuajtje, dhe gjithashtu pas kësaj bote nuk ka derë tjetër, përveç të xhennetit ose të xhehennemit".

Në momentin e agonisë, ashtu siç na e ka përshkruar All-llahu xh.sh. në Kur'anin Kerim, do të na largohet perdja, do të na hiqen të gjitha pengesat dhe do të mundemi të shohim më qartë, sepse do të na shpaloset gjithçka që na ishte e panjohur.

Këtë e vërtetojmë me thëniet e All-llahut në Kur'an:

"Përse atëherë, kur t'iu vijë shpirti në fyt, e ju jeni duke e shikuar. (Dijeni) Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju atë nuk e shikoni."

Në këtë moment fillon etapa e parë e jetës së ahiretit, sepse për të që vdes, kijameti ka ndodhur dhe ai do t'a njohë jetën tjetër (ahiretin e tij). Kur të vdesë, ai dëgjon, por nuk është në gjendje të përgjigjet. Ai sheh, por nuk është në gje-ndje të transmetojë se çfarë është duke parë. Ai, gjithashtu, kupton njëlloj sikurse kuptojnë të gjallët.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë:

"Kur t'i vizitoni varrezat, përshëndetini banuesit në atë vend, duke ju thënë: Selamun alejkum, o ju shtëpi të njerëzve besimtarë."

Përderisa i Dërguari All-llahut s.a.v.s. na ka urdhëruar për këtë, aty, detyrimisht, ka njohje. Të gjithë ata që banojnë aty, pra në varreza, e kuptojnë këtë përshëndetje, pasi përndry-she, Muhammedi s.a.v.s nuk do të na kishte urdhëruar për këtë.

Pra, banuesit e varrezave i dëgjojnë vizitorët dhe e ku-ptojnë selamin e tyre, sepse ai iu atribuohet atyre. Kemi edhe një njohje tjetër, me anën e mendjes, e cila i bën ata t'a dallo-jnë të mirën dhe të keqen, apo shpresën dhe dëshpërimin.

I Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"O ju që keni besuar, mos u miqësoni me ata njerëz prej të cilëve All-llahu është i zemëruar. Ata i kanë humbur të gjitha shpresat për botën tjetër, ashtu siç i kanë humbur shpresat pabesimtarët që kanë vdekur. (që të shpresojnë se s'do të ringjallen në Ditën e Gjykimit)."

Meqenëse kanë arritur këtë shkallë të dëshpërimit, atyre me siguri iu është mundësuar që të mendojnë dhe të ko-nceptojnë diçka. Përndryshe, ata nuk do të dinin të dëshpë-roheshin ose t'i përjetonin ato ndjenja, përveçse me dhënien e mundësisë për t'i dalluar gjësendet. Sepse ata, në ato momente, që përndryshe kuptohen se janë momente shprese, ata e ndiejnë këtë dëshprim.

All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë:

"ashtu siç i kanë humbur shpresat pabesimtarët që kanë vdekur. (që të shpresojnë se s'do të ringjallen në Ditën e Gjykimit)".

JETA NË BERZAH E PËRJASHTON KOHËN

Pra jeta e Berzah-it, në brendinë e saj ka të konceptuarit, të cilën e njeh vetëm i vdekuri. Jeta në varreza nuk ka të bëjë aspak me kohën. Për këtë arsye, kur njeriu, prej jetës së tij të parë në këtë

botë, futet në varr, do të vazhdojë të qëndrojë aty deri në Ditën e Kijametit (Kataklizmës). Ai, për këtë periudhë kohore që do të qëndrojë në të (në varreza), do të mendojë se ka qëndruar një ditë, ose diçka prej saj. Për këtë, i Lartësuari na ka dhënë një shembull konkret, që është shembulli i tregimit të banorëve të shpellës. Atyre (All-llahu) iu kishte mundësuar të flinin 309 vjet, dhe kur ata u zgjuan, pyetën veten:

I Lartmadhëruari na rrëfen kështu, në Kur'anin Kerim:

"Dhe kështu Ne i zgjuam ata , që t'a pyesnin njëri-tjetrin. Njëri prej tyre tha: "Sa kohë kemi këtu (në gjumë?)"- U përgjegjën: "Mbase kemi qëndruar një ditë, apo një pjesë të ditës..."

Pse thanë, paskemi fjetur një ditë apo një pjesë të ditës? (Thanë kështu pasi) Ata kishin shikuar fytyrat e njëri-tjetrit, gjithashtu edhe rrobat e tyre, që ishin të pandryshuara ashtu si (ditën kur) ishin futur në shpellë. Por nëse ata do të ishin zgjuar dhe do t'i kishin thonjtë të gjata, mjekrat e zgjatura dhe të bardha, gjithashtu edhe fytyrat (e mplakura) gjëra të cilat do të kishin dhënë shenja të qëndrimit të gjatë me vite të tëra, ata nuk do të kishin thënë se kemi qëndruar në të (shpellë) një ditë, ose një pjesë të ditës. Pra, kjo vë në pah se, ky treqindvjeçar, për ta, ka qenë jashtë kohës, sepse atyre nuk iu kish lënë kurrfarë shenje kjo periudhë kohore.

Kështu është edhe me banuesit e varrezave. Ata do të zgjohen në atë formë, në të cilën janë varrosur. Foshnja kur të vdesë, nuk do të ringjallet në moshë të plakur, sado që do të qëndrojë (në varreza) për shumë vite.

Për këtë arsye, i Lartmadhëruari do t'i pyesë, duke iu thënë:

"Thotë: "Sa vjet qëndruat në tokë (jetuat në këtë botë)?". Do të përgjigjen: Qëndruam një ditë ose një pjesë të ditës. Pyeti numëruesit (ata që mbajtën llogarinë)."

Nga ky shpjegim mund t'i kuptojmë ligjet e jetës së Berzah-it. Kjo (jetë) nuk ka të bëjë aspak me kohën, sepse nuk jep shenja të jetës njerëzore. Ata (njerëzit në Berzah) jetojnë jashtë kohës.

Por shtrohet pyetja: a ekziston për banuesit e varrezave dënimi? Përgjigja është: nuk ka dënim para marrjes në pyetje. Por, ndërsa njeriu është në varr, ai sheh se si është përgatitur vendi i tij në zjarr, ose në xhennet. Kjo është nga mirësitë e All-llahut për besimtarët (që t'a kuptojnë) se janë të shpëtuar nga zjarri i xhehennemit. Ata do t'a kuptojnë këtë mirësi kur t'a vërejnë se janë larg zjarrit dhe, gjithashtu, kur t'i shohin begatitë e xhennetit. Atje do të shihet dallimi ndërmjet të mirës dhe të keqes, ndërmjet njeriut besimtar dhe atij mizor, ndalimi i tij nga këto begati dhe destinimi i tij për dënimim e dhembshëm.

Besimtari e ndien mirësinë dhe mëshirën e All-llahut xh. sh., që e shpëtoi prej zjarrit, atij i zgjerohet kraharori dhe ai e kupton madhështinë e All-llahut dhe begatinë që Ai ka përgatitur për të.

I Lartmadhëruari na ka përshkruar se çfarë do të bëhet me familjen apo ithtarët e Faraonit, ndërkohë që ata do të jenë në varreza.

I Lartësuari thotë:

"Ata, do t'i paraqiten zjarrit çdo mëngjes dhe mbrëmje, ndërsa kur të vijë çasti (Dita e Kijametit, All-llahu do të urdhërojë): " Futini ithtarët e Faraonit, dhe ndëshkojini sa më rëndë!"

Kur do t'u paraqitet zjarri ithtarëve të Faraonit? A u është paraqitur ai (zjarri) në këtë botë? Sikur atyre t'iu ishte paraqitur vetëm për një moment, ata kurrë nuk do t'a adhuronin Faraonin. Ata sikur t'a dinin këtë, do t'a kishin mbytur vetë Faraonin dhe, me siguri, do ta kishin hedhur vetë në det.

Zjarri nuk iu është paraqitur ithtarëve të Faraonit në këtë botë. Por, a do t'ju paraqitet atyre në ahiret? Përgjigja, gjithashtu, është: Jo, - sepse atje nuk ka paraqitje. (Atje, në ahiret) Ata do të futen në zjarr për t'u dënuar.

Pra, atyre nuk iu është paraqitur zjarri, as në këtë botë, e as në ahiret, pasi atje ata do të hyjnë në të (zjarr) konkretisht.

Në bazë të kësaj që thamë më sipër, na ka ngelur vetëm jeta e Berzah-it, ose jeta në varreza. Ithtarëve të Faraonit do t'u para-qitet zjarri çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje, gjatë jetës së tyre në varreza, ose Berzah. Gjithashtu, shtrohet pyetja: a do të dalin ithtarët e Faraonit dy herë, çdo ditë, për t'iu paraqitur zjarrit? Apo, atyre do t'iu paraqitet zjarri duke qenë në varreza?

Askush nuk mund të prognozojë në diçka të tillë. Me përjashtim se në varr, ekziston njëfarë lloj dënimi që mund t'i paraqitet njeriut duke qenë atje. Por, duhet të dimë një gjë, se: dënimi i vërtetë do të jetë, për secilin, pasi të janë marrë në pyetje në Ditën e Gjykimit. Ithtarëve të Faraonit do t'iu mjaftojë (si dënim në varr) fakti se ata do t'a shohin zjarrin, i cili është në pritje të tyre, për t'i dënuar dy herë në ditë, çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje. Mendoj se ndjenja e pritjes së vuajtjes së dënimit është më e rëndë se vetë dënimi. Duket se ata do të jenë të bindur se do të dënohen në atë zjarr. Për ta është një dënim i dhembshëm, sa herë që ata e vërejnë atë.

Kështu pra, Zoti ynë i Lartmadhëruar caktoi që secili që e kryen misionin e tij në këtë botë, nuk do të kthehet në të për të dytën herë, derisa të ringjallemi.

I Lartmadhëruari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"Derisa, kur t'i vijë vdekja (ndonjëri prej femohuesve, i penduar), do të thotë: "O Zoti im, më kthe (përsëri në këtë botë). Që të bëj vepra të mira, të cilat i kisha lënë pa bërë"- Kurrsesi! Pa dyshim, ai ato i ka vetëm fjalë të kota që i thotë. Nga prapa e kanë Berzah-in, deri në ditën kur do të ringjallen."

Ç'është Berzah-u? 'Berzah' është ndarja midis të gjallëve dhe të vdekurve, me qëllim që njeriu i cili vdes të mos ketë mundësi të kthehet përsëri në jetën e kësaj bote. Kështu edhe dëshmorët (shehidët), kur i përjetuan të mirat e All-llahut, kërkuan nga Ai që të kthehen edhe një herë në këtë botë për t'iu treguar (njerëzve) se ç'kanë parë prej begative dhe mirësive të All-llahut xh.sh. I Lartmadhëruari, iu tha atyre: është shkruar se ai i cili del prej saj, nuk kthehet më në të. Për këtë aryse, i Lartmadhëruari i ka informuar njerëzit për këtë pikë shumë të rëndësishme: - për vendin e veçantë të mreku-llueshëm të besimtarëve dëshmorë.

VETËM AI JEP DHE MERR JETË

All-llahu i Lartësuar është Krijues i vdekjes dhe jetës, prej së cilës kuptojmë se i Lartmadhëruari është i Vetmi i Cili e shndërron njeriun prej të gjallit në të vdekur dhe prej të vdekurit në të gjallë.

Për këtë arsye, emrat e Tij të Lartma-dhëruar e emërojnë All-llahun me emrat- Gjallëruesi dhe Vde-kjeprurësi. Ibrahimi a.s. ka thënë (ne, një pjesë të tregimit të tij, do t'a sjellim ashtu siç na e ka treguar i Lartësuari në Kur'anin Kerim):

"Vërtet, ata janë armiqtë e mi, përveç Zotit të botëve; i Cili më krijoi mua dhe vetëm Ai do të më udhëzojë (përudhë); dhe i Cili më ushqen dhe më jep për të pirë; dhe kur të sëmurem, vetëm Ai më shëron; dhe i Cili do të më bëjë të vdes, e pastaj do të më ringjallë; dhe nga i Cili shpresoj të m'i falë mëkatet e mia Ditën e Ringjalljes."

Në këto ajete kur'anore vërejmë se All-llahu i Lartësuar i ka sqaruar fare mirë thëniet e Tij për të mos lënë dyshime, sepse kemi njerëz që për disa gjëra mendojnë ose pretendojnë se kanë gisht në to (varen prej tyre). Ndërsa, për ato gjëra për të cilat njeriu nuk duhet të pretendojë se varen prej tij, i Lartësuari na ka sqaruar duke na treguar ngjarjet.

Ibrahimi a.s.thotë: - i Cili më Krijoi mua... - sepse askush nuk mund të pretendojë se është krijues. Ndërsa thënia tjetër: - Ai do të më udhëzojë, - përmban në vete një përemër të veçuar, i cili është vërtetues ose përforcues, sepse kemi disa (njerëz), të cilët pretendojnë se janë "udhëzues", e në realitet janë shtrembërues të së vërtetës. Ata veprojnë kështu sa për të pasur pasues për qëllimet e tyre meskine. All-llahu xh.sh. nuk e la këtë përemër të veçuar të ketë lidhje të drejtëpërdrejtë me emrin e Ibrahimit a.s.. Ai nuk tha: Ai i Cili më krijoi mua, por tha: i Cili më Krijoi mua. Këtu shohim se krijimi është nën kompetencat e drejtpërdrejta të All-llahut të Lartmadhëruar. Në anën tjetër, shohim se përemri është prezent në thënien e Ibrahimit a.s., kur ai tha: - është Ai i Cili më ushqen mua dhe më jep për të pirë - këtu kemi përemrin (Ai), sepse këtu

kemi të bëjmë edhe me ndërhyrjet e veprimeve të njerëzve ndaj qenieve të gjalla p.sh. kërkesat për t'iu dhënë njerëzve ushqim për të ngrënë, ose ujë për t'a pirë.

Pastaj kemi thënien e të Lartmadhërishmit: "dhe kur të sëmurem, vetëm Ai më shëron" këtu, gjithashtu, e kemi përemrin, për arsye që të mos pretendojë askush se mjeku është ai i cili shëron. E vërteta është krejtësisht tjetër. Mjeku jep kurën. Ndërsa ai i cili shëron është All-llahu xh.sh. Mjeku mund të ndodhë të jetë një prej shkaktarëve të vdekjes (të pacientit), sepse mund t'i japë të sëmurit barin ose injeksionin e gabuar, duke menduar se ai do t'a shërojë atë dhe bëhet kështu shkaktar i vdekjes së tij. Për këtë arsye, i Lartësuari, e vërtetoi këtë me përemër të veçuar, për arsye, siç thamë, të përforcimit. Ai tha: "vetëm Ai më shëron."

Por, kur erdhi tek thënia rreth vdekjes dhe jetës, nuk kishte nevojë t'a përdorte përemrin përforcues. Ai tha: "dhe i Cili më vdes mua, pastaj më ngjall" Pse? Për shkak se vdekja dhe jeta janë nën kompetencat e drejtëpërdrejta vetëm të All-llahut xh.sh. dhe askush nuk mund të pretendojë (për pjesëmarrje) në këtë veprimtari.

NEMRUDI SI "VDEKJEPRURËS DHE JETËDHËNËS"

Kur'ani Kerim na transmeton tregimin e Nemrudit, personit që All-llahu xh. sh. i kishte dhënë pushtet të madh. Në vend që të ishte falënderues, të sillej mirë dhe të ishte mirënjohës për të mirat që i kishte dhënë i Lartësuari, ai ishte vetëdashuruar me vetveten e tij dhe ishte mashtruar

pas kësaj bote. Ai pretendonte se edhe ai u jepte njerëzve jetë dhe vdekje. Le të lexojmë thënien e All-llahut xh.sh.:

"A nuk e pe atë që polemizoi me Ibrahimin për Zotin e tij (All-llahun): sepse All-llahu atij (Nemrudit) i kishte dhënë pushtet. Kur Ibrahimi tha: "Zoti im është Ai që jep jetë dhe sjell vdekjen".Ai tha:"Unë gjithashtu ngjall dhe vdes". Ibrahimi pastaj i tha: "All-llahu sjell diellin prej lindjes, pra, sille ti prej perëndimit". Atëherë, ai i cili kishte mohu-ar, mbeti i hutuar, sepse All-llahu nuk i udhëzon keqbërë- sit. "

Për t'a justifikuar thënien e tij, Nemrudi urdhëroi që t'i afrohej njëri prej gardës së tij. Pastaj urdhëroi që atë t'a vritnin. Me këtë shembull, ai deshi t'iu tregojë të pranishmëve se me atë urdhër ai e mbyti atë (pra, se jep vdekje)!! Në momentin e ekzekutimit tha: Lirojeni, e kam falur. Me këtë urdhër ai shprehu ngjalljen e tij (pra, se jep jetë)!!

Atij i themi se ai nuk i ka dalluar këto dy ngjarje, nuk i ka dalluar veprimet midis vdekjes dhe vrasjes. Mbytja nuk është vdekje, por është shkatërrim i trupit derisa të dalë shpirti prej tij. Shpirti nuk rri në trupin e shkatërruar, ai qëndron në trup të shëndoshë, me disa premisa të veçanta. Për këtë, All-llahu xh.sh., për të dërguarin e Tij s.a.v.s. thotë:

"Muhammedi s'është tjetër veçse i dërguar. Por, edhe para tij ka pasur të dërguar. Në qoftëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheshit prapa!? Kushdo që të kthehet prapa (në injorancë dhe fe të gabuar), All-llahut nuk i bëjnë kurrfarë dëmi, ndërsa All-llahu do t'i shpërblejë falënderuesit."

Pra, vdekja ndryshon nga vrasja. Vdekje do të thotë kur shpirti del prej trupit pa ndonjë imponim dhe në qetësi. Këtë lloj vdekje nuk e bën askush përveç All-llahut xh.sh. Ndërsa vrasjen,

njeriu ka mundësi që t'a bëjë me ndonjë mjet të mprehtë ose me plumb. Në të dyja rastet, shpirti do të dalë nga trupi. Në rastin e parë (pra, në vdekje) shpirti del nga trupi me qetësi të plotë. Ndërsa, (në rastin e vrasjes) së pari, do të shkatërrohet ndërtimi strukturor i trupit, pastaj do të dalë shpi-rti. Pra, që të dy: si ai vdekuri, ashtu edhe ai i vrari do të ri-ngjallen, ose do të dalin në Ditën e Tubimit.

"Sikur të vdisni ose të vriteni, ju me siguri tek All-llahu do të tuboheni."

Nga kjo mësojmë se cilido të jetë përfundimi i njeriut, qoftë i vrarë, qoftë i vdekur, ai do të dalë në Ditën e Kijametit para All-llahut xh.sh. Ashtu siç thamë, jeta është antinomi i vdekjes, dhe gjithashtu vdekja është antinomi i jetës. Për këtë arsye, këto dyja nuk bashkohen në asnjë pikë të vetme, kështu pra, kemi ose jetë, ose vdekje.

Për këtë, i Lartësuari, thotë:

"I Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se kush prej jush bën punë të mira; - Ai është i Plotëfu-qishëm dhe Falës."

Jeta, thuajse, është eksperimetale. Pas saj vjen vdekja dhe fillojnë etapat e tjera të ahiretit, e deri tek marrja në pyetje – llogaria. All-llahu xh.sh., momentin e vdekjes, e ka mbajtur sekret prej nesh. Atë nuk e di askush, dhe askush nuk e di se kur do të paraqitet ajo.

I Lartësuari, për këtë, thotë:

"...e askush nuk e di se çfarë do të fitojë nesër, gjithashtu askush nuk e di se në ç'vend (të botës) do të vdesë. Vërtet, All-llahu është i Gjithëditur dhe njohës i çdo gjëje."

Fshehja e vdekjes është një prej Urtësive të Tij të mëdha. Së pari, njeriu e pret vdekjen në çdo moment të jetës së tij. Pritja e tij, në çdo çast, konsiderohet si lajm i vdekjes. Ti pra, je i vetëdijshëm se mund të vdesësh në orën e ardhshme. Kjo bën që ti t'i përshpejtosh gjërat dhe t'i përbyllësh më mirë. Këtë e bën nga frika se mos po të vjen exheli dhe mbetesh vetëm me pak vepra të mira që i ke bërë. Kështu, kjo pritje të ndalon prej veprave të këqija, nga frika se mos po të shkatërrohet (po merr fund) jeta dhe se nuk do të kesh kohë për pendim. Pra, se mos të kap vdekja në flagrancë (duke kryer mëkat).

Pra, fshehja e exhelit apo e momentit të vdekjes, është një prej urtësive më të mëdha. Ajo, në të njëjtën kohë, shërben si nxitësi më i madh për vepra të mira dhe për largimin nga veprat e këqija apo nga mëkatet. Kjo e përgjithëson mirësinë në univers dhe, njëkohësisht, e vret të keqen.

Pra, duhet të jesh i bindur: Nuk ka shkaktar për vdekjen pa caktim (exhel). Mos i beso sëmundjes që të vdes, ose plumbit që të vret, se mund të ndikojë në vdekjen ose caktimin tënd (exhelin), e as të ndonjë njeriu në këtë jetë. Ndodh që kur njeriu sëmuret, vetëm me një aspirinë ose me një gotë çaj t'a shërojë atë (sëmundjen), sepse është caktuar që të jetojë edhe më tutje. Por ndodh që të sëmurit t'i qëndrojnë mbi krye me dhjetëra mjekë në spital, ose i tërë ekipi mjekësor të përkujdeset për të, por pa sukses, sepse atij i ka ardhur momenti i vdekjes (exheli). Kjo për arsyen se vdekja është prej caktimeve të All-llahut, dhe caktimet e All-llahut nuk mund t'i zmbrapsë askush.

I Lartësuari thotë:

"Thuaj: Unë nuk zotëroj asgjë për t'i bërë dobi e dëm vetes sime, me përjashtim të asaj që All-llahu ka shprehur në vullnetin e Tij. Çdo popull e ka fundin, kur t'i vijë ai fund, nuk ka mundësi

askush t'a shtyjë atë, qoftë edhe për një çast, gjithashtu, nuk ka mundësi as ta përshpejtojë (këtë caktim-fund)."

Mos e lodh veten me shkaktarët e vdekjes, sepse vdekja, kur e ka ditën e saj, vjen me të gjitha shkaqet e mundshme në univers. Askush nuk ka fuqi për t'a penguar atë. është pyetur Aliu, i biri i Ebu Talibit r.a.: A e ke frikë vdekjen? Ka thënë: Jo. Në momentin kur ajo të vijë, askush s'e ndalon dot. Gjithashtu, askush nuk mund t'a përshpejtojë atë nëse nuk e ka kohën e vet.

Shkaktarët që sjellin vdekjen, si p.sh. sëmundja, pleqëria, e të tjera, të gjitha këto janë shkaqe jo reale, që nuk kanë të bëjnë me të vërtetën. Kur të vijë vdekja, nuk ka nevojë për shkaktarë. Por, detyra jonë është të themi: ai vdiq se i erdhi momenti i caktuar (exheli). I Lartmadhëruari thotë:

"Kudo që të ndodheni, vdekja do t'iu kapë, madje qofshit edhe në kështjellat më të fortifikuara (në siguri të plotë) ..."

Tani, shkurtimisht, t'i përfshijmë ato se ç'thamë në këtë kapitull. Jeta dhe vdekja janë dy paralele të kundërta njëra me tjetrën, ato nuk takohen midis tyre. All-llahu ia ka ndaluar njeriut përjetësinë në këtë botë. Vdekja është momenti kalimtar ose transformuesi i jetës. Vdekja do të përfundojë pasi të vetëflijohet në Ditën e Kijametit.

Njeriu do të jetë i përjetshëm në univers, ai do të jetojë ose në xhennet ose në xhehennem (All-llahu na mbroftë prej tij). Jeta në varreza ka një lloj të kuptuari. Për këtë arsye edhe duhet t'i përshëndesim të vdekurit kur u bëjmë vizitë atyre në varreza. Femohuesit i humbin shpresat në mëshirën e All-llahut. Derisa janë në varreza, ata janë jashtë ndikimeve kohore, prandaj nuk e ndiejnë atë. Përjetojnë diçka, sepse janë dëshmitarë të dënimit. Për njeriun, me vdekjen

përfundon gjithçka, përzgjedhja që ishte dhurata e fundit nga All-llahu xh.sh. për të, mbaron në këtë etapë. Shenja e përmbushjes së misionit të tij në këtë botë është momenti i agonisë së tij. Ky moment tregon për mbarimin e kohës së zgjedhjeve midis alternativave të tij. Gjithashtu, edhe koha e eksperimentimit, në këtë moment, është duke iu sosur.

Kur t'i vijë koha e agonisë, besimtarit i paraqiten melekët e mëshirës, ata e përgëzojnë me xhennet. Ai vdes me kraharor të hapur, sepse tani do të rrugëtojë drejt një vendi më të mirë nga ai që ishte. Ndërsa, femohuesit do t'i paraqiten melekët e ndëshkimit. Ai do të goditet nga para dhe prapa. Ata ia përshkruajnë atij shijet dhe dhimbjet e vuajtjeve. Ai do të vdesë me fytyrë të shëmtuar, sepse rrugëtimi i tij do të jetë i keq, krahasuar nga ajo në të cilën ishte. All-llahu është Krijuesi i jetës dhe i vdekjes dhe askush nuk mund të pretendojë se e posedon këtë mundësi. Askush, përveç All-llahut, nuk mund të thotë se është jetëdhënës dhe vdekjeprurës. All-llahu i Lartmadhëruar e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe, gjithashtu, e nxjerr të vdekurin nga i gjalli.

Ne deri tani folëm rreth vdekjes së njeriut. Po si qëndron problemi kur kemi të bëjmë me përjetësinë (amshueshmërinë)!? Cila është e vërteta e kësaj amshueshmërie? Këtë do të mundohemi t'a sqarojmë në kapitullin tjetër, nëse i Lartësuari ka shprehur vullnetin e Tij.

KAPITULLI I KATËRT
NJERIU DHE PËRJETËSIA

All-llahu i Lartmadhëruar e krijoi njeriun të përhershëm. Kjo është një e vërtetë që shumica e njerëzve nuk i kushtojnë vëmendje. Shumë njerëz, jetën e llogarisin vetëm si jetë të kësaj bote. Mjerisht, ky supozim është i gabuar. Jeta e kësaj bote është vetëm një pjesë shumë-shumë e shkurtër e jetës njerëzore. Ky univers, duke patur parasysh në të diellin, hënën, ujin etj., të cilat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut që prej miliona vjetësh, nuk mund të jetojë më shumë se ai, për të cilën janë krijuar (për shërbimin ndaj njeriut). Gjithashtu, nuk mund të llogarisim se jeta e njeriut mbaron vetëm me disa vjet, ose dekada, të cilat ai i kalon së qëndruari në këtë botë. Ajo ka vazhdimësi dhe jeta është e përhershme.

I Lartësuari All-llah, nga vullneti i Tij ka caktuar që njeriu dhe xhinn-ët, të jetojnë përjetësisht. Nuk ka dallim nëse është besimtar apo pabesimtar. Mund të themi se dallimi i vetëm midis tyre është: besimtari do të shpërblehet përjetësisht me xhennet, ndërsa jobesimtari do të shpërblehet, gjithashtu përjetësisht, por në xhehennem.

I Lartmadhëruari ia dhuroi përjetësinë njeriut, atëherë kur i fryu atij nga Shpirti i Tij. Këtë përjetësi, i Lartësuari, me vullnetin e Tij, e ndau në disa etapa:

- Vdekje,
- Jetë,
- Vdekje, dhe

- Përjetësi.

Por çfarë t'i bëjmë injorancës sonë, që shumica e njerëzve llogarit vetëm një etapë, atë të jetës së kësaj bote? I'është e vërteta, jeta e kësaj bote, siç e theksova më sipër, është një pjesë shumë-shumë e shkurtër e udhëtimit të jetesës së gjatë, deri në përjetësi.

Ishim të vdekur në botën e atomeve-Dherrit, më pas vullneti i All-llahut ishte që ne të jetojmë në këtë jetë, pastaj Ai do të na vdesë përsëri. Duke qenë të vdekur ne do të jetojmë jetën e Berzah-ut. Pas kësaj etape, Ai do të na ringjallë përsëri, për të na marrë në llogari. Kjo pjesë e etapës së ringjalljes, do të jetë ajo që do t'a përcaktojë përjetësinë tonë. Ose do të jemi në xhennet ose në xhehennem (All-llahu na mbroftë prej këtij të dytit).

Kur All-llahu i Lartësuar flet për jetën, ka për qëllim jetën e përjetësisë, e cila është në ahiret. Dynjaja (kjo botë) është dera eksperimentale, ndërsa ahireti është jeta e vërtetë, në të cilën do të shkojë secili prej njerëzve, padyshim.

I Dërguari All-llahut s.a.v.s., në një hadith thotë:

"Ç'mendoni se është jeta kësaj bote, në të cilën jemi tani? Ne këtu jemi vetëm sikurse udhëtari, i cili qëndron pak nën hijen e një peme për të pushuar. (Pastaj) E lë atë vend dhe ikën".

Jeta dhe vdekja janë nën kompetencat e plota të All-llahut xh.sh. Askush nuk ka mundësi t'a mohojë këtë. All-llahu, vazhdimisht, ia shpalos dhe ia mëson njeriut "sekretet" e Tij, natyrisht, vetëm ato të cilat Ai dëshiron. All-llahu i ruajti për vete tri gjëra sekrete:

- Jetën

- Vazhdimësinë e veprave të jetës
- Vdekjen

Në këto tri gjëra, askush nuk mund të thirret (prete-ndojë për pjesëmarrje), sepse i Lartësuari është Ai i Cili i krijoi ato. Njeriut i la fushëveprimtari gjatë vazhdimësisë së jetës, derisa t'i vijë exheli (vdekja) dhe të vdesë. Fillimi i jetës është në duart e All-llahut xh.sh., kjo është një çështje që është nën kompetencat e All-llahut. Askush nuk mund të pretendojë se mund t'i japë jetë ndonjë krijese, me përjashtim të All-llahut xh.sh. Për të qenë më të qartë, i Lartësuari All-llah, e ka sfiduar mbarë njerëzimin, nëse mund t'a bëjnë një gjë të tillë.

I Lartmadhëruari thotë:

"O ju njerëz, po ju paraqesim një shembull, prandaj dëgjojeni atë (me shumë vëmendje): " Ata të cilët ju i adhuroni (prej idhujve) - përveç All-llahut, nuk janë në gjendje të krijojnë as edhe një mizë, madje sikur të tuboheshin enkas për këtë (krijim të mizës). E nëse miza, ju rrëmben atyre diçka, ata (idhujt) nuk janë në gjendje t'ia rimarrin asaj. (prandaj) Të dobët janë: si lutësi (adhuruesi idhullit) ashtu edhe i luturi (idhulli)."

Pra, po shohim se i Lartësuari All-llah, sfidoi kështu mbarë njerëzimin. Ai i sfidoi shkencëtarët, trilluesit e ideve të mbrapshta, pra secilin që mendon se ka fuqi ose mundësi që të krijojë qoftë edhe një mizë të vetme. I Lartmadhëruari i ka paralajmëruar (njerëzit) se nuk do të kenë mundësi dhe se janë të dobët. Kjo kështillë ose sfidë është e vlefshme për dijetarët dhe shkencëtarët, që kur ka zbritur Kur'ani, e deri në Ditën e Gjykimit. Ata nuk do të munden kurrë t'a bëjnë një gjë të tillë.

All-llahu i Lartmadhëruar, disa prej sekreteve të Tij, ua shpalosi shkencëtarëve që u morën me shkencën e evolucionit, trashëgimisë dhe embriologjisë. Do të ishte e natyrshme që atyre, që arritën t'i mësojnë këto shkenca, t'iu shtohej imani (besimi) në All-llahun xh.sh., sepse Ai (All-llahu) ia caktoi secilës krijesë kodin e jetës së vet. Por, për fat të keq, shumica e tyre e keqpërdorën këtë dituri dhe e vunë në shërbim të propagandës kundër atyre që besonin bindshëm në All-llahun e Lartmadhëruar. Sfida e shembullit të mizës, ua verboi sytë atyre. Ata, iu shmangën sfidës së vërtetë, duke sjellë shembuj se janë në gjendje t'a ndërrojnë gjininë e foshnjes, nga femra në mashkull, por, thënë realisht, ai mashkull nuk i duhet askujt. Njerëzimi duhet t'a kuptojë se shejtani vazhdon t'i mashtrojë ata, që të mundohen në gjëra të kota, që nuk iu sjellin kurrfarë dobie, sikurse është të pretenduarit për të ndërruar krijesat e All-llahut. All-llahu i Lartësuar, na i paraqet këta persona, në Librin e Tij të mrekullueshëm, në këtë mënyrë:

"(Thotë djalli:) dhe unë do t'i bëj ata që të humbin, do t'i joshi në shpresa të kota, gjithashtu, do t'i urdhëroj që t'ua presin veshët kafshëve, do t'i urdhëroj madje edhe t'i ndërrojnë (tjetërsojnë) krijesat e All-llahur. "Ai që e merr djallin për mbrojtës, e jo All-llahun, ai ka humbur, ai është humbës i sigurtë. "

Nëse shkenca e embriologjisë, arriti një sukses gjatë viteve të gjashtëdhjeta, ajo nuk arriti ndonjë sukses, as tek kafshët, e as tek njerëzit. Shkencëtarët s'mundën të arrijnë ndonjë gjë të madhe, me përjashtim të shndërrimit të krijesave (organeve të tyre) të All-llahut dhe, së fundi, nuk arritën asgjë me të. Marrja me gjëra të kota, sikurse ata që i zëvendësuan sytë e mizës me krahë, nuk jep ndonjë sihariq të përmirësimit të jetesës, ose të shtimit të kompetencave të tyre. Kjo, për ne, është një orvatje e kotë, e cila i shërben vetëshkatërimit dhe propagandës!

SEKRETI I JETËS
DHE MBARIMI I SAJ

All-llahu i Lartmadhëruar, i ka lënë Vetes disa kompetenca, të cilat nuk ia ka lënë askujt tjetër prej krijesave të Tij, sikurse janë sekretet e jetës. Nuk ka krijues tjetër përveç Tij. Këto kompetenca i shtriu, gjithashtu, edhe në veprimtari të tjera të cilat kanë të bëjnë me të. Ato janë rrjedhëse, pasi janë të domosdoshme për jetë, si ajri (për frymëmarrje), uji dhe ushqimi. I Lartësuari xh.sh. është Ai i cili e krijoi mbështjellësin atmosferik qiellor, prej së cilit, të gjithë ne, marrim ajër nëpërmjet frymëmarrjes. Kuptohet, ky mbështje-llës nuk është prodhim njerëzor, por është prodhim i All-llahut të Lartmadhëruar. Kështu është edhe me ujin, ai shërben për t'u pirë dhe është prodhim i All-llahut xh.sh.

Mënyra e rënies së shiut, fillon nga procesi i avullimit të ujit prej tokës, për shkak të rrezeve të diellit. Më pas, këta avuj grumbullohen në shtresat e larta të qiellit dhe shndërro-hen në re mjegullnajore. Erërat i lëvizin këto re në ato vende ku i Lartësuari dëshiron që të lëshojë shiun (i cili bie pas ko-ndesimit të avujve të ujit, proces që shkakton formimin e piklave të e shiut). E gjithë kjo është prodhimtari e All-llahut xh.sh.

Atyre, që thonë ose që pretendojnë se janë ata që shkaktojnë rënien e shiut, ju themi: nuk kemi pse të debatojmë me ju, pasi bota është plot shkretëtira dhe pa ujë. All-llahu xh.sh. krijoi lumenj që kanë shtrirje me mijëra kilometra dhe caktoi elementet përbërëse të ujit për rrjedhshërinë e tij. Ne nuk kërkojmë nga ju të na ndërtoni një lumë, por ajo çka ne do të dëshironim nga ju, që pretendoni se mundeni të shkaktoni rënien e shiut, është të na bëni një përroskë të vockël, pra

vetëm një të vogël, në shkretëtirë. Kur të korrni sukses në këtë projekt, atëherë ejani dhe polemizoni me ne, dhe na thoni: ja, ne jemi ata që e zbresim shiun. Por para se ta bëni këtë, ne, nuk kemi pse të debatojmë me ju.

Nuk na takon neve të hymë në dialog me individë, pretendimet e të cilëve janë të parealizuara (dhe s'mund të realizohen dot kurrë). Ne, vërtet, jemi lodhur me thashetheme. Krijuesi i ushqimit është All-llahu xh.sh. Ai e ka shpërndarë ujin në sasira të nevojshme për secilin vend. Kështu pra, edhe fara, është mrekulli e krijuar prej All-llahut të Lartmadhëruar. Ajo ka mbështetjen për të ushqyerit e vet tek ushqimi i magazinuar në vet vendin e farës. Ky ushqim mbetet i magazinuar në vet këtë farë, derisa ajo të bëhet e aftë për t'i nxjerrë gjethet, të fillojë të marrë frymë, ndërsa rrënjët të thithin ushqimin prej tokës.

Askush nuk mund të pretendojë se është krijuesi i farës së parë, për çdo lloj fare, që ekziston në këtë botë. Për shembull, farën e parë të grurit e krijoi All-llahu xh. sh., pastaj kjo farë është përcjellë gjeneratë pas gjenerate, deri në ditët tona. Kështu është me gjithë sistemin biologjik, në botë... Njeriu bëhet shkaktar i ruajtjes dhe rritjes së prodhimit. Ai përpiqet të japë fruta të shumta dhe cilësore, por fillimi mbetet tek All-llahu xh.sh. Ajo çka është me rëndësi, është se njeriu nuk mundet të krijojë as edhe një farë të vetme.

Rrjedhshmëria e veprimeve dhe e jetës janë vepër e All-llahut xh.sh. I Lartësuari, për këtë lloj krijimi, thotë:

"Po për spermën që e hedhni (në mitër), (mos vallë) ju e krijoni atë, apo Ne jemi krijues i tyre? "

Kjo farë shkakton jetën, e cila bëhet sipas proceseve të caktuara të krijimit. All-llahu i Lartmadhëruar ishte Ai, pra, që krijoi këtë ekzistencë. Gjithashtu, bëri që ajo të ketë jetë të vazhdueshme, që prej kohës së Ademit a.s,. e deri në Ditën e Kijametit.

All-llahu i Lartësuar thotë:

"A e shikoni ujin që pini, a mos (vallë) jeni ju ata që e lëshoni prej reve, apo Ne jemi lëshuesit !?"

All-llahu i Lartësuar, me këtë, sikur dëshiron të na tregojë se: zbritja e ujit (shiut) është në kompetencat e Tij, e jo të dikujt tjetër. Prandaj, çdo gjë që thuhet përveç kësaj nuk qëndron, sepse nuk është e vërtetë. Vetëm i Lartësuari është në gjendje që, për të na dënuar, të na japë të pijmë ujë të kripur në vend të ujit të ëmbël. Për këtë, All-llahu xh.sh. na ka dërguar edhe ajet që ka urtësi:

"A e shikoni atë (farën) që e mbillni (në tokë)? Ju jeni ata që e bëni të mbijë, apo Ne jemi ata, që bëjmë që ajo të mbijë?"

Kështu pra, nga njeriu nuk kërkohet gjë tjetër, veçse t'a lëvrojë tokën, ndërsa fara që e hedh për t'a mbjellë është një prej krijimeve të drejtpërdrejta të All-llahut xh.sh. Uji, me të cilin e ujisim tokën, është gjithashtu krijim i All-llahut xh.sh. All-llahu është Ai i Cili i mundëson pemës etapat qarkulluese të jetës së saj, derisa pema të bëhet e gatshme për të dhënë frutat e saj. Pra, ne vetëm e hedhim farën në tokë, pastaj ulemi dhe shikojmë nga larg se si pema bëhet e gatshme vetvetiu të lëshojë frutat e saj. Ne nuk mund të ndikojmë asgjë tek ajo dhe ne nuk mund të ndërhyjmë në

brendinë e zhvillimit të jetës së saj. Më pas, ajo lëshon frutat e saj dhe kështu vazhdojnë (vit pas viti) prodhimet e njëpasnjëshme.

RICIKLIMI I DY KRIJIMEVE: I VDEKJES DHE I JETËS

Le të shohim tani përfundimin e jetës. Përfundimi i jetës, gjithashtu, është në kompetencat e All-llahut xh.sh. Askush nuk mund t'i japë përjetësi vetes së vet, apo të tjerëve. All-llahu i Lartësuar i thotë të Dërguarit të Tij, Muhammedit s.a.v.s.:

" Ndërsa Ne, para teje askënd nuk e kemi bërë të përjetshëm, nëse ti vdes; a mos (vallë) ata (pabesimtarët mendojnë se) do të mbesin gjallë (përjetësisht)!?"

Vërtet, njerëzimi ka ecur dhe po ecën me një zhvillim të lakmueshëm. Teknologjia më e sofistikuar e kohës dëshmon për këtë realitet, por të gjitha shkencat janë të paafta t'a ndalo-jnë vdekjen, pavarësisht prej fjalëve "shpresëdhënëse" të cilat thonë njerëzit. E vërteta është se ne nuk jemi të disponuar të bëjmë polemika me ata njerëz, të cilët paraqesin ide të ndryshme (mbi vdekjen), përveçse asaj se i është afruar exheli.

Megjithatë, ekziston një pikë për të cilën duhet pole-mizuar. Le të shohim se ç'na thotë i Lartësuari All-llah, në Kur'anin Kerim:

" ...Ai e nxjerr të gjallin prej të vdekurit, dhe nxjerr të vdekurit prej të gjallit..."

Disa dijetarë që janë marrë me komentimin e Kur'anit, këtë ajet e kanë shpjeguar në mënyrë shumë të gabuar: All-llahu (sipas tyre) e "nxjerr vezën prej pulës, ndërsa veza është e ngordhur. Kështu del i vdekuri prej të gjallit. Ndërsa i gjalli del prej të vdekurit – del zogza prej vezës."

Ne, më sipër, folëm për këtë pikë dhe thamë: ky koment është shumë i gabuar, për arsye se çdo gjë, që është në botë, është e gjallë. Ìdo gjë ka jetën e vet, madje edhe eleme-ntet e ngurta jetojnë. Pra, nëse çdo gjë që kemi në këtë botë është e gjallë, atëherë kush është i vdekur prej të cilit do të dalë i gjalli?

Themi se etapat e vdekjes janë: si ajo e hershmja, ashtu edhe ajo ardhmja. Ne pra ishim të vdekur para se të vinim në këtë botë. Kur ne të vijmë në këtë botë, fillon cikli i jetës së gjallë. Pastaj ne vdesim përsëri.

Pra, çdo gjë që ekziston në këtë univers qëndron midis ciklit të krijimit (të periudhës së vdekjes dhe jetës). All-llahu xh.sh. thotë:

"Si mund të mos t'a besoni All-llahun, kur ju ishit të vdekur e Ai ju dha jetë; pastaj Ai do t'iu bëjë të vdisni, dhe gjithsesi pastaj do t'iu ngjallë, (dhe më në fund) tek Ai do të ktheheni."

Çdo gjë që është e gjallë e ka detyrën e vet në këtë botë. Kur e kryen detyrën e vet, largohet nga jeta e kësaj bote dhe bëhet e pajetë (e vdekur). Pema p.sh., kur përfundon së dhëni fruta, thahet dhe largohet nga kjo jetë, sepse ajo e ka kryer detyrën e vet. Gjithashtu, çdo kafshë pasi e kryen detyrën e vet gjatë jetës së saj, ngordh dhe largohet nga kjo botë.

Kështu është edhe me njeriun. Edhe ky ka detyrën e vet gjatë kohës kur ai është në jetën e të gjallëve. Ai konsiderohet në kohën e testimit, të cilën ia ka caktuar All-llahu xh.sh. Dhe pasi All-

llahu t'a ketë testuar disa herë, jeta e tij do të përfundojë, për shkak se detyra për të cilën ai ka ardhur në këtë jetë ka përfunduar.

Tani kthehemi sërish dhe pyesim: Nëse çdo gjë, që kemi në këtë botë, konsiderohet e gjallë, atëherë ku është vdekja?

EMRAT E QENIES DHE EVIDENTIMI I ATRIBUTEVE

Para se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, duhet të themi patjetër: Vërtet, prej atributeve të All-llahut janë: Jetëdhënësi dhe Vdekjeprurësi (Jetëmarrësi). Cilësitë ose emrat e All-llahut të Lartmadhëruar të shpiejnë, në të njëjtën kohë, deri tek evidentimi dhe krijimi. Qenien e All-llahut të Lartmadhëruar e përbëjnë edhe cilësitë e Tij, cilësi të cilat kanë të bëjnë me Vetë Qenien. Kur ne themi: 'All-llahu është Furnizues' - kjo do të thotë se Ai ishte Furnizues para se të kishte cilin t'a furnizonte, ose para se të ekzistonte ndonjë krijesë për t'a furnizuar All-llahu xh.sh. All-llahu i Lartmadhëruar e ka furni-zuar krijesën e Tij të parë me cilësinë e Tij të qenurit Furni-zues. Sikur i Lartmadhëruari të mos ishte Furnizues para se t'a krijonte atë (krijesë) që do t'a furnizonte, atëherë si do t'a furnizonte krijesën e Tij në momentin e krijimit të saj?

All-llahu ishte Krijues para se të krijonte. Ai krijoi me cilësinë e Tij të krijimit. Cilësia e të krijuarit tek All-llahu ekzistonte para se të krijohej krijesa e parë. Cilësia, ekzistonte në qenien e Tij që nga amshueshmëria-ezeli. Si jeta, ashtu edhe vdekja, janë të krijuara. Ne jetojmë brenda krijimit të

jetës dhe krijimit të vdekjes. Jetojmë brenda krijimit të jetës në këtë botë, dhe brenda krijimit të jetës së amshueshmërisë-ahiretit. Gjithashtu, jetojmë brenda krijimit të vdekjes para se të vinim në këtë botë.

Pastaj do të shkëputemi sërish deri në ringjallje. Përderisa All-llahu xh.sh. është i vetmi Krijues, çdo gjë vjen në jetë në saje të All-llahut. Gjithashtu, çdo gjë që shkëputet nga kjo jetë, për në vdekje, i atribuohet All-llahut. Transformimi nga bota e gjallë, në botën e vdekur e ka burimin tek All-llahu xh.sh., transformim të cilin ne e quajmë vdekje dhe jetë.

ISHIM PARA SE QË JEMI

Ne kemi qenë të krijuar para se të vinim në jetën e kësaj bote. Për këtë që themi, ne bazohemi në informacionin që na ka dhënë All-llahu xh.sh. I Lartmadhëruari na ka folur të gjithëve. Ai ka kërkuar që ne, të dëshmojmë për ekzistencën (e Tij). Ai ka marrë, gjithashtu, prej nesh edhe premtimin. Ne, atëherë ishim të krijuar, por ishim në botën e të vdekurve, pastaj jemi transferuar, me urdhërin apo lejen e All-llahut xh.sh. në botën e gjallë. U bëmë të gjallë, pasi ishim të vdekur. Si?

Ne u transferuam nga bota e vdekur, në botën e gjallë- në botën e kësaj jete, të cilën po e jetojmë tani. Ashtu siç thamë më sipër: çdo gjë që ekziston në këtë botë është e gjallë. Thjesht, vetëm duke na trasferuar nga bota e vdekur në botën e gjallë, u bëmë të gjallë. Kur ne do t'a lësho-jmë

këtë botë, do të transferohemi përsëri, nga bota e gjallë në botën e vdekur. Pastaj përsëri do të ringjallemi, dhe do të tra-nsferohemi nga bota e vdekur në atë të gjallë.

Kjo nuk nënkupton se vdekja është inekzistente, por kjo nënkupton se ne transferohemi prej një bote që ka ligjet e veta, në një botë tjetër, që gjithashtu ka ligjet e veta. Ky tra-nsferim i krijesave, nuk bëhet pa lejen e All-llahut të Lartmadhëruar.

Ne u transferuam nga Bota e Dherr-it, në botën e gjallë, pra, ishim të vdekur dhe u bëmë të gjallë, pastaj transferohemi, nga jeta e gjallë e kësaj bote, në Botën e Berzah-it. Duke qëndruar në atë botë (të Berzah-it) ne jemi të vdekur, pastaj do të kthehemi përsëri në botën e gjallë, në kohën e Ringjalljes për t'u marrë në pyetje.

Askush nuk mund të thotë se ne në botën e Berzah-it nuk kemi ndieshmëri (idrak). Jo! Ne ndiejmë, por kjo ndodh në një formë të veçantë. Ne do t'i ndiejmë ose njohim gjërat, bile edhe do të logjikojmë. Kur ne do të dergjemi për të dhënë shpirtin (në momentin e agonisë), neve do të na zbulohen botërat, të cilat na ishin të fshehura (të panjohura). Do të shohim ato që nuk i shihnim dot më parë. Ky moment është shumë i rëndësishëm saqë disa do të kërkojnë, duke iu lutur shumë të Lartmadhëruarit, që të kthehen përsëri në këtë botë, sepse e kanë parë vendimin (për vendin) e tyre. Kanë parë xhennetin ose xhehennemin, të plotëbindur.

Le të lexojmë thënien e All-llahut xh.sh.:

"Derisa, kur t'iu vijë vdekja (ndonjërit prej mohuesve, i penduar), do të thotë: " O Zoti im, më kthe (përsëri në këtë botë). Që të bëj vepra të mira, të cilat i kisha lënë pa bërë" Jo-Kurrsesi! Nuk

ka dyshim se, ai ato i ka vetëm fjalë të kota që i thotë. Nga prapa e kanë Berzahin, deri në ditën kur do të ringjallen"

Njeriu, në këto momente, do t'a kuptojë me plotëbindje se cili do të jetë fati tij i ardhshëm. Ai, qoftë besimtar apo femohues, do t'a dijë saktë, nëse do të jetë prej të shpërblyerve me xhennet, apo me xhehennem (All-llahu na mbroftë prej tij). Ai e kupton saktë se çdo gjë mori fund dhe se rrugëtimi i jetës së tij nuk ka përfunduar me vdekjen e tij.

Bile, ai do t'a dijë saktësisht se tani është duke shkuar në jetën pasive, pasi ishte aktiv. Përndryshe, nuk kishte për të kërkuar nga All-llahu i Lartmadhëruar për t'u kthyer, në mënyrë që të bëjë vepra të mira. Zgjatja ose shtrirja e kësaj ekzistence do të ketë kuptim dhe do të jetë bindëse, edhe pse është në botën e të vdekurve. Njeriut do t'i paraqiten shumë gjëra, që do e bëjnë atë të jetë i bindur. Ai do t'a kuptojë se nuk paska ikje nga caktimi (kaderi) i All-llahut. Ai do t'a kuptojë se do të kthehet përsëri në jetë (i gjallë).

VETËVRASËSI – PËRJETËSISHT NË ZJARR

Ashtu siç thamë më sipër: jeta dhe vdekja janë dy gjëra të kundërta. Njeriu nuk ka kurrfarë mundësie t'i bashkojë ato. Askush prej krijesave nuk ia merr shpirtin tjetrit. Dikush mund të thotë se: është e vërtetë (e saktë) se njeriu nuk ka mundësi t'a nxjerrë vetveten nga vdekja në jetë, dhe këtu nuk ka vend për polemikë, por, ama, njeriu mundet që t'a kalojë veten nga jeta në vdekje.

(Kjo ndodh atëherë) Kur dikush vendos të vetëvritet. I jep vetes një plumb, ose e hedh veten nga një farë lartësie (ndërtese), kodër ose hidhet në det, etj.

Këtyre, që mendojnë kështu, iu themi: Pse e përzieni vdekjen me vrasjen!? Vetëvrasësve iu është caktur dënimi në xhehennemin e përjetshëm. A e dini pse? Sepse njeriu nuk e ka krijuar vetë veten e tij, atëherë pse të veprojë kështu!? All-llahu xh.sh. ishte Ai që e krijoi atë, me trup dhe me shpirt. Jeta e tij është dhunti e All-llahut. Kur dikush vetëvritet ka shkaktuar dëm në pronën, e cila nuk është pasuri e tij. Ai i cili vret një njeri pa qëllim, do të dënohet me shpagim të vlerës së caktuar. Ndërsa, ai i cili e vret veten me qëllim, kot së koti, ose prej ngatërresave që i janë shkaktuar në tokë, dënimi i tij është në xhehennemin e përjetshëm. Vetëvrasësi e ka mbytur veten me qëllim dhe, për këtë, dënimi është i drejtë.

Me këtë, i Lartësuari, dëshiroi që ne të mësojmë se jeta, përsa i përket njeriut, është pararendësja e vdekjes. Pra, njeriu nuk e përjeton këtë jetë, nëse nuk ekziston me të edhe e kundërta e saj - vdekja. Për të kuptuar se kjo jetë do të mbarojë, (dhe se ai do të shkojë) në atë vend ku ai ishte më parë. Pra, aty ku kishte filluar roli i tij. Por nëse është i vdekur, atëherë (ligjet) vdekja do t'a përcjellë atë.

Duhet t'a kuptojmë se kemi dallim midis jetës së konceptuar sipas vizionit tonë dhe jetës reale. Jeta sipas vizio-nit tonë mund të kuptohet si kënaqësi, lojë, mburrje me pasuri dhe fëmijë. Mbase ky duhej të ishte kuptimi, sipas vizionit tonë, i jetës së kësaj bote. Për këtë arsye, ngarendim pas tyre, sa për t'i arritur ato gjëra që na joshin. Por, i Lartmadhëruari All-llah, nuk na e krijoi neve jetën e kësaj bote për këto kotë-sira (për lojra dhe kënaqësi). All-llahu këtë e krijoi për një qëllim, i cili duhet të realizohet.

Le të lexojmë thënien e All-llahut në Kur'an:

"Ne nuk e krijuar qiellin dhe Tokën, dhe çdo gjë që gjendet midis tyre, për t'u zbavitur. Sikur Ne të dëshironim të argëtoheshim do ta bënim atë sipas mënyrës Sonë (ashtu si i përket Mbretërisë Sonë), por Ne nuk e bëjmë këtë (për zbavitje)."

Pra, prej kësaj mësojmë se i Lartësuari ka përcaktuar detyrimet për secilën gjallesë. Kjo përgjegjësi është edhe qëllimi i jetës, bile është qëllimi i krijimit në tërësi.

Nëse je kurioz për të kuptuar funksionin e ndonjë gjëje, atëherë pyete atë që e ka krijuar ose prodhuar atë objekt: Përse e krijove atë? Kjo është ekuivalente me rastin e të pyeturit të prodhuesit të ndonjë fabrike për prodhimet e saj. P.sh. prodhimi i lavatriçeve ka për qëllim që t'ia lehtësojë punët zonjës së shtëpisë për larjen e rrobave. Ajo ka një sistem dhe një rol të caktuar, pasi prodhuesi ia ka caktuar detyrën (funksionin) asaj. Me këtë prodhuesi realizon qëllimin e vetvetes.

Prodhuesi shpiku pjesë dhe mjete të ndryshme dhe i sistemoi ato për t'a realizuar qëllimin e tij. Gjithashtu, ai ka caktuar mënyrën, formën dhe sistemin e punës. Ka paraparë që në rast ngarkeseje, makina të sigurohet me anë të siguresave. Pra, kur ajo të mbingarkohet, nuk do të mund të funksionojë për t'a kryer punën e caktuar. Nëse ndodh që të prishet, prodhuesi na e ka lehtësuar punën, duke na ofruar katalogun për të marrë udhëzimet e para. Kjo na shërben për t'a evide-ntuar prishjen. Nëse ne ndërhyjmë në riparimin e saj, pa udhëzimet e prodhuesit ose mjeshtrit dhe i përvishemi punës me hamendje, ka shumë mundësi që t'a prishim edhe më shumë atë, në vend që t'a riparojmë.

Është për t'u çuditur se ne veprojmë kështu, me të gjitha makineritë ose mjetet që ka prodhuar qenia njerëzore. Kështu veprojmë me veturat, frigoriferët etj., por kur bëhet fjalë për sigurimin e jetës së njeriut sipas udhëzimeve të Krijuesit, stepemi dhe nuk i marrim këto udhëzime. Ai është Krijuesi, Ai e di më së miri se çka i duhet, e çka nuk i duhet njeriut. Çuditërisht, ne veprojmë sipas tekave tona dhe kështu bëhemi shkaktarë të ngatërresave. Ne, sigurisht nuk jemi të aftë të dimë se si t'a riparojmë sistemin programor të krijimit, të parashikuar nga Ai, për jetën tonë. Jemi të mbingarkuar me ide dhe programe njerëzore, të cilat po na ngulfasin. Propagandohen dhe paraqiten ide të ndryshme, që orvaten të na bindin se janë në gjendje t'a riparojnë mirëqenien njerëzore më mirë se All-llahu!!

All-llahu xh.sh. na e ka sqaruar këtë, në Kur'anin Kerim:

"Kur atyre ju thuhet: mos bëni ngatërresa në botë, ata përgjigjen duke thënë: "Por ne jemi reformistë (mundohemi për të mirën e njerëzimit)!". Veni re ata janë ngatërrestarë? - por këtë nuk e ndiejnë"

Nëse, tani, duam t'a përfshijmë shkurtimisht atë që thamë në këtë kapitull, do të kishim:

All-llahu i Lartësuar e krijoi njeriun për të qenë i përjetshëm në jetë. Secilit që i fryu nga Shpirti i Tij, që prej kohës së Ademit e deri tek Dita e Kijametit, e ka të garantuar përjetësinë. Ai ose do të jetë i kënaqur në xhennet, ose do të pësojë dënimin në xhehennem. Kjo do të thotë se ai është i përjetshëm. Askush nga kjo botë nuk vdes për të mos u ringja-llur, dhe askush nuk do të ringjallet kot së koti. Secili do të merret në pyetje dhe kjo, gjithashtu, nuk do të ndodhë pa ndonjë qëllim (kot), por (për të caktuar se) do të hyjë në xhennet, apo në xhehennem.

All-llahu i Lartmadhëruar ka bërë që fillimi i etapave të jetës të fillojë me vdekjen. Ne kemi ardhur në këtë botë nga vdekja e botës së parajetës - Dherrit. U transferuam nga të qenurit të vdekur, në të qenurit të gjallë. E këtë, ju siguroj, se askush nuk mund t'a bëjë me përjashtim të All-llahut xh.sh. Ai është i Vetmi që është Krijuesi i vdekjes dhe i jetës. ٹshtë i Vetmi i Cili do t'i ngjallë të vdekurit nga varrezat. Nuk ka asnjë forcë tjetër, në univers, ekuivalente me Të. Kushdo qofshin ata, qofshin individë ose grupe njerëzish (forcash), nuk do të mundeshin t'a transferonin të vdekurin në jetë, ose t'ia ndalojnë ndokujt transferimin prej jetës në vdekje.

Ne, të gjithë, jemi të paaftë t'i japim dikujt jetë ose t'ia ndalim atë. Jeta dhe vdekja janë dy gjëra të kundërta. Ai i cili është i gjallë nuk është i vdekur, gjithashtu, ai i cili është i vdekur nuk është i gjallë. Secili ka ligjet dhe botën e vet.

Thamë se ne e dallojmë vdekjen nga vrasja, si dy gjëra të ndryshme. Këto ndryshojnë dukshëm nga njëra tjetra. Pastaj theksuam qëllimet e krijimit të universit. Pse e krijoi All-llahu xh.sh.? Cili ishte qëllimi i kësaj?

Pastaj thamë: prodhuesi i një gjësendi (objekti) e realizon qëllimin e tij. Por njeriu, gjithmonë, mendon gabimi-sht se është në gjendje vetë t'ia përcaktojë vetvetes qëllimin, qëllim për të cilën ai nuk është krijuar, duke e mashtruar veten dhe të tjerët se është duke bërë reforma në tokë, por që në rea-litet është duke u bërë shkatërrues i tyre dhe i vetvetes.

Por, atëherë, pse All-llahu e krijoi jetën në këtë botë? Këtë do të mundohemi që t'a shpjegojmë në kapitullin e ardhshëm, inshalla.

KAPITULLI I PESTË
JETA E DUNJASË

All-llahu i Lartmadhëruar e krijoi universin për një qëllim të caktuar dhe na tregoi për të, me qëllim që ne t'a kuptojmë arsyen e krijimit. Pra, cili ishte qëllimi dhe cili është përfundimi.

I Lartësuari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"Xhindët dhe njerëzit nuk i krijova për gjë tjetër, përveçse të më adhurojnë. Prej tyre nuk kërkoj furnizim (risk), e as të më ushqejnë. Pa dyshim, All-llahu është i vetmi Furnizues! Ai posedon Fuqi të Plotë të pakontestueshme!"

Pra, qëllimi i krijimit tonë në këtë univers qenka që t'a adhurojmë dhe t'a lartësojmë All-llahun, t'a lavdërojmë e t'a madhërojmë Atë. Shtrohet pyetja, pse i Lartmadhëruari i paska përcaktuar vetëm qeniet njerëzore dhe xhinn-ët, ndërsa krijesat e tjera në univers i ka lënë pa përcaktim? Pse?

Kjo është për arsyen se i Lartësuari vetëm këtyre dy krijesave u ka dhënë lirinë e të shprehurit. Këto dy krijesa mund të besojnë (pohojnë) dhe të mohojnë. Këto kanë lirinë t'i binden ose (mos e thashtë Zoti) kanë lirinë t'a mohojnë. Ndërsa llojet e tjera, në mbarë universin, janë të detyruara t'i binden (nënshtrohen) Madhërisë së Tij. Atyre nuk iu është dhënë mundësi alternative. Ato, gjithnjë, e madhërojnë All-llahun e Lartmadhëruar, nuk hamenden, e as nuk harrojnë për t'a madhëruar.

Lexojeni thënien e All-llahut xh. sh. në Kur'an Fisnik :

"A nuk po e sheh se All-llahut i bën sexhde çdo gjë që është në qiej dhe çdo gjë që ekziston në tokë. (I bën sexhde:) dielli dhe hëna, yjet dhe malet, drunjtë dhe shtazët. (Atij i bëjnë sexhde:) edhe shumë nga (qeniet) njerëzore, prej të cilëve shumë prej tyre e meritojnë dënimin. Atë të cilin e turpëron All-llahu, s'ka kush që mund t'a nderojë. Pa dyshim, All-llahu vepron sipas Vullnetit të Tij."

Nga ky ajet kuptojmë se të gjitha gjallesat i bëjnë sexhde të Lartmadhëruarit All-llah, qofshin ato në tokë apo në qiell. Askush nuk e shkel respektin, bindjen, përkujtimin dhe lartësimin ndaj All-llahut xh.sh.. Njeriu nuk i përket absolutisht këtij grupi. Njerëzit janë dy tabore. Ata besimtarë dhe ata femohues (kafirë). Vetëm kur është përmendur emri i njeriut ndodhi sqarimi i këtyre dy taboreve. Pse? Sepse All-llahu i Lartmadhëruar, ashtu siç thamë, njerëzve dhe xhinn-ëve u ka dhënë lirinë e zgjedhjes.

I Lartësuari, e krijoi këtë univers madhështor për t'i shërbyer njeriut, zëvendësit të Tij në tokë. I tërë universi iu bind Krijuesit të vet. Me përjashtim të shumë njerëzve, të cilët All-llahu i bëri zotërues të universit të Tij!

All-llahu xh.sh. ia kishte paraqitur Amanetin (në këtë rast amaneti është liria e zgjedhjes alternative) të gjitha llojeve të universit. Të gjitha u copëtuan në vetvetet e tyre, sepse nuk ishin të disponuara t'a mbanin këtë barrë, dhe thonin: O Zot, duam dhe pranojmë të jemi të detyruara në nënshtrim dhe në bindje.

I Lartësuari, në Kur'an, thotë:

"Ne, kur ua ofruam amanetin qiejve, tokës dhe maleve, ato u drithëruan nga frika e

atij (amaneti) dhe nuk e morën përsipër këtë barrë. (Këtë amanet) e pranoi njeriu. Ai, (njeriu në momentin e pranimit) vërtet ishte dëmtues (i vetvetes) dhe injorant (xhahil-ngase nuk e kuptoi se ç'kishte pranuar)."

Kjo ishte përzgjedhja e parë dhe e fundit për të gjitha llojet e krijesave në univers. Ishte njeriu ai i cili pranoi t'a mbajë këtë barrë, pra, këtë amanet. I Lartësuari ia paraqiti këtë liri nga dashuria, e jo nga urrejtja. Të bëhet i fortë për t'a mundur mohimin. Të besojë me plotdashuri në All-llahun xh.sh. Xhinn-ët dhe njerëzit janë dy krijesa, të cilat do t'a vërtetojnë cilësinë e dashurisë së All-llahut. Këta do të përzgjedhin duke u bazuar në programin e Tij, me dëshirën e tyre. Këtë do t'a bëjnë nga dashuria, e jo nga domosdo-shmëria. Këta do t'a lartësojnë, do t'i përkulen, do t'a madhë-rojnë, do t'i luten dhe falënderojnë All-llahun, vetëm e vetëm për t'a shprehur dashurinë ndaj Tij.

I Lartmadhëruari thotë: "Nuk i krijova xhinn-ët dhe njerëzit (për gjë tjetër) përveçse të më adhurojnë". Për t'ia dhënë saktësinë adhurimit, duhen të përfshihen të gjitha rrymat lëvizëse të jetës. Pra, të gjitha veprat njerëzore duhet t'a shprehin dashurinë ndaj All-llahut xh.sh. Secila lëvizje në jetë, është argument i gjallë për këtë dashuri. Programi është argument, sinqeriteti është shkëlqim, gjithashtu, edhe rrugë-timi tij nuk duhet të ketë shtrembërim. Nuk duhet që All-llahu t'a shohë njeriun, aty ku ia ka ndaluar të qëndrojë, gjithashtu, mos t'a ndiejë mungesën (e kryerjes së veprave) për të cilat është urdhëruar.

ADHURIMI - I DOMOSDOSHËM
POR, SI BËHET?

Njerëzit mendojnë se adhurim janë (vetëm) pesë dispozitat e Islamit: (eshhedu en la ilahe il-la llah ve eshhedu enne Muhammeden resulullah- Dëshmoj se nuk ka Hyjni tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Tij), falja e namazit, dhënia e zekatit, të agjëruarit e muajit të ramadanit (ramazanit) dhe shkuarja në haxh e të gjithë atyre që kanë mundësi materiale për të shkuar atje. Themi se mbi këto shtylla është ngritur feja.

Në këtë mënyrë, Zoti ynë ka paraparë që ne, me anë të kësaj feje, të jemi në një lidhje të vazhdueshme me Të, sepse shejtani kështu nuk do të ketë gjasa të na mashtrojë, përderisa ne të paraqesim prezencën, dhuntitë dhe bollëkun e Tij në çdo kohë, apo në çdo çast.

Namazi pas namazit, apo namazi i njëpasnjëshëm e 'grason' (yndyros) imanin dhe padyshim, ai na mbron nga devijimi prej programit të All-llahut xh.sh., bile na forcon dhe na afron tek All-llahu i Lartmadhëruar. Kështu është edhe me agjërimin, zekatin dhe haxhin. Secili adhurim mban me vete dritën (nurin) e All-llahut xh.sh.

Sa herë që e ndiejmë veten të tensionuar, apo kemi presione të brendshme, përqëndrohemi dhe shkojmë marrim një pjesë drite (nuri) prej All-llahut xh.sh., i cili na kthen në vete barazpeshën tonë imanore. Njëlloj, sikurse ndërmarrim masat e duhura kur dobësohen bateritë. Sigurisht që i drejto-hemi karikuesit të baterive për t'a mbushur atë përsëri. Islami përfshin programin e të gjithë jetës njerëzore.

Nuk dua të futem në polemika të kota me ata të cilët thonë se: Islamin e përbëjnë vetëm (pesë) dispozitat e Islamit. Nëse t'i falesh, jep zekat, agjëron dhe shkon në haxh, me këtë e ke siguruar afrimin tënd tek All-llahu xh.sh. Pasi t'i bësh këto, më pas ti vepro ç'të duash, apo leri punët e kësaj bote të gjy-kojnë lirshëm pa mbështetjen e imanit!

Të gjithëve atyre, që mendojnë kështu, iu them: nuk kam për qëllim të polemizoj, por do të flas vetëm nga një kënd i obligimeve fetare që ne kemi. Të marrim lutjen (namazin). Për të hyrë në namaz, apo për të dalë para All-llahut, është i domosdoshëm angazhimi ynë jetësor në:

E para, që duhet të bëjmë, e që na i obligon qëndrimi në këmbë para All-llahut në namaz, është mbulesa e pjesshme e trupit apo e pjesëve të turpshme. Nuk kam për qëllim të them se nevojiten rroba ose diçka të ngjajshme me to, por kam për qëllim qoftë edhe një copë arneje apo bezeje, sa për t'i mbuluar pjesët e obligueshme. Kjo arnë (që të prodhohet) ka nevojë për pambuk, ndërsa pambuku ka nevojë për bujkun. Pastaj bujku ka nevojë t'a lëvrojë tokën për të hedhur farën. Kjo farë mund të gjendet ose jo këtu tek ne (në vendin tonë). Në këtë situatë detyrohemi t'a importojmë nga jashtë. Pastaj, për t'a lëvruar tokën, domosdo, bujkut i nevojitet plugu prej metali të rëndë, si plugu i thjeshtë që e përdorte njeriu primitiv.

Kështu njeriut i bëhet e domosdoshme të hapë xeherore nëpër kodra e male, për t'a nxjerrë xehen e papërpunuar të hekurit. E gjithë kjo punë gjigante për të bërë një plug të thjeshtë. Kjo xehe, pastaj, obligon ndërtimin e fonderive e pastaj punën e farkatarëve dhe kështu, derisa t'i dorëzohet bujkut për t'u shërbyer. Pastaj, kur pambuku bëhet i gatshëm, nevojitet që t'a mbledhë dikush e pastaj t'a transportojë atë deri në magazinë. Prej aty, dërgohet më pas për t'u përpunuar në fabrikat e tekstileve, për t'u shndërruar në fije (penj). Pasi të bëhet fija (e pambukut), ajo

dërgohet në veg, për t'a bërë copë bezeje. Aty shkon tek tregtari, që merret me shitjen e tij, për t'a marrë, e prej tij e blejmë ne. Të gjitha këto lëvizje janë të domosdoshme, që ne të mundemi të qëndrojmë para All-llahut të Lartmadhëruar, pra për t'a mbuluar trupin dhe për të na u pranuar namazi.

KUSH NA PREMTON USHQIMIN

Për t'a përforcuar edhe më shumë shembullin rreth faljes, mendoj se, para se të kryejmë namazin, kemi nevojë për ca kafshata buke. Jo shumë, por aq sa të jemi në gjendje t'a kryejmë rukunë ose sexhden. Pra, marrja e një kafshate buke na jep fuqi për t'a bërë këtë. Për sigurimin e kësaj panineje buke që e blejmë në dyqan, duhet një tregim i gjatë, që merr me vete një mal angazhime ose punë (të shumë e shumë njerëzve). Duhet filluar nga mbjellja e grurit, korrje-shirjet, transporti për në mulli, deri sa ai të bëhet miell. Pastaj mielli duhet bërë brum, e ai brum pastaj duhet bërë bukë, e pastaj bukët transportohen deri në dyqan për t'i blerë ne.

Pra, po shohim se duhen punë jashtëzakonisht të mëdha, derisa të bëhemi të gatshëm për t'a kryer një namaz. Nëse do të qëndronim të gjithë në xhami për t'u falur, e nuk do të merreshim me punë të tjera, kush do të na sillte një copë bez (arën) për t'a mbuluar trupin, ose një panine buke për t'a mbajtur shpirtin gjallë!? Pra, ajo që është e domosdoshme duhet t'a kryejmë si vepër të domosdoshme. Për këtë arsye themi se adhurimi na bën të jemi të gjithë në lëvizje.

Përderisa All-llahu e do njeriun që t'a adhurojë Atë, Ai do që njeriu t'i lutet në shtëpi, në zyrë, në xhami, në rrugë. Me fjalë të tjera, Ai e do njeriun që t'i lutet në secilën lëvizje që bën ai në jetën e tij. Islami është nxitës i edukimit të përgjithshëm, përderisa ka bërë që njeriu edhe në rrugë të jetë i sjellshëm dhe i edukuar.

Vërtet, All-llahu sevapet i ka shpërndarë tek të gjitha lëvizjet, ose angazhimet e jetës. Programin të cilin e ka përpiluar All-llahu e ka bërë të tillë, që çdo gjë të ketë lëvizje të përgjithshme. E shpërblen atë që e viziton të sëmurin, atë që gjykon me drejtësi ndërmjet njerëzve, atë që i bën një të mirë fqinjit të tij, atë që pastron ose largon ndonjë pengesë nga rruga, atë që ndihmon të hendikepuarin për t'a kapërcyer rrugën, atë që kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët, atë që u kryen me edukatë shërbime njerëzve, atë që e largon të keqen, atë që është fjalëdrejtë dhe këshillues i paanshëm, atë që ndihmon të tjerët, atë që ka dalë të kërkojë punë për riskun e fëmijëve të tij, atë që bëhet shkaktar për të penguar ndonjë krim dhe atë që urdhëron për vepra dobiprurëse. Të gjitha këto dhjetëramijëra vepra nuk janë në shtyllat e Islamit, por të gjitha këto kanë shpërblime.

Nëse ne, në lëvizjen tonë jetësore, përqëndrohemi vetëm në këto pesë dispozita të Islamit, ne jemi duke e penguar veten nga 90 % të sevapeve të cilat i ka paraparë All-llahu për ne. Përderisa Vetë i Lartmadhëruari ka thënë: "Nuk i krijova xhinn-ët dhe njerëzit, përveçse që të më adhurojnë..." patjetër, duhet të kuptohet se i gjithë programi i Tij është adhurim.

Programi është ai i cili e komandon lëvizjen e besimtarit në botë. Secila lëvizje në gjithësi është adhurim, përderisa me të ka për qëllim që të dalë para All-llahut të Lartmadhëruar.

PROGRAMI PARA KRIJIMIT

All-llahu i Lartmadhëruar, para se të krijonte njeriun, ia përpiloi atij programin dhe ia caktoi detyrat e jetës. Secili që ngre ose krijon diçka, fillimisht përcakton qëllimin. Përderisa jeta është garancia e gjërave që t'a kryejmë detyrimin tonë, atëherë patjetër duhet të dimë këtë detyrim, për të cilin na krijoi All-llahu. Ai, Krijuesi ynë, është Ai i Cili i ka paraparë ligjet e jetës sonë për të qenë të mirë dhe për t'a kryer detyrën për të cilën jemi krijuar.

Është për t'u çuditur, vërtet habitem, kur analizoj se universi pikësynimin ose burimin e ka tek njeriu (është krijuar në shërbim të tij). E gjithë kjo rrjedh ngase njeriu është qenie që ka lirinë e përzgjedhjes midis alternativave të ndryshme. Ndërsa krijesat e tjera, janë të detyruara për respekt dhe nënshtrim, pra, prej tyre nuk vjen e dëmshmja.

Ato e kryejnë detyrën e tyre, sepse janë krijuar për këtë shkak, ato nuk kanë përzgjedhje alternative. Por, ajo që e shkatërron jetën dhe universin është ndërhyrja e qenieve njerëzore, të cilëve iu është mundësuar përzgjedhja alternative.

I Lartësuari dëshiroi që ne të jetojmë në këtë botë për t'a përcjellë programin e krijimit tonë. Me këtë, ne do ta kishim kryer detyrën tonë, sikurse edhe krijesat e tjera në univers. I Lartmadhëruari, në Kur'anin Kerim, thotë:

"...dhe nëse bini ndesh për ndonjë gjë, atëherë drejtojuni All-llahut dhe të Dërguarit të Tij ..." □

Pra, përderisa mësuam se të gjitha krijesat e ngurta, bimët dhe kafshët, i janë nënshtruar shërbimit të njeriut, atëherë cila është detyra e njeriut? Detyra e tij është t'a adhurojë All-llahun. All-llahu në një hadith Kudsij thotë:

" O biri i Ademit! E krijova këtë univers për ty, ndërsa ty të krijova për veten Time, prandaj mos u preokupo me atë që është e jotja, aq sa ti je për të."

Por atëherë, cila do të ishte detyra kryesore ose qëllimi final i adhurimit? A mos vallë, All-llahu kërkon prej nesh që t'a madhërojmë pandërprerë tërë ditën dhe t'a përmbyllim ditën në këtë mënyrë? Jo! Adhurimi nënkupton përpjekjet e njeriut për t'a kryer detyrën e vet për të cilën është krijuar. Çdo lëvizje në univers konsiderohet adhurim, ndërsa ne i zbatojmë pesë dispozitat e Islamit, për t'a plotësuar imanin tonë, që është në brendinë tonë. Për këtë fjala (adhurim) ka kuptimin: bindje All-llahut në gjithë programin e përcaktuar.

DETYRAT E NJERIUT NË JETË

O njeri! Të gjitha gjallesat në tokë, si materiet inorga -

nike, ashtu edhe flora dhe fauna të binden ty! Ato të shërbejnë ty, të nënshtrohen ty për të gjitha ato gjëra që ke nevojë. Ato janë të detyruara që t'i shërbejnë si njeriut besimtar, ashtu edhe atij jobesimtar, si të bindurve ndaj Zotit, ashtu edhe mohuesve, deri në ditën e Kijametit. Atëherë

(në këtë ditë) njeriu do t'a humbasë këtë veçori (privilegj) dhe me këtë përfundon ky shërbim (i universit ndaj tij).

Dielli në këtë botë, nuk rrezaton vetëm për besimtarët. Toka nuk i jep frutat e veta vetëm për ata që besojnë, dhe t'ua ndal ato femohuesve. Krijesat e tjera të tokës janë në shërbim të njeriut dhe për njeriun, pa marrë parasysh se çka beson dhe ç'mendon ai për Zotin e tij. Ata të cilët i mirëpresin proceset, atyre do t'ju shërbejnë ato procese. Nuk ka dallim midis atyre që deklarojnë se nuk ka hyjni tjetër, përveç All-llahut dhe atij që refuzon t'a deklarojë këtë.

Ndërsa në ahiret, gjendja ose statusi do të ndryshojë. Krijesat do t'i shërbejnë vetëm njeriut besimtar, ndërsa pabesimtarëve nuk do t'iu shërbejnë. Kur pabesimtari do të mundohet t'a gënjejë All-llahun dhe t'i thotë se të kam besuar, këmbët e tij do të flasin dhe do të thonë: Jo, Lartmadhëria jonë, ishte ky i cili na dërgonte për çdo ditë në lokalet e alkoolit. Kështu do të flasin edhe duart duke thënë: Jo, Lartmadhëria jonë, na detyronte t'i rrihnim të dobëtit. Kështu do të flasë edhe gjuha duke thënë: Jo, Lartmadhëria ime, vazhdimisht e përdorte gjuhën e tij për të të mohuar. Kështu do të vazhdojë të dëshmojë kundër edhe trupi i tij

Le t'a lexojmë thënien e All-llahut në Kur'anin Kerim:

"derisa të arrijnë tek ai (zjarri), kundër tyre do të dëshmojnë, veshët, sytë dhe lëkurët e tyre. (Këto do të dëshmojnë) Për atë se ç'kishin punuar. (ata) Lëkurëve të tyre do t'iu thonë: "Përse dëshmuat kundër nesh? Do të thonë: "All-llahu na bëri të flasim, ashtu siç ka bërë çdo gjë të flasë. Ai Ju krijoi herën e parë dhe tek Ai (përsëri) do të ktheheni."

Pra, në lirinë e njeriut, hyjnë edhe gjymtyrët ose organet e trupit, ato janë në shërbim të tij. Ato, në këtë botë, u shërbejnë të gjithë njerëzve, ndërsa, në ahiret, ato do t'u shë-rbejnë vetëm besimtarëve.

Nëse femohuesi do të tentojë të ikë nga Dita e Kijametit, atij nuk do t'i lëvizin këmbët. Kështu është edhe kur të dëshirojë të ikë nga dënimi i zjarrit, këmbët e tij e dërgojnë vetë atje, edhe pse ai do të kundërshtojë. Nëse do të kërkojë ujë për të pirë, atij do t'i jepet ujë i valë dhe me të do t'a 'largojë' etjen. Kështu është edhe kur ai do të dëshirojë të vishet, melekët e zjarrit do t'i qepin rroba të hekurta të puthitura pas trupi (parzmore të skuqura).

Kështu do të veprojnë edhe shërbyesit. Ata në Ditën e Kijametit nuk u shërbejnë femohuesve (qafirëve). Ata jo vetëm që do t'i mallkojnë, por do t'i djegin dhe do t'i dënojnë në forma nga më të të ndryshmet. All-llahu xh.sh. e privi-legjoi njeriun, sepse Ai ka paraparë që njeriut t'i japë në ahiret përjetësinë - jetë e cila nuk bazohet nga ndikimet e proceseve apo shkaqeve. Aty janë të gjitha të mirat dhe ka begati të panumërta. Njeriu (besimtar) nuk iu largohet atyre, e as ato nuk iu shmangen besimtarëve. Ajo është jetë e cila do t'u përshtatet besimtarëve, kuptohet secilit sipas meritave. All-llahu xh.sh. e privilegjoi njeriun duke ia dhënë krenarinë në univers dhe jetën e pambarueshme (në ahiret) që nuk ka fund (vdekje).

Jeta e njeriut nuk mbaron me vdekjen. Pas jetës së kësaj bote, ai ka për të jetuar në ahiret, gjë për të cilën edhe është krijuar. Por, kush do të shpërblehet me këto begati? Do të shpërblehet vetëm ai i cili e ka kryer detyrën e vet në këtë botë, detyrë për të cilën e ka krijuar All-llahu xh.sh. E kjo detyrë duhet të bazohet në frikë-respektin ndaj All-llahut xh. sh. Ky frikë-respekt do t'a shpierë njeriun në lumturinë e amshueshme.

I Lartmadhëruari e krijoi universin që t'i bindet dhe që i tëri t'a falënderojë All-llahun. Nëse i bashkangjitesh linjës së detyrimeve të universit, dhe je prej atyre që adhuron All-llahun xh.sh., me siguri do të kesh jetë të hareshme, sikurse krijesat e tjera. Secila krijesë e jeton jetën e vet në univers. Pas kësaj, i Lartësuari do t'i japë (njeriut) përjetësinë, në ahiret.

Përderisa i Lartmadhëruari na krijoi për t'a adhuruar Atë, a mos vallë kjo do të thotë se All-llahu xh.sh. paska nevojë për këtë adhurim!? Themi: I Lartmadhëruai është absolutisht i panevojshëm për të. Ai nuk ka nevojë për asgjë, nga të gjitha krijesat e Tij. Mohimi, Atë, se dëmton aspak. Frikë-respekti ose bindja jonë, Atij nuk i shërben absolutisht për asgjë. Ai na krijoi të lirë që ne të veprojmë sipas vullnetit tonë. Ai që dëshiron të besojë le të besojë, po ashtu, edhe ai që dëshiron të mohojë le të mohojë. Secili duhet t'i drejtohet Atij me dashuri, e jo me zor.

I Lartmadhëruari thotë:

"Sikur të donim Ne, do t'iu zbritnim atyre nga qielli një shenjë (mrekulli - para së cilës), ata do të përulnin kokat dhe do të nënshtroheshin. "

LIGJET E ALL-LLAHUT DHE LOGJIKA E NJERIUT

Ç'bëri njeriu kur i Lartësuari All-llah e bëri zotëri të universit, dhe ia nënshtroi të gjitha krijesat e tjera? A mos vallë ai e kuptoi seriozisht jetën e kësaj bote dhe filloi t'a praktikojë menjëherë sipas

programit të All-llahut? Jo! Ai e la programin e All-llahut dhe mendoi të sillte ligjet e veta (pozitiviste) për veten e vet. Me këto ligje, ai vetëm sa e stërmbushi universin me mjerim. Sot, njerëzimi, në vend të programit të All-llahut, po praktikon ligjet pozitiviste. Sot, njeriu i dashuruar me logjikën e tij, gjendet në një pozitë mjaft të mjerë, ngase e ka lënë programin e All-llahut.

Programi i cili të vjen nga i Urti është ai i cili merr parasysh çdo gjë (që të nevojitet, o njeri), ndërsa programet e tjera që të servohen vijnë nga i njëjti lloj, prej të cilit je edhe ti vetë, o njeri! Pra, kemi një dallim shumë të madh midis këtyre dy programeve. Ai që vjen nga qenia e llojit tënd është shumë i kufizuar, i paperceptueshëm dhe ka mangësira të shumta. Edhe vetë jemi dëshmitarë se, sapo fillojmë të mësojmë diçka, shohim se diçka tjetër na ka kaluar (pa e njohur).

Ndërsa ligjet Hyjnore shihet qartë se janë të qëndrueshme, ato nuk ndryshojnë dhe nuk zëvendësohen. Ai i Cili i parashikoi dhe i vendosi këto ligje e di fare mirë se çfarë do të ndodhë me mbarë universin deri në Ditën e Kijametit. Atij nuk mund t'i përballet askush, madje, askush nuk prete-ndon t'i përballet, sepse i Lartmadhëruari është i Ditur dhe dituria e Tij është pafund.

Ligjet e njerëzimit kanë mangësitë e tyre. Jemi dëshmitarë se ato janë përplot zëvendësime dhe ndryshime. Nuk kalojnë pak vite dhe befasohemi me "ligje" të reja të cilat japin shpresën e "shërimit" të problemeve shoqërore, por me kalimin e kohës dalin probleme të reja, të cilat nuk janë parashikuar. Këto probleme të paparashikuara bëhen shkak i ndryshimeve dhe i zëvendësimeve të "ligjeve" me të tjera "më të mira". Por ajo që të bie në sy është fakti se zëvendësimi i këtyre ligjeve bëhet po nga të njëjtit (nga qeniet njerëzore), të cilët janë si ne, pra, që diçka e dimë, e shumëçka nuk e dimë. Pa dyshim se edhe ky zëvendësim do të duhet të ndryshojë

pas një kohe relativisht të shkurtër. Kështu, njerëzimi do të vuajë nga ndryshimet e (njëpasnjëme të) ligjeve, deri atëherë kur të vijë urdhëri nga All-llahu xh.sh.

Mjerimi në univers është rezultat i mosrespektimit (dhe moszbatimit) të detyrës sonë, për të cilën jemi krijuar, pra, nga moskryerja e adhurimit të All-llahut xh.sh. dhe nga mospë-rcjellja e programit të Tij, program të cilin nuk ka mundësi t'a sfidojë asnjë mendje njerëzore e as askush tjetër, sepse ai (program) është reveluar (zbritur) nga Urtësia Hyjnore.

All-llahu xh. sh. na ka prezantuar programin në të cilin është mirëqenia dhe lumturia. Mjerisht, ne parapëlqyem filozofirat e kota, që janë plot mashtrime. Nga kush vijnë këto mashtrime? - Nga njeriu! Si është e mundur që ne të jemi më të mirë dhe më përparimtarë se All-llahu, në univers?! Ne, në këtë mënyrë, po shkatërrojmë çdo gjë. Kemi humbur jetën dhe qëllimin tonë. Kjo që po bën njeriu, do të thoja, është një krim i papërshkrueshëm. Ai po i bën dëm vetvetes dhe, përveç kësaj, po hyn në kompetencat e Krijuesit të Tij.

I jemi shmangur qëllimit për të cilën u krijua ky univers. Sipas kësaj që na servohet nga njerëzimi, jeta jonë është e kotë (e paqëllimtë). Meqë jemi duke e humbur jetën e kësaj bote, me siguri, do t'a humbim edhe jetën e dytë (ahiretin). Jeta e parë do të na shpierë tek ajo e dyta, në ahiret, tek ajo që është e vërtetë dhe e përjetshme. Ah, sikur ne t'a të jetonim këtë jetë sipas urdhërave të All-llahut! Ne po e humbasim së koti jetën e parë, sepse jemi duke u marrë me filozofira të kota dhe me ide njerëzore. Jemi duke u marrë me ato të cilat e lejojnë të keqen dhe e ndalojnë të mirën. Kurse, atyre, që ndjekin programin e All-llahut iu thonë të prapambetur dhe të marrë. Vallë, kush është vërtetë i marrë, ne, apo ata që duan t'a humbin amshimin (ahiretin)?

JETA – NGA MASHKULLI DHE FEMRA

All-llahu i Lartmadhëruar kur e krijoi këtë botë, vendosi në të edhe ligjet e saj. Një prej këtyre ligjeve të Tij ka paraparë se jeta njerëzore do të shumohet prej vetë qenies së vet. Nga mashkulli dhe femra. Secila krijesë, është krijuar me veçoritë e veta. Njeriu, bimët, kafshët dhe të gjitha qeniet në tokë janë të krijuara nga çifti: mashkull-femër. Të qenurit mashkull dhe femër jep të kuptohet se këto krijesa janë autonome, të pavarura nga krijesat e tjera. Askush nuk mund të krijohet nga një qenie e një lloji tjetër, ashtu siç pretendojnë darvinistët.

Le të lexojmë këtë thënie të All-llahut xh.sh. në Kur'an:

"...dhe, prej çdo sendi, kemi krijuar çiftin, mbase do të mendoni (do t'i përkujtoni Mirësitë e All-llahut)."

Pra, çifti paska ekzistuar, ndërkohë që ne nuk e dinim këtë, por e mësuam shumë vonë. Mësuam se edhe elektriciteti për të funksionuar domosdo duhet të ketë çiftin (e ngarkesave të grimcave elementare), atë negativ dhe pozitiv. Sikur të dy ngarkesat të ishin negative ose pozitive nuk do të kishim kurrën e kurrës elektricitet. Kështu mësuam se edhe mjegullat janë të krijuara sipas këtij ligji, të ngarkesave elektrike pozitive dhe negative. Kur ato çiftëzohen (bashkohen) japin shiun. Po kështu mësuam se edhe atomi përmban në vete pozitivin (pozitronin) dhe negativin (elektronin). Sigurisht ekzistojnë edhe krijesa të tjera për të cilat ne, ende, nuk dimë gjë. Por, kur të vijë koha e shfaqjes së këtyre krijesave, All-llahu xh.sh. do të na i zbulojë neve ato sekrete.

Kështu do të mësojmë se çdo lloj, apo qenie në këtë univers, pa përjashtim, është krijuar nga çifti: mashkull-femër.

Nga kjo nxjerrim dy gjëra që duhen të konsiderohen si thelbësore. All-llahu xh.sh. është Ai i cili ka gjykuar (vendosur) për to. Ai ka kërkuar që ne të mos t'i nënshtrohemi logjikës apo mendjes sonë për to. Logjika, me dijen e vet, nuk mund t'a perceptojë dot këtë. Ështja e parë është se ne nuk mund t'a dimë se si është krijuar universi, ndërsa, e dyta, është se ne nuk mund t'a dimë, gjithashtu, se si jemi krijuar ne.

Ju themi simpatizuesve të teorive të "specializuara" që meren me krijimin: Si ishte forma e këtij universi më herët? Nga i nxirrni 'këto e ato teori' dhe prej kujt i merrni këto të dhëna!? A mos vallë keni qenë dëshmitarë të krijimit, apo ju ka ardhur ndonjë njohuri, të cilën nuk e posedojnë të tjerët!? Ata të cilët pretendojnë se prejardhja e njeriut është nga majmuni, janë shumë të gabuar. Ëdo gjë që është në kundë-rshtim me (të vërtetën mbi) origjinën e natyrës së universit është e gabuar. Sado që të bashkohen idetë dhe argumentet e dobëta (për t'a mbështetur njëra-tjetrën), ato nuk mund të na japin të vërtetën.

Tani, le t'a përmbledhim shkurtimisht atë që thamë: All-llahu është Ai i Cili krijoi këtë univers për t'i bërë sexhde, për t'a madhëruar dhe për t'iu lutur të Lartmadhëruarit. I tërë universi i është bindur dhe i është nënshtruar All-llahut xh.sh. me detyrim. Por, All-llahu i Lartmadhëruar ishte Ai i Cili dëshiroi që njeriu t'a adhurojë Atë nga dashuria (me dëshirën e vet).

Gjithashtu, All-llahu xh.sh. ishte Ai i Cili e caktoi programin dhe solli misionarët e Vet që (ky program) t'a përfshijë mbarë lëvizjen jetësore. Adhurimi nuk duhet të kuptohet vetëm me namaz, zekat, agjërim dhe haxh. Por, e tërë lëvizja e jetës sonë është adhurim.

All-llahu xh.sh. kërkoi nga ne që të lëvizim (punojmë) në jetë dhe t'a ndërtojmë tokën. P.sh. për t'a bërë namazin ne detyrohemi të merremi me aktivitete të gjëra (punuese) të të jeturit tonë. Kjo përfshin shumë segmete të jetës sonë. All-llahu i Lartmadhëruar nuk dëshiron nga ne që gjithmonë dhe pandërprerë, ditën dhe natën, t'i shprehim Atij falënderimet tona. Por, Ai kërkon nga ne që të punojmë dhe të lëvizim.

Njeriu filloi të bëhet shkatërrues, atëherë kur presupozoi se ai është eksperimentues në tokë. Kështu, ai i la anash ligjet e All-llahut dhe parapëlqeu "ligjet" e veta për veten e vet. Ky eksperimentim me ligjet njerëzore (individuale), po i sjell njerëzimit mjerim dhe po e largon nga programi i All-llahut, të cilin po e zëvendëson me ligjet e veta njerëzore. Ne, derisa të polemizojmë për krijimin dhe për gjërat të cilat nuk i përkasin mendjes sonë, do të shkojmë drejt humbjes. Debati rreth krijimit dhe rreth asaj se si erdhi njeriu, është i kotë dhe nuk na çon deri tek e vërteta.

Jeta jonë është e shkurtër në këtë botë të kufizuar. Ndërsa jeta e ahiretit është jeta e vërtetë, të cilën nuk e pengon as vdekja e as asgjësimi total. Ajo është jeta e përjetësisë për të cilën do të flasim në kapitullin e ardhshëm.

KAPITULLI I GJASHTË
JETA TJETËR - AHIRETI

Para se të mbarojmë fjalimin tonë rreth jetës dhe vdekjes, është e domosdoshme të flasim hollësisht për jetën e ahiretit. Njeriu nuk dyshon për të vërtetën, se: jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, veçse një vend eksperimental laboratorik. Njeriu nuk mundet t'i shmanget kurrsesi kësaj (sprove), sado të jetojë në të. Pastaj do të shkojë në jetën e përjetësisë.

Jetës së kësaj bote i paraprin vdekja, dhe ajo e ndjek atë. Jeta e kësaj bote është jetë e mashtrimeve, gjendja e njeriut asnjëherë nuk është e stabilizuar. I forti bëhet i dobët, ndërsa i pasuri bëhet i varfër, po ashtu edhe pushtetari mund të mbetet pa fuqinë e tij ndikuese në masë.

Ndërsa jeta e ahiretit është e kundërta e kësaj, ajo është e stabilizuar në çdo gjë. Ajo është e qetë, si në të mira ashtu edhe në të këqia, në pengesa dhe në liri. Njeriu, para se të vinte në këtë botë, ka qenë në gjendje të vdekur, ose në botën e Dherrit, për të shkuar më pas në jetën e përjetësisë. Ai përsëri do të kthehet në gjëndje të vdekur, ose në botën e Berzah-it. Ndërsa Berzah-i është kufiri midis vdekjes dhe ringjalljes, midis botës dhe ahiretit. Me mbarimin e kësaj etape nuk ka më kthim në këtë jetë.

Duhet t'a dimë se njeriu, qoftë në botën e Dherrit, qoftë në jetën e kësaj bote, ose në botën e vdekjes, ose në ahiret, është i arkivuar në regjistra shumë precizë, që gjenden tek All-llahu i Lartmadhëruar. Pra, secila etapë do të kapërcejë nëpër një sistem shumë të sofistikuar, që i përket vetëm një preciziteti të lartë Hyjnor.

All-llahut xh.sh. nuk mund t'i shpëtojë asgjë pa ditur në këtë univers sepse Ai e regjistroi qëllimin e çdo gjëje dhe precizitetin për secilën krijesë veç e veç. Atij nuk i shpëton pa ditur as sa grimca e atomit, as në këtë tokë, e as në qiej. Ai, çdo gjë, çdo ngjarje dhe çdo vepër, e ka të shënuar në librin e quajtur 'nëna e Librave' që është në 'Lehvi Mahfudh'..

Le të lexojmë thënien e All-llahut:

"Vërtet, Ne, i ringjallim të vdekurit, e shënojmë të kaluarën e tyre dhe gjurmët (veprat që kanë lënë, dhe ato që vazhdojnë edhe pas vdekjes së tyre). (Gjithashtu Ne) çdo send e kemi të statistikuar në Librin e qartë."

Pra, paskemi një regjistër shumë të ruajtur, i cili qenka tek All-llahu xh.sh. për secilin prej nesh. Ai regjistër po i përfshika të gjitha ndodhitë e jetës dhe ai do të jetë dëshmuesi ynë në Ditën e Kijametit. Si do të dëshmojë ai? Do të dëshmojë me zë dhe fotografi dhe ne do t'i shohim të gjitha ndodhitë e jetës sonë, ashtu siç kanë ndodhur. Ato do të dëshmojnë për secilën imtësirë me një precizitet aq të madh saqë, pas kësaj dëshmie, askush nuk do të ketë mundësi t'a mohojë atë që ka ndodhur. Kjo bëhet me qëllim që njeriu të bëhet vetë dëshmitar për veten e vet në Ditën e Kijametit.

Të shohim se çfarë thotë All-llahu xh.sh.:

"(njeriut do t'i thuhet)...Lexoje librin tënd (dosjen), mjafton që ti, sot, t'i japësh llogari vetes tënde!"

Ky regjistër dhe kjo jetë e regjistruar për mbarë jetërat e njerëzve është shumë preciz. Do të habitemi nga ky precizitet i regjistrimit. Aty ka gjëra dhe hollësi që, edhe nëse ne do t'i kemi harruar, do t'i gjejmë tek ky libër regjistrues.

All-llahu xh.sh. thotë:

"(veprat e tyre)...All-llahu i ka të gjitha të saktësuara, ndërsa ata i harruan..."

Ne nga preciziteti i lartë (i regjistrimit), gjithashtu, kemi për t'a ndier madhështinë e llogaritjes, pasi All-llahut nuk i paska shpëtuar asgjë pa e ditur. Për këtë, patjetër, le t'i hedhim një vështrim edhe thënies së All-llahut xh.sh:

"...dhe do të thonë: "Të mjerët ne, ç'qenka ky libër! Nuk paska lënë as më të voglën, (vepër) e as të madhen pa e regjistruar. Atë që kanë punuar do t'a gjejnë përpara, ndërsa Zoti Yt, nuk i bën padrejtësi askujt."

Kur ne lexojmë këto fjali (ajete) kur'anore, ato na shtyjnë dhe na nxisin t'u shmangemi mëkateve. Ne, kështu, e kuptojmë bindshëm se çdo gjë regjistrohet dhe se ky regjistër do të shpaloset për të dëshmuar në Ditën e Dëshmisë së Madhe, para All-llahut të Lartmadhëruar. Ai (regjistri) do të dëshmojë për çdo hollësi të veprimeve tona me zë dhe fotografim..

MENDJA – JO,
NDËRSA MUNDËSIA- PO

Ata të cilët nuk u besojnë sekreteve, ndalen duke thënë: A është e mundur kjo!? A është e mundur që t'i shpalosen (veprimet) secilit, veç e veç!? Ata, që kanë jetuar në këtë botë dhe që do të jetojnë deri në Ditën e Kijametit, janë biliona e biliona individë! Ludi! A është e mundur që All-llahu të na i paraqesë (veprimet) secilit veç e veç, kur trupat e njerëzve t'i ketë përpirë toka, ashtu që nuk do të ketë mbetur asgjë prej qenies njerëzore!?

Kur ne flasim për Fuqinë ose mundësinë e All-llahut xh.sh., nuk duhet të gjykojmë kurrën e kurrës sipas logjikës sonë. All-llahu xh.sh. është mbi mundësitë e logjikës sonë, Atij nuk i ngjason askush. Kështu edhe cilësitë e Tij dhe mundësitë e Tij janë mbi perceptimet tona njerëzore. Secili njeri është krijuar nga një precizitet shumë i lartë i cili as nuk tretet e as nuk humbet kurrë.

All-llahu i Lartmadhëruar, nga Mëshira e Tij, për t'a ndihmuar mendjen tonë, ka bërë që ky univers të ketë sekretet e veta, të cilat ia zbulon njeriut aq sa mendja e tij të jetë në gjendje të gjykojë dhe t'i kuptojë ato sekrete të mahnitshme. E gjithë kjo, mbase, është bërë që ne mos të humbim, ose mos të dëshpërohemi.

Njeriu në origjinën e tij ka qenë spermë. Mbarë njerëzimi ka qenë në trupin e Ademit, apo për të qenë më preciz, ajo ka qenë në spermë. Syri i rëndomtë nuk e sheh dot atë. Mendoj se ky precizitet është i mjaftueshëm për njerëzit.

Le të parafytyrojmë se mbarë njerëzimi, që prej krijimit të Ademit (e deri në ditën e fundit), ka qenë prezent në trupin e tij (të Ademit a.s.). Ky ishte fillimi. Secili spermato-zoid paraqet një jetë njeriu. Atij i është regjistruar një shifër (kod) që është shumë precize për tërë jetën e tij. I është regjistruar jeta, gjatësia dhe të gjitha ngjarjet që do t'a përcjellin atë: nëse do të jetë ai mashkull apo femër, fatmirë apo fatkeq, e të tjera gjëra të jetës së tij.

Sikur ne t'a dinim çelësin e kësaj shifre, do t'a merrnim dhe do t'a vendosnim atë në kompjuter në mënyrë që t'i zgjidhnim labirintet. Aty do të kishim parë sekondat e jetës së njeriut, do të kishim parë formën dhe gjininë e tij, gjithashtu do të kishim parë edhe jetën e tij të plotë dhe me përpikmëri. Nëse kjo është një e vërtetë shkencore që ka filluar të dalë dhe të zbulohet tani, ajo ka qenë që prej Ademit a.s. Por, All-llahu xh.sh. nuk shprehu vullnetin e Tij që t'i zbulonte njeriut disa sekrete menjëherë qysh atëherë. Tani, si duket, ka ardhur koha e shpalosjes së tyre.

Ky spermatozoid përzgjidhet me një precizitet të mahnitshëm. Vetëm ai do të jetë i aftë që, nga gjithë ai kontingjent i madh spermatozoidesh të spermës që depërtojnë në mitër, t'a shpërthejë vezën për t'a mbarësuar atë. Ky kod (shifër) do të vazhdojë të japë atë se çka i është regjistruar, derisa t'i vijë exheli dhe kështu ai e përfundon detyrën e tij.

REGJISTRI NUK HUMBET

Ky është regjistri i cili nuk fshihet, as nuk humbet, e as nuk i shlyhen shenjat, asnjëherë. Kur Allahu do t'i ringjallë njerëzit në Ditën e Kijametit, Ai do t'i thotë spermatozoidit: Bëhu, dhe

shifra do të hapet. Ai pastaj do të deshifrohet për të dhënë informacionin që ka të regjistruar brenda. Kështu njeriu do të jetë dëshmitar i vetvetes.

I Lartmadhëruari All-llah na tërheq vërejtjen kur Ai thotë: ringjallja është rikthim i krijimit e nuk është krijim i ri.

All-llahu xh.sh. thotë:

"Ashtu siç e filluam me krijimin e parë, ashtu do t'i kthejmë ata tek Ne. Ky është premtimi Ynë, vërtet, Ne, do t'a bëjmë këtë."

Gjithashtu, i Lartësuari thotë:

"...ata do të thonë: cili do të na kthejë neve (ringjall)!? Thuaju: (do t'iu ringjallë) Ai i cili ju ka krijuar herën e parë. Ata do t'i tundin kokat dhe (në formë talljeje do të) thonë: Kur është ajo!? Thuaju: Shpresojmë se do të jetë afër."

Kësaj fare (spermatozoidi) që është në tokë, i Lartëmadhëruari All-llah do t'i thotë: kthehu ashtu siç ishe, dhe ajo do të kthehet. Ndërsa dallimi i vetëm është koha, sepse në ahiret nuk ka kohë, shprehja 'kohë' atje nuk ekziston. Ajo që ka ndodhur në këtë botë brenda tridhjetë, katërdhjetë, pesëdhjetë vjetësh ose më shumë se kaq, ose më pak, do të kryhet në çast.

Vetëm ky do të jetë dallimi që do t'i dallojë. Ndërsa, përveç kësaj, ringjallja duhet kuptuar si kthim i një jete që ka ekzistuar. Edhe pse kemi ngjashmëri midis njerëzve në pamje, cilësi dhe përmbajtje, aty nuk do të kemi ngjashmëri dhe nuk do të ketë përputhje midis dy individëve, që

prej krijimit të Ademit a.s., e derisa të bëhet Dita e Kijametit, edhe pse ne duam që të jemi kopje e përsëritur.

All-llahu i Lartmadhëruar është mëshirues ndaj mendjeve tona dhe për këtë na ka dhënë argumente të shumta. Si shembull do të përmendja vijat (poret) e gishtërinjve. Asnjëri prej nesh nuk i ka vijat e gishtërinjve të njëjta me dikënd tjetër, secilit i ndryshojnë nga tjetri. Bile, bile, ky ndry-shim duket midis gishtërinjve të një dore!! Kështu pra, besoj se askush nuk është kundër kësaj të vërtete. Kur, me kalimin e kohës, dituria e kësaj bote po shfaq zbulime të shumta, (konstatojmë se ato qysh më parë janë gjendur në Kur'an, pra se) Kur'ani për secilën gjeneratë është dhurues i risive. Kjo me siguri nuk ndodh rastësisht. Sepse, i Lartmadhëruari All-llah, na ka tërhequr vëmendjen për këtë në Kur'anin Kerim, ku thotë:

"A mendon njeriu se nuk Jemi në gjendje t'ia mbledhim eshtrat? Jo vetëm kaq, por, Ne jemi në gjendje (t'ia mbledhim ato) edhe t'ia bashkojmë majat e gishtave të tij."

Kjo do të thotë se Fuqia e All-llahut xh.sh. nuk kufizohet vetëm tek rikthimi i eshtrave, të cilat do të kalben dhe madje do të shndërrohen në dhé, por Fuqia e All-llahut shkon aq larg, saqë Ai do t'i rikthejë edhe vijat e gishtërinjve, që secili individ i ka të ndryshme nga tjetri. Ky ndryshim, domethënë, ekziston që prej Ademit e deri në Ditën e Kijametit.

Fatmirësisht, shkenca e ka vërtetuar këtë. Padyshim se All-llahu ishte Ai i Cili ia shpalosi njerëzimit këtë dituri. Ashtu sikurse gishtërinjtë kanë vija të ndryshme, ashtu edhe trupi ka ndryshimet e tij. Gjithashtu, edhe era e trupit të njeriut ndryshon nga njëri tek tjetri. Keni vërejtur se qeni i policisë e ndjek erën e njeriut të arratisur sepse secili njeri ka erën e vet..., kështu është edhe me ndryshimin e zërit, të dhëmbëve, etj. Bile i tërë trupi ka shifrat e veta të veçanta, secili

organ i di ndryshimet e veta dhe i njeh ato. Kjo mundëson që të mos ngatërrohen pjesët e trupit, apo organet e një trupi me një trup tjetër.

Ne këtë e vërejmë në mbjelljen e organeve dhe mbjelljen e lëkurës. Trupi i njeh organet e tij, ashtu si e njeh lëkurën e vet. Kur njeriu plagoset, vërejmë se si lëkura solidarizohet me pjesët e tjera të trupit dhe bën thurrjen, derisa të shërohet plotësisht. Ky solidaritet vazhdon kështu me të gjitha pjesët ose organet e trupit, kur ato sulmohen nga mikrobe të ndryshme. Organet e trupit bashkohen, bien në ujdi dhe së bashku i luftojnë mikrobet, derisa i mundin ato.

Nëse marrim një organ ose lëkurë të huaj prej një njeriu tjetër, çfarë do të ndodhë!? Do të shohim se si trupi reagon menjëherë, sepse do t'a kuptojë se tek ai janë futur pjesë të huaja. Ìuditërisht ai do t'i luftojë ato dhe do të mundohet t'i përzerë në çdo mënyrë. Qofshin ato organe prej trupit të vëllait, djalit apo vajzës së tij. Pra, ai i lufton ato edhe pse ato (organe) kanë të bëjmë me vetë origjinën e tij.

Kjo na lë të kuptojmë se secili trup ka shifrën e vet të ndryshme nga tjetri. Si duket, mjekët kirurgë, e dinë më së miri këtë të vërtetë, kur ata bëjnë mbjelljen e organeve. Ata dëshmojnë çdo ditë se si trupi i nënës e refuzon mëlçinë e vajzës së saj. Gjithashtu, edhe trupi i babait nuk e pranon lëkurën e djalit të tij, sepse secili trup ka shifrën e vet që nuk përputhet me trupin tjetër. (Kjo shifër është) Prodhim i All-llahut i Cili e përkreu çdo gjë.

ARGUMENTI LOGJIK
I RINGJALLJES

Tani, përpara këtyre fakteve (argumenteve), është më afër mendjes të themi se secili njeri ka pamjen e vet dhe nuk i ngjason askujt. Pra, njeriu, nuk është kopja e tjetërkujt. Ai ka cilësitë e tij, që e bëjnë atë të dalluar nga të tjerët. Këto gjëra të veçuara të tij e bëjnë atë të ketë shifrën ose kodin e tij, qysh nga formimi i spermatozoidit të tij. Që nga filli i të qenurit njeri prej Botës së Dherrit ose vdekjes, deri në këtë botë, ku do t'a kryejë detyrën e tij.

Ne, që prej atëherë, e dimë saktë se do të rikthehemi në jetën tjetër, e cila është më e lehtë se ajo e para, edhe pse për All-llahun xh.sh. nuk ekziston shprehja më e lehtë ose më e vështirë. Atij i mjafton gjësendit t'i thotë 'Bëhu' dhe ai bëhet. Por ne këtë shprehje e themi sa për t'a kuptuar ne, se rikrijimi është më i lehtë përsa na përket neve krahasuar me krijimin e parë. All-llahu i Lartmadhëruar, në Kur'anin Kerim, për t'a afruar kuptimin sa më afër mendjeve tona, thotë:

"Ai krijon prej asgjëje, dhe Ai e përsërit atë; për Të - kjo është shumë e lehtë..."

Transferimi ynë nga një etapë në një etapë tjetër, në udhëtimin tonë drejt përjetësisë nuk bëhet ndryshe përveçse me Fuqinë e All-llahut xh.sh. Dalja jonë nga varrezat, nuk duhet të kuptohet se është jeta jonë e amshueshmërisë- ahiretit. Kjo dalje shërben vetëm për t'u paraqitur tek Dita e Llogarisë. Atëherë, mbarë njerëzi do të ringjallen nga varrezat e veta, pra, prej aty ku ishin varrosur. Ata do të dalin prej aty dhe, ashtu siç thamë, do t'i thuhet spermatozoidit: Bëhu. Ashtu siç ishte spermatozoidi në botën e Dherrit, i cili përpëlitej në pamje të vdekjes.

Kështu do të vazhdojë derisa të urdhërojë All-llahu e të thotë: Bëhu! Dhe jeta do të fillojë, derisa të realizohet e shkruara e tij, që prej shtatzënisë, lindjes, fëmijërisë, adoleshe-ncës dhe jeta e tij e caktuar deri në vdekje. Kështu do të jetë edhe me momentin e ringjalljes, atëherë kur spermatozoidit do t'i thuhet: Bëhu! Njerëzit do të fillojnë të dalin prej varrezave të tyre. Por, si do të dalin?

A do të stërmundohet së përpjekuri njeriu për të dalë nga varreza, apo do t'a zhbirojë dheun, që ka sipër, për të dalë? Jo, asesi, toka do të shkapërderdhet për të me urdhërin e All-llahut.

Le të lexojmë thënien e All-llahut:

"Ditën kur toka do të çahet (hapen varrezat) e të dalin ata me nxitim, kjo është (dita e) grumbullimit (i gjithë njerëzimi për t'u marrë në pyetje), për Ne kjo është fare e lehtë."

Pse e quajti All-llahu i Lartmadhëruar Dita e Grumbu-llimit (Hashr-in)? Sepse secili që është varrosur në tokë do të dalë prej saj, edhe pse (njerëzit) nuk janë varrosur njëherësh. Ata janë varrosur përgjatë shekujve të shumtë dhe pjesët e tyre janë zbërthyer dhe shpërndarë nëpër vende të largëta midis vete dhe, përfundimisht, janë shndërruar në dhé. Por, prapse-prapë, të gjithë do të dalin përnjëherësh. Toka do t'iu bëhet e ngushtë dhe për këtë arsye i Lartmadhëruari e quajti Dita e Grumbullimit (Hashr), sepse kallaballëku do të jetë shumë i madh.

Le të supozojmë p.sh. që Egjipti t'i presë vetëm të vdekurit e vet, që kanë vdekur para shumë shekujsh. Të gjithë njerëzit do të vijnë njëherësh. S'do mend se do të bëhej një rrëmujë e madhe dhe ato ditë do të ishin ditë të tmerrshme.

Në kohën kur unë isha në Amerikë, një person më pyeti: Ku shkon shpirti pas vdekjes? Iu përgjigja: aty ku ishte para se të vinte në këtë jetë. Një tjetër më pyeti: si do të bëhet regjistrimi për të gjitha ngjarjet në univers? I thashë: Ato nuk janë vetëm të regjistruara, por edhe të shkruara tek All-llahu i Lartmadhëruar, para se ato të ndodhnin. Ky është edhe një argument i Fuqisë Hyjnore që përfshihet në Diturinë e All-llahut. Secila punë dhe secila ngjarje bëhet sipas regjistrimit të All-llahut për të.

Lexoni thënien e All-llahut të Lartmadhëruar:

"Asnjë fatkeqësi (mjerim) nuk e godet tokën, e as juve, pa qenë e shënuar që më parë në Libër. Me të vërtetë, për All-llahun, kjo është e lehtë!"

Se sa preciz është regjistrimi, këtë do t'a shpjegojmë me anën e shembullit të syrit të kriminelit. Atij, në bebëzën e syrit i paraqitet fytyra e tij e kriminelit (katilit). Sikur ne të kishim mundësi t'a zbërthenim bebëzën e syrit të kriminelit, do t'a kishim parë apo njohur menjëherë pamjen e tij kriminale. Ldo gjë është e regjistruar, dhe për këtë ka argumente.

All-llahu xh.sh. para se t'a krijonte jetën, krijoi vde-kjen. Kur të lindë njeriu, meleku i vdekjes është vazhdimisht në përcjellje të tij. Jeta e njeriut në këtë botë është aq sa e ka caktuar meleku i vdekjes për të. Kur ai e takon atë, atëherë e ka exhelin.

XHENNETI

Njeriu ka shumë të panjohura. I Lartësuari All-llah, ka bërë që në botën tjetër, gjithashtu, të ketë gjëra të shumta të panjohura. Xhenneti është një vend që syri s'ka parë kurrë si ai, e as veshi nuk ka dëgjuar, e as zemra njerëzore nuk e ka përjetuar. Prandaj, do të ishte shumë e vështirë të gjenim shprehje për t'a përshkruar atë dhe (mënyrën) se si do të ishte jeta atje.

Së pari, për t'a përshkruar gjësendin duhet të kemi para vetes idenë ose fotografinë e atij në mendje. Pasi t'i kishim këto, atëherë do të gjendeshin shprehjet e duhura të përshta-tshme për të, që do të na shpienin deri tek ajo. P.sh. para se të shpikej televizioni, nuk ekzistonte shprehja televizion, në asnjë fjalor të botës. Kur ai u shpik dhe u bë realitet, shprehja e tij tani gjendet në të gjithë fjalorët gjuhësorë. Pra u gjend shprehja e përshtatshme e tij.

Kur All-llahu i Lartmadhëruar na përshkruan jetën e xhennetit thotë: "Sikur shembulli i jetës..." ç'ka do të thotë se ajo nuk është e tillë, por (sikur ajo) Ai na e afron afër mendjes sonë. Ne, me këtë njohuri që kemi, kur duam t'i shpjegojmë dikujt diçka që nuk i është e njohur, ne mundohemi t'i sjellim disa shembuj analoge të saj. Me këtë ne vetëm sa e kemi përngjasuar atë me diçka që na është e njohur. Kështu veprojmë sa për të na kuptuar bashkëfolësi. Ti, kur përpiqesh t'ia shpjegosh një njeriu tjetër formën e tokës, së pari ia afron hartën e rruzullit tokësor. Por, sikur t'ia paraqitje rruzullin tokësor në formën e sferës (topthit) do të ishte shumë më mirë. Pastaj i thua atij: - Ja, toka i ngjason kësaj forme.

Kur, ata që e kanë merituar, do të hyjnë në xhennet, xhenneti do t'u ngjasojë me ndonjë gjë, që atyre u ishte e njohur. Atyre do t'iu duket se, ajo që po shohin, është duke u ngjasuar me diçka të

ngjashme me të cilën furnizoheshin nga All-llahu xh. sh., në kohën kur ata ishin në botën eksperimentale. Por, realiteti është krejtësisht tjetër. I Lartësuari do t'i urdhërojë ata që të hanë (ushqimin e servuar). Ata, pasi t'a kishin shijuar atë, do të binden se nuk paska qenë ashtu siç kishin menduar. Pra, do të shohin dallimin ndërmjet kësaj bote (eksperimentale) dhe botës tjetër (ahiretit).

Për këtë arsye, secili përshkrim, që paraqitet nga All-llahu xh.sh. për jetën e xhennetit, duhet të kuptohet se Ai dëshiron t'ia afrojë mendjes njerëzore për t'a kuptuar sa më mirë. Pra, vetëm sa për t'i mundësuar njeriut të parafytyrojë se si do të jetë atje. Njeriu duhet t'a kuptojë se ai (përshkrim) vetëm sa i është përafruar mendjes së tij. Pasi (përshkrimin real) askush në këtë botë nuk është në gjendje t'a realizojë.

Isha një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më gostitën në një hotel mbretëror. Ata filluan të mburren me përparimin e tyre të lartë. Ndo gjë ishte ndërtuar prej guri. E prekje një buton për kafe dhe ajo dilte nga brenda. Butoni tjetër ishte e çajit, një tjetër i ushqimit, etj. Një ditë më pyetën: ç'mendon për ne? Ju thashë: nëse kjo është e tëra, dhe me këtë mburreni, kjo është arritja e njeriut për t'i shërbyer njeriut. A mund t'i paramendoni premtimet e All-llahut për njerëzit besimtarë në xhennet?

Në xhennet vetëm nëse të shkon në mendje për diçka, do t'a kesh para vetes. Ndo gjë që i kujtohet njeriut, ekziston atje. All-llahu ka shumë më shumë se çfarë mund të kërkojë ose njeh njeriu.

Për këtë, i Lartësuari, thotë:

"Ata do të kenë atje ç'të duan, ndërsa Ne kemi më shumë (për t'iu dhënë)."

Pra, All-llahu xh.sh. i jep njeriut në xhennet çdo gjë që atij i shijon, dhe çdo gjë që atij mund t'i shkojë ndërmend. Bile, atje, ka shumë më shumë se çka mendon ai. Por, mbi të gjitha, do t'i mjaftojë kënaqësia më e madhe, kur ai do t'a shohë All-llahun në Ditën e Kijametit.

Kjo do të jetë begatia më e madhe që do të arrijë njeriu i kësaj bote. Kur njeriu do t'a shohë All-llahun nuk do të kërkojë begati të tjera. Atë, pas kësaj kënaqësie të madhe të qëndrimit para All-llahut, nuk do t'a joshë më asgjë prej kërkesave njerëzore.

Për këtë, All-llahu i Lartmadhëruar, thotë:

"Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë, duke e shikuar Zotin e tyre."

Dhembja më e madhe, që mund të provojë njeriu në Ditën e Kijametit, është të mos e shikojë All-llahun. Gjithashtu, edhe Ai të mos ia hedhë shikimin, e as të mos i flasë. Kjo do të ishte dhembja dhe dënimi më i madh i mundshëm, për ata të cilët do të gjenden në fund të pusit të zjarrtë.

Për këtë, gjithashtu, i Lartmadhëruari thotë:

"...All-llahu as nuk ka për t'iu folur atyre dhe as nuk do t'i shikojë Ditën e Kijametit..."

Gjithashtu, i Lartësuari thotë:

"...vërtet, atë Ditë, ata (përgënjeshtruesit) do të jenë të penguar që t'a shohin Zotin e tyre."

Ne duhet të dimë, se jeta jonë, do të jetë o në xhennet, o në xhehennem. Trupi ynë do të pësojë ndryshime, ngase do të kalojmë nga forma e zhdukjes dhe ndryshimeve, në jetën e përjetësisë. Ai duhet të jetë i gatshëm për t'i përballuar problemet e jetës të cilën do t'a jetojë. Banorëve të

xhennetit do t'iu ndryshohet forma e trupit për t'a shijuar jetën në xhennet. Ata do t'a shohin All-llahun kur Ai do t'iu flasë, ndërsa ata (njerëzit) vetëm do të dëgjojnë. Banorëve të zjarrit (Zoti na ruajtë nga ai vend i tmerrshëm), sa herë që do t'iu digjen lëkurat e veta, do t'iu zëvendësohen me lëkura të tjera. Kjo bëhet me qëllim që t'a përjetojnë dënimin dhe dhembjen, për shkak se nervat e ndieshmërisë së dhimbjes janë nën lëkurë. Përfundimisht, këtë e zbuloi edhe shkenca e kohëve të fundit.

Për këtë i Lartësuari thotë:

"Me të vërtetë, ata që s'besojnë argumentet Tona, do t'i djegim në zjarr. Sa herë që t'u digjen (shkrumohen) lëkurat e tyre, Ne do t'ua ndërrojmë ato me lëkurë tjetër, (këtë e bëjmë sa) për t'a shijuar dhembjen. Vërtet, All-llahu është i Plotëfuqishëm dhe ka Urtësinë absolute."

Pra, ne do të jemi një krijesë e re. All-llahu i Lartësuar do të na japë të korrurat, të cilat i kemi mbjellë në jetën tonë të kësaj bote. Do të na japë jetën e përjetshme, jetë e cila u takon atyre që e kanë respektuar dhe besuar All-llahun xh.sh. Ai e krijoi gjithë këtë univers për njeriun, kjo është jeta për të cilën edhe All-llahu ka shprehur vullnetin që ne të ishim në të.

Ndërsa banorët e zjarrit (All-llahu na mbroftë prej tij), mbase kanë shijuar kënaqësi të pakta në këtë botë, por me ato kënaqësi të pakta, përfituan dënimin e përjetshëm. Ata e humbën dhe e shkatërruan jetën e tyre, duke e mohuar All-llahun xh.sh. Mjerisht, e humbën jetën e vërtetë, që na ka premtuar All-llahu i Lartmadhëruar.

Arritëm deri këtu dhe me këtë do t'a përmbyllja fjalimin, duke shpresuar se All-llahu xh.sh. është i kënaqur me ne. Lus të Lartmadhëruarin që ky libër të bëhet udhëzues për secilin që do t'a lexojë

dhe t'i bëhet dritë në rrugën drejt jetës së vërtetë në xhennet. Vërtet, Ai është dëgjues dhe u përgjigjet lutjeve.

* * *

Falënderoj All-llahun e Lartmadhëruar që më mundësoi përkthimin e këtij libri.

Lavdi All-llahut (el Hamdu lil-lah).